Banka e Shqipërisë

RAPORTI I POLITIKËS MONETARE PËR TREMUJORIN E TRETË TË VITIT 2012

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
sheshi "Avni Rustemi", nr.24, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; Faks: + 355 4 2419409/10/11
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

P Ë R M B A J T J A

OBJEKTIVI 9

I. FJALA E GUVERNATORIT 10

II. ZHVILLIMET NË EKONOMINË E JASHTME 14

II.1 Rritja ekonomike dhe balancat makroekonomike 14
II.2 Çmimet e mallrave kryesorë 18
II.3 Vendimet për normat e interesit dhe ecuria e tregjeve financiare 19

III. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE OBJEKTIVI I BANKËS SË SHQIPËRISË 21

III.1 Ecuria e çmimeve të konsumit, përmbushja e objektivit dhe politika monetare 21
III.2 Ecuria e inflacionit sipas kategorive 23
III.3 Prirjet kryesore të inflacionitt 25

IV. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE DHE NDIKIMET NË INFLACION 29

IV.1 Prodhimi i brendshëm bruto dhe ecuria e kërkesës agregate 29
IV.2 Tregu i punës, pagat dhe kostot e punës 52
IV.3 Inflacioni i importuar 56
IV.4 Pritjet inflacioniste 58
IV.5 Vlerësim i presioneve inflacioniste në sektorin real të ekonomisë 59

V. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE 61

V.1 Ecuria e treguesve monetarë 61
V.2 Zhvillimet në tregjet financiare 69
V.3 Vlerësimi i presioneve inflacioniste me natyrë financiare 77

HAPËSIRA INFORMUESE

Hapësirë informuese 1.	*Çmimet në Shqipëri në krahasim me ato në vendet e Bashkimit Evropian*	*27*
Hapësirë informuese 2.	*Çmimet në tregun e banesave për tremujorin e tretë, 2012.*	*33*
Hapësirë informuese 3.	*Ndryshimi i sjelljes konsumatore- Tregues nga pasuria financiare e individëve*	*38*
Hapësirë informuese 4.	*Zhvillimet kryesore në bilancin e pagesave, T2- 2012*	*43*
Hapësirë informuese 5.	*Reagimi i politikave makroekonomike gjatë viteve 2006-2012*	*50*
Hapësirë informuese 6.	*Përmbledhje e rezultateve nga vrojtimi i aktivitetit kreditues për tremujorin e tretë të vitit 2012.*	*68*

PËRMBAJTJA E TABELAVE

II. Zhvillimet në ekonominë e jashtme

Tabelë 1	*Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë*	*15*
Tabelë 2.	*Disa tregues makroekonomikë për vendet BRIK*	*17*
Tabelë 3.	*Tregues ekonomikë për disa vendet e rajonit*	*17*

III. Stabiliteti i çmimeve dhe objektivi i Bankës së Shqipërisë

Tabelë 4.	*Kontributi vjetor i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)*	*24*

IV. Zhvillimet makroekonomike dhe ndikimi në inflacion

Tabelë 5.	*Treguesit kryesorë të bilancit të pagesave*	*43*
Tabelë 6.	*Treguesit kryesorë fiskalë.*	*50*
Tabelë 7.	*Treguesit e bilancit të forcave të punës.*	*52*

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

II. Zhvillimet në ekonominë e jashtme
Grafik 1. Ndryshimet vjetore të çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar dhe të indeksit nominal të monedhave kryesore të shprehura në dollarë amerikanë. 18
Grafik 2. Ndryshimet vjetore të çmimeve sipas grup-mallrave kryesorë. 18
Grafik 3. Ecuria e normave bazë të interesit. 19
Grafik 4. Ecuria e kursit të këmbimit dhe e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare. 19

III. Stabiliteti i çmimeve dhe objektivi i Bankës së Shqipërisë
Grafik 5. Inflacioni vjetor (në %). 22
Grafik 6. Norma bazë e interesit (në %). 22
Grafik 7. Operacionet injektuese në treg të hapur të Bankës së Shqipërisë. 23
Grafik 8. Inflacioni vjetor dhe tremujor (në %). 23
Grafik 9. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje). 24
Grafik 10. Inflacioni vjetor sipas kategorive të mallrave dhe shërbimeve (në %). 25
Grafik 11. Inflacioni vjetor bazë dhe jo bazë (majtas); kontributet respektive (djathtas). 26
Grafik 12. Inflacioni vjetor sipas sektorëve (majtas); kontributet respektive (djathtas). 27
Grafik 13. Niveli i çmimeve të disa prej grupmallravetë indeksit të çmimeve të konsumit kundrej mesatares së EU-27 =100 (në %). 28
Grafik 14. Niveli i përgjithshëm i çmimeve dhe ai i dy prej grupmallrave të indeksit të çmimeve të konsumit kundrejt mesatares së EU-27 =100, në disa vende të rajonit (në %). 28

IV. Zhvillimet makroekonomike dhe ndikimi në Inflacion
Grafik 15. Ecuria e PBB-së (ndryshime vjetore dhe tremujore, grafiku majtas) dhe e treguesit të tendencës ekonomike, normës së shfrytëzimit të kapaciteteve (grafiku djathtas). 30
Grafik 16. Produkti i brendshëm bruto dhe kontributet e sektorëve në ecurinë vjetore të tij. 31
Grafik 17. Sektori i industrisë. Vlera e shtuar, treguesi i besimit, i porosive dhe i normës së shfrytëzimit të kapaciteteve. 31
Grafik 18. Ecuria e treguesve kryesorë të bilancit energjetik. 32
Grafik 19. Sektori i ndërtimit. Vlera e shtuar, treguesi i besimit, i porosive dhe i normës së shfrytëzimit të kapaciteteve. 32
Grafik 20. Ecuria e indeksit të çmimit të banesave dhe qirasë (IÇB dhe IQB) dhe tregues të tërthorte për kërkesën dhe ofertën. 33
Grafik 21. Ecuria e raportit të IÇB me IQB. 33
Grafik 22. Sektori i bujqësisë, gjuetisë, pyjeve dhe peshkimit. Kontributi i sektorit në ecurinë vjetore të PBB-së dhe ecuria e prodhimit agroindustrial. 34
Grafik 23. Sektori i shërbimeve. Vlera e shtuar, treguesi i besimit, i kërkesës dhe normës së shfrytëzimit të kapaciteteve. 34
Grafik 24. Tregues përafrues të konsumit privat. 36
Grafik 25. Tregues përafrues të financimit të konsumit privat. 37
Grafik 26. Tregues përafrues të investimeve private. 38
Grafik 27. Mjetet, detyrimet dhe pasuria financiare neto e individëve në vend. 39
Grafik 28. Pasuria financiare neto e individëve në Shqipëri dhe në vendet e rajonit. 39
Grafik 29. Norma e rritjes së eksporteve, importeve dhe eksporteve neto realë (në %majtas) dhe kontributi i tyre në rritjen e eksporteve neto realë (në pp; djathtas). 40
Grafik 30. Ndryshimet vjetore të eksporteve neto (boshti majtas) dhe të indeksit REER (%; boshti djathtas). 41
Grafik 31. Kontributi i importeve e eksporteve ndaj ecurisë vjetore të deficitit tregtar (majtas) dhe bilanci tregtar (ndryshime vjetore në përqindje) (djathtas). 41
Grafik 32. Kontributi sipas kategorive në eksportet totale, në pikë përqindje (majtas); orientimi i eksporteve, në milionë euro (djathtas). 42

Grafik 33. Kontributi sipas kategorive në importet totale, në pikë përqindje (majtas); orientimi i importeve, në milionë euro (djathtas). 42
Grafik 34. Kontributet sipas zërave në deficitin korent (në pikë përqindje). 44
Grafik 35. Llogaria kapitale dhe financiare (flukse neto, në milionë euro). 44
Grafik 36. Shpenzimet buxhetore kumulative (korrente e kapitale) ndaj PBB-së, (në %, majtas) dhe ndryshimi vjetor i shpenzimeve buxhetore në % me kontributet përkatëse të shpenzimeve korente, kapitale e transfertave*, (në pp djathtas).* 45
Grafik 37. Ndryshimet vjetore në % të shpenzimeve tremujore sipas kategorive kryesore (grafikët nga e majta në të djathtë: shpenzime totale, shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale), dhe trendet e tyre përkatëse T1 '07- T3 '12.* 46
Grafik 38. Të ardhurat sipas dy grupeve kryesore në raport ndaj PBB-së, (majtas) dhe ndryshimi vjetor i të ardhurave totale me kontributet e dy kategorive kryesore në pp (djathtas), M3' 08- M9' 12. 47
Grafik 39. Ndryshimet vjetore në % të të ardhurave tremujore sipas kategorive kryesore (nga majtas djathtas: të ardhura totale, të ardhura tatimore dhe të ardhura nga TVSh-ja), dhe trendet e tyre përkatëse T1 '07- T3 '12. 48
Grafik 40. Deficiti buxhetor ndaj PBB-së (grafiku majtas) dhe deficiti primar në raport me PBB-në (grafiku djathtas), M3 '08- M9 '12.* 49
Grafik 41. Kombinimi i politikës fiskale e asaj monetare në rastin e Shqipërisë. 51
Grafik 42. Kombinimi i politikës fiskale e asaj monetare në EU 17. 51
Grafik 43. Tregues sasiorë të tregut të punës. 53
Grafik 44. Paga dhe vlerësimet për to në ekonomi. 54
Grafik 45. Treguesit e produktivitetit, të kostos së punës për njësi dhe të pagës mesatare reale (majtas); ndryshime vjetore (djathtas). 55
Grafik 46. Ndryshimet vjetore: IÇK dhe IÇP për prodhimet në tregun vendas; korrelacionet lineare. 56
Grafik 47. Indeksi "Presionet inflacioniste prej çmimeve të huaja"dhe inflacioni në vend (majtas, ndryshim vjetor), dhe kontributet e çmimeve të huaja dhe kursit të këmbimit (djathtas). 57
Grafik 48. Diferenciali ndërsektorial dhe kontributet përkatëse (grafiku djathtas). 58
Grafik 49. Treguesi i masës së ankorimit të pritjeve të inflacionit nga agjentë të ndryshëm të ekonomisë. 58
Grafik 50. Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në ekonomi (devijim nga mesatarja, grafiku majtas) dhe vlerësimet për punësimin (devijime nga mesatarja, grafiku djathtas). 59

V. Zhvillimet Monetare dhe Tregjet Financiare

Grafik 51. Kontributi i përbërësve të kërkesës dhe ofertës për para. 62
Grafik 52. Ecuria vjetore e agregatëve monetarë, shumëzuesi i parasë. 62
Grafik 53. Ecuria vjetore e depozitave sipas monedhës dhe maturitetit. 63
Grafik 54. Kontributet e depozitave të agjentëve ekonomikë në lekë dhe në valutë. 63
Grafik 55. Kredia për ekonominë sipas valutës. 64
Grafik 56. Kredia për sektorin privat ndaj PBB-së dhe rritja vjetore e saj. 65
Grafik 57. Zhvillimet në kredinë për biznese sipas qëllimit të përdorimit. 66
Grafik 58. Zhvillimet në kredinë për biznese sipas sektorëve të ekonomisë. 66
Grafik 59. Zhvillimet në kredinë për individë sipas qëllimit të përdorimit. 67
Grafik 60. Standardet e kredisë dhe kërkesa për kredi për bizneset (balanca neto). 68
Grafik 61. Standardet e kredisë dhe kërkesa për kredi për individët (balanca neto). 69
Grafik 62. Vëllimi mesatar tremujor i transaksioneve në tregun ndërbankar për maturitetin 1- dhe 7-ditor(në mld lekë). 70
Grafik 63. Ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar (majtas) dhe e diferencave të tyre nga norma bazë (djathtas). 71
Grafik 64. Ndryshimet e yield-eve dhe niveli i tyre (majtas) dhe diferenca midis maturiteteve (djathtas). 72
Grafik 65. Yield-et e letrave me vlerë të qeverisë në tregun primar (majtas) dhe struktura kohore e borxhit të brendshëm (djathtas). 72
Grafik 66. Normat e interesit për depozitat e reja në lekë (grafiku majtas) dhe ato në euro (grafiku djathtas). 73
Grafik 67. Normat e interesit për kredinë e re në lekë. 74
Grafik 68. Normat e interesit për kredinë e re në euro. 74
Grafik 69. Ndryshimet vjetore dhe tremujore të lekut në terma nominalë efektivë (NEER). 75
Grafik 70. Ecuria ditore e raportit euro/lekë, usd/lekë dhe euro/usd, gjatë tremujorit të parë të vitit 2012. 76

Grafik 71. Luhatshmëria e raportit usd/lekë dhe euro/lekë në terma tremujorë. 77
Grafik 72. Ecuria (indeks me bazë tetorin e vitit 2008) dhe luhatshmëria e raportit euro/lekë në krahasim me monedhat e Evropës Lindore-Qendrore dhe Ballkanit. 77
Grafik 73. Ecuria e hendekut te parasë dhe kreditit te brendshëm. 78
Grafik 74. Ecuria e diferencës së yield-ve dhe e presioneve në tregun valutor. 78

OBJEKTIVI

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Nxitja e investimeve afatgjata, ruajtja e fuqisë blerëse të parasë, rritja e eficiencës së shpërndarjes së fondeve në ekonomi dhe mbështetja e stabilitetit financiar janë disa nga përfitimet e një mjedisi ekonomik të karakterizuar nga stabiliteti i çmimeve. Ky stabilitet është kontributi më i madh që banka qendrore mund të japë në mbështetje të një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Në përputhje me strategjinë e saj të miratuar në Dokumentin e Politikës Monetare për periudhën 2012 -2014, Banka e Shqipërisë angazhohet në arritjen dhe ruajtjen e inflacionit vjetor në nivelin 3.0 për qind, me kufij tolerance +/- 1 pikë përqindje. Shpallja e objektivit sasior për inflacionin synon ankorimin e pritjeve të agjentëve ekonomikë dhe uljen e primeve të rrezikut.

Në përmbushje të këtij qëllimi dhe për të forcuar transparencën e saj, Banka e Shqipërisë përgatit dhe publikon Raportin e Politikës Monetare. Ky Raport është instrumenti kryesor i komunikimit të politikës monetare me publikun. Ai paraqet një tablo gjithëpërfshirëse të zhvillimeve më të fundit makroekonomike dhe faktorëve që kanë ndikuar dhe priten të ndikojnë në ecurinë e çmimeve të konsumit në vend.

Raporti i Politikës Monetare për tremujorin e tretë të vitit 2012 u miratua në 31 tetor 2012 nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Analiza ekonomike në këtë raport mbështetet mbi të dhënat më të fundit statistikore dhe cilësore në dispozicion, deri më 18 tetor 2012.

I. FJALA E GUVERNATORIT

Si pasojë e situatës së vështirë në të cilën gjendet ekonomia botërore, dhe veçanërisht në eurozonë, ekonomia shqiptare është përballur me një ambient botëror sfidues gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2012. Goditjet e ofertës, me origjinë të brendshme e të huaj, kanë përcaktuar profilin e rritjes ekonomike dhe kanë vazhduar të testojnë themelet makroekonomike dhe financiare të vendit. Gjatë kësaj periudhe, ekonomia shqiptare është përballur me një rritje të ngadaltë të kërkesës së huaj, me rritjen e primeve të rrezikut në tregjet financiare dhe me tendenca të uljes së ekspozimit ndaj ekonomisë shqiptare të disa agjentëve të tregut financiar. Këto zhvillime janë reflektuar gjithashtu në nivele të ulëta konsumi dhe investimesh në vend. Së bashku me reduktimin e stimulit fiskal përgjatë vitit 2012, ato kanë shkaktuar një kërkesë të zbehtë agregate dhe një rritje të ulët ekonomike gjatë tre tremujorëve të parë të vitit.

Pavarësisht ndikimit negativ në ritmet e rritjes ekonomike, stabiliteti financiar dhe makroekonomik i vendit rezultoi i qëndrueshëm. Ndonëse në prani të luhatjeve të kërkesës dhe të problemeve të ofertës, niveli i inflacionit në vend rezultoi i ulët dhe nën kontroll, duke reflektuar ndër të tjera edhe ankorimin e mirë të pritjeve të publikut rreth objektivit tonë prej 3%. Qëndrueshmëria e ekuilibrave fiskalë, përmirësimi i pozicionit të jashtëm të vendit, si dhe bilancet e shëndosha të sektorit real dhe financiar të ekonomisë, kanë forcuar më tej stabilitetin ekonomik dhe financiar të vendit gjatë kësaj periudhe.

Inflacioni mesatar vjetor i çmimeve të konsumit rezultoi 2.7% në tremujorin e tretë të vitit, duke shënuar një rritje graduale gjatë vitit. Shifra vjetore e inflacionit në këtë tremujor u formua më së shumti nga kontributi i shtuar i çmimeve të ushqimeve të papërpunuara dhe të mallrave të konsumit jo-ushqimor. Nga ana tjetër, zhvillimet në çmimet e kategorive të tjera të shportës janë shfaqur të qëndrueshme dhe me luhatshmëri të vogël. Analiza ekonomike dhe monetare konfirmon praninë e presioneve të dobëta inflacioniste nga ana e kërkesës. Zhvillimet në sektorin real të ekonomisë kanë kushtëzuar rritjen e kontrolluar të çmimeve të prodhimit brenda vendit. Këto tendenca reflektohen në pirjen rënëse të inflacionit bazë dhe në inflacioni e ulët të kategorisë së mallrave të patregtueshëm të shportës së konsumit. Gjithashtu, ecuria e çmimeve të konsumit vijon të reflektojë presionet të ulëta nga ana e elementeve të tjerë të kostove. Në veçanti, çmimet e huaja kanë qenë të ulëta dhe, në prani të qëndrueshmërisë relative të kursit të këmbimit, kanë përcjellë presione të ulëta të inflacionit të importuar.

Pas tkurrjes ekonomike në tremujorin e parë, ekonomia shqiptare ka regjistruar një rritje vjetore prej 2.0% në tremujorin e dytë. Rritja e aktivitetit ekonomik është gjeneruar nga sektorët e bujqësisë, të industrisë dhe nga

disa degë të sektorit të shërbimeve, ndërkohë që sektori i ndërtimit shënoi një rënie të fortë.

Nga këndvështrimi i kërkesës agregate, rritja ekonomike e tremujorit të dytë u mbështet më së shumti nga kërkesa e huaj, ndërsa kërkesa e brendshme vlerësohet të ketë mbetur e zbehtë. Shpenzimet konsumatore, ndonëse më të larta se në tremujorin e parë, nuk i janë rikthyer normave të rritjes së vitit të kaluar. Ecuria e këtij komponenti të kërkesës së brendshme vijon të ndikohet nga pasiguria e perceptuar, nga mungesa e dinamizmit në tregun e punës dhe, së fundi, edhe nga ngadalësimi i treguesit të të ardhurave të disponueshme. Të përballur me një kërkesë të ulët finale për produktet e tyre, si dhe në prani të kapaciteteve të pashfrytëzuara dhe të kushteve relativisht të shtrënguara të kreditimit, edhe investimet private kanë mbetur të ulëta.

Në veçanti, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, niveli i ulët i investimeve private ka pasqyruar edhe kërkesën e ulët të familjeve për banesa rezidenciale.

Shpenzimet publike dhe stimuli fiskal ka qenë gjithashtu i dobët si pasqyrim i natyrës konsoliduese të politikës fiskale dhe i respektimit të kufizimeve fiskale të përcaktuara në ligj. Procesi i konsolidimit fiskal, i bazuar më së shumti në reduktimin e shpenzimeve, ilustrohet nëpërmjet prirjes rënëse së ndjekur nga deficiti buxhetor përgjatë gjithë kësaj periudhe. Deficiti buxhetor rezultoi rreth 25.7 miliardë lekë gjatë nëntë muajve të parë të vitit, duke u ngushtuar me rreth 19% në terma vjetorë. Deri në muajin shtator, shpenzimet e realizuara janë rreth 0.2% më të ulëta se një vit më parë ndërkohë që të ardhurat buxhetore janë rritur me 2.3%.

Të dhënat mbi zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë tregojnë një përmirësim të ndjeshëm të pozicionit të jashtëm të vendit. Eksportet në vlerë kanë shënuar një rritje vjetore prej 6.7% gjatë tetë muajve të parë, në reflektim të moderimit të kërkesës së huaj dhe të ecurisë së çmimeve në tregjet botërore. Po për këtë periudhë, importet janë tkurrur me 0.9% në terma vjetorë. Këto zhvillime kanë rezultuar në ngushtimin vjetor me 5.4% të deficitit tregtar deri në muajin gusht, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e kërkesës agregate. Gjithashtu, rënia e fortë e deficitit të llogarisë korrente gjatë tremujorit të dytë është një sinjal pozitiv për qëndrueshmërinë afatgjatë të këtij treguesi dhe ndihmon në stabilizimin e kërkesës dhe ofertës për valutë në tregun e brendshëm.

Edhe zhvillimet në sektorin monetar konfirmojnë presione të ulta inflacioniste në ekonomi. Ekspansioni i mjeteve monetare ka shfaqur shenja ngadalësimi gjatë tremujorit të tretë, në reflektim të reduktimit të kërkesës së brendshme për para. Sjellja e kujdesshme e sektorit publik ka diktuar një kërkesë të ulët për mjete monetare, veçanërisht nga sistemi bankar. Nga ana tjetër, ecuria e ngadaltë e aktivitetit ekonomik dhe ekzistenca e kapaciteteve të lira duket të kenë kufizuar kërkesën për mjete monetare të agjentëve privatë të ekonomisë. Kredia për sektorin privat shënoi një rritje vjetore prej 5% në muajin gusht, duke ndjekur trajektoren ngadalësuese të nisur që në

gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011. Ecuria e muajve të fundit tregon se bankat janë më aktive në ndërmjetësimin në monedhën vendase ndërkohë që ato kanë ulur ndërmjetësimin në monedhë të huaj. Ky zhvillim është diktuar si nga gatishmëria e bankave për të investuar fondet në lekë ashtu edhe nga ndërgjegjësimi në rritje i agjentëve ekonomikë për rreziqet që mbart kreditimi në valutë.

Duke u ndalur në problemet e kreditimit, duhet theksuar se ecuria e dobët e kredisë i dedikohet në masën më të madhe kërkesës së ulët të agjentëve ekonomikë për mjete monetare. Megjithatë, edhe oferta e kredisë bankare paraqitet disi e shtrënguar. Sistemi bankar vijon të jetë i kujdesshëm në përzgjedhjen e projekteve që financon, si pasojë e rënies së cilësisë së portofolit të kredisë dhe e pasigurive të perceptuara për të ardhmen. Bankat kanë vazhduar të mbajnë kritere të shtrënguara kredi-dhënie, duke u shfaqur mjaft selektive në vlerësimin e planeve të biznesit dhe në përmbushjen e kërkesave për kredi. Në tërësi, Banka e Shqipërisë vlerëson se krijimi i një klime më pozitive do të ndihmonte në gjallërimin e kërkesës për kredi dhe të aktivitetit kreditues. Sistemi bankar i vendit mbetet i mirëkapitalizuar, likuid dhe i aftë për t'iu përgjigjur nevojave të ekonomisë me kredi. Megjithatë, brenda parametrave të kujdesit financiar, ai duhet të jetë më largpamës në vendimet e veta dhe më fleksibël në mbështetjen financiare të biznesit shqiptar.

Tregjet financiare janë karakterizuar nga prirje rënëse e normave të interesit gjatë tremujorit të tretë, të shoqëruar nga presione të ulëta likuiditeti dhe kanë reflektuar politikën monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë. Rritja e aktivitetit në tregun ndërbankar sugjeron për rritje të eficiencës së përdorimit të këtij tregu dhe është një premisë e mirë për zhvillimin e gjithë tregut monetar në Shqipëri. Gjatë kësaj periudhe, janë përcjellë më mirë sinjalet lehtësuese të politikës monetare në drejtim të uljes së yield-eve të letrave me vlerë të Qeverisë. Kjo përcjellje është favorizuar nga përfundimi i lëvizjeve strukturore në sistemin bankar dhe nga rënia e kërkesës të Qeverisë për financim. Normat e interesit të depozitave kanë vijuar gjithashtu të ulen, por sikurse reflektohet nga niveli i lartë i rritjes së depozitave këtë tremujor, ato nuk kanë frenuar rritjen e kursimeve financiare pranë sistemit bankar. Lehtësimi i kostove të financimit nuk ka gjetur përçim të plotë në segmentin e kredive për sektorin privat gjatë muajve korrik-gusht. Në veçanti, kostot shtesë që bankat kërkojnë për akordimin e kredisë së re mbeten ende të shtrënguara, në përgjigje të pasigurisë së perceptuar dhe të mekanizmit reagues të tyre për reduktimin e rrezikut në procesin kredidhënës.

Në prani të një panorame ekonomike të karakterizuar nga ecuria e ngadaltë aktuale dhe ajo e pritur e inflacionit dhe e kërkesës agregate, politika monetare thelloi natyrën e saj stimuluese në tremujorin e tretë. Në fund të muajit korrik, norma bazë u reduktua me 0.25 pikë përqindje, duke zbritur në nivelin minimal historik prej 4.0%. Kjo ishte ulja e pestë radhazi e normës bazë, që prej muajit shtator 2011. Paralelisht me të, Banka e Shqipërisë ka vazhduar të furnizojë sistemin bankar me likuiditetin e kërkuar, nëpërmjet operacioneve të saj të injektimit të likuiditetit me afate të ndryshme.

Zhvillimet e pritura në të ardhmen sugjerojnë se presionet inflacioniste mbeten të ulëta. Analizat dhe projeksionet tona arrijnë në përfundimin se aktiviteti ekonomik do të vijojë të mbetet nën potencial, duke ushtruar presione në kahun rënës mbi inflacion. Në të njëjtën kohë, edhe presionet e prodhuara nga faktorët e ofertës paraqiten të përmbajtur. Bazuar në ecurinë e deritanishme të faktorëve përcaktues të inflacionit dhe në projeksionet për ecurinë e tyre në të ardhmen, me një probabilitet prej 90%, inflacioni pas 12 muajsh pritet të luhatet në intervalin 1.2% – 3.4%. Zhvillimet e pritura ekonomike dhe në inflacion nënkuptojnë ruajtjen e natyrës stimuluese të politikës monetare, edhe gjatë periudhës së ardhshme. Banka e Shqipërisë mbetet e vëmendshme ndaj zhvillimeve të ardhshme dhe informacionit të ri, e gatshme për të reaguar në masën dhe në kohën e duhur në funksion të përmbushjes së misionit të saj ligjor.

II. ZHVILLIMET NË EKONOMINË E JASHTME

Ripërtëritja e ekonomisë botërore është ngadalësuar. Pas një fillimi premtues në tremujorin e parë të vitit 2012, ritmet e rritjes ekonomike janë zbehur gjatë muajve në vazhdim. Në tremujorin e dytë të vitit u vërejt një ngadalësim i rritjes në shumë nga ekonomitë e zhvilluara, ndërkohë edhe shtetet në zhvillim kanë shfaqur moderim të aktivitetit ekonomik. Rezultatet e vrojtimeve si dhe tregues paraprakë tregojnë se rritja ekonomike e brishtë do vazhdojë edhe në tremujorin e tretë, për tu forcuar pak në tremujorin e fundit. Tregjet financiare ndërkombëtare kanë vijuar të shfaqin paqëndrueshmëri, ndonëse vendimet politike dhe mekanizmat e aprovuar së fundmi nga organizmat kryesore kanë ndikuar pozitivisht në uljen e pasigurive. Në nivel botëror, normat e inflacionit kanë vazhduar të bien në muajt e fundit, të ndikuara kryesisht nga rëniet në çmimet e lëndëve të para dhe të mallrave.

II.1 RRITJA EKONOMIKE DHE BALANCAT MAKROEKONOMIKE

Pas gjallërimit të vërejtur në fillimin e vitit, ekonomia botërore ka ngadalësuar normat e rritjes në tremujorin e dytë. Ndrydhja e konsumit të brendshëm përbën një nga faktorët kryesorë të marra në analizë që ka ndikuar zhvillimet ekonomike në shumicën e shteteve. Ngjallja e tensioneve në tregjet financiare i ka shtuar pasiguritë për perspektivën afatmesme dhe ka kushtëzuar pjesë të konsiderueshme të kërkesës agregate në botë. Situata e brishtë e tregut të punës dhe nevoja për konsolidim të bilanceve në sektorët publik dhe privat kanë frenuar rigjallërimin e ekonomisë, duke larguar pritjet për një ripërtëritje të shpejtë. Ekonomitë në zhvillim kanë treguar ecuri ekonomike më të mirë, ndonëse problemet e sipërpërmendura janë reflektuar në uljen e ritmit të rritjes në shumë nga këto vende. Presionet inflacioniste janë paraqitur të përmbajtura në shumicën e ekonomive, duke reflektuar një kontribut rënës të çmimeve të lëndëve të para gjatë gjysmës së parë të vitit si dhe dobësim të presioneve nga ana e kërkesës.

Zhvillimet e ardhshme në ekonominë botërore rrethohen nga shumë faktorë pasigurie. Treguesit paraprakë dhe parashikimet e agjentëve ekonomikë mbështesin idenë se kjo performancë e ngadaltë do vijojë edhe në gjysmën e dytë të vitit, veçanërisht në Eurozonë.

Tabelë 1. Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë.

	Ndryshimi i PBB-së		Norma e papunësisë	Norma e inflacionit	
Shtetet	T2-12/ T1-12	T2-12/ T2-11	Gusht-12	Shtator-12/ Gusht-12	Shtator-12/ Shtator-11
ShBA	0.4	2.2	7.8	0.6	2.0
Eurozonë	-0.2	-0.4	11.4	0.7	2.6
Gjermani	0.3	1.0	5.5	0.0	2.1
Francë	0.0	0.3	10.6	-0.3	2.2
Mbretëria e Bashkuar	-0.7	-0.8	7.9[1]	0.4	2.2
Japoni	0.3	3.6	4.1	-0.3[2]	-0.4[2]

Burimi:BQE, FED, Eurostat dhe institutet statistikore përkatëse.

[1] *Intervali qershor-gusht 2012.*

[2] *Muaji gusht 2012.*

EKONOMIA E EUROZONËS

Ekonomia e Eurozonës është tkurrur gjatë tremujorit të dytë të vitit. Norma negative rritjeje janë regjistruar si në terma tremujorë (-0.2%) ashtu edhe në krahasim me vitin e kaluar (-0.5%). Të dhënat e publikuara së fundmi nga Eurostat, kanë treguar se ekonomia e Eurozonës vijon të vuajë dobësinë e kërkesës së brendshme, ecurinë e pafavorshme të tregut të punës, rritjen modeste të kreditimit të bizneseve si dhe situatën e brishtë në tregjet financiare. Kontributi pozitiv i eksporteve neto nuk ka arritur të zbusë ndikimin negativ të zërave të sipërpërmendur. Norma e papunësisë ka shënuar tjetër rritje (11.4%) në muajin gusht, duke konfirmuar situatën e vështirë e të vazhduar të tregut të punës në këtë rajon. Norma e inflacionit gjatë tremujorit të tretë[1] është ulur lehtas, duke qëndruar në nivelin 2.5%. Dinamika e prirjeve afatgjata të inflacionit tregon për presione inflacioniste të përmbajtura.

Tregues paraprakë dhe të tërthortë[2], për muajt korrik dhe gusht nuk japin sinjale të qarta për ecurinë e ekonomisë në tremujorin e tretë, ndonëse parashikimet e ekspertëve të BQE tregojnë për një vijim të trajektores aktuale edhe për pjesën e mbetur të këtij viti. Pritjet për një rritje pozitive janë zhvendosur në vitin 2013.

EKONOMIA E SHBA

Në tremujorin e dytë të vitit, ekonomia amerikane ka vijuar të rritet me ritme të ngadalta vjetore, të vlerësuara në 2.2%. Rritja e tremujorit të dytë është ushqyer kryesisht nga zgjerimi i shpenzimeve konsumatore dhe më pak nga rritja e eksporteve dhe e investimeve private. Nga ana tjetër, shpenzimet qeveritare dhe rritja e importeve kanë kontribuar negativisht në rritjen ekonomike. Në muajin shtator, norma e papunësisë ra në 7.8%, duke arritur vlerën më të ulët në katër vitet e fundit. Inflacioni vjetor shënoi një rritje të lehtë, në nivelin 2.0% gjatë muajit shtator.

---

[1] *Në këtë rast është llogaritur mesatarja e thjeshtë arihtmetike e inflacionit vjetor për tre muajt e tremujorit.*

[2] *Tregues të tillë si shitjet me pakicë, prodhimi industrial, matrikullimi i makinave dhe investimet fikse jo ndërtim.*

Nga të dhënat e tërthorta dhe paraprake për periudhën në vijim vijnë sinjale të paqarta; indeksi i besimit të biznesit vijon të tregojë vlera të ulëta, ndërkohë që ka sinjale pozitive nga tregu i banesave dhe indeksi i besimit të konsumatorëve. Këto të dhëna sugjerojnë se rritja ka vijuar të jetë e ngadaltë edhe në tremujorin e tretë të vitit. Rezerva Federale (FED) ka nisur programin e tretë të lehtësimit sasior (QE3), nëpërmjet të cilit FED do të mund të blejë obligacione të mbështetura nga kredi hipotekore për një periudhë të pacaktuar në periudhën në vijim deri në vlerën 40 miliardë dollarë në muaj.

EKONOMITË E VENDEVE BRIK

Performanca e ekonomisë në vendet BRIK, të cilat kanë njohur rritje të shpejtë në periudhat e mëparshme, është ngadalësuar në tremujorin e dytë të vitit.

Ekonomia e Brazilit është rritur vetëm me rreth 0.5% në terma vjetorë, kryesisht në reflektim të rënies së ndjeshme të eksporteve si pasojë e një kërkese të ulët botërore për prodhimet braziliane. Gjithashtu, edhe komponentet e tjerë të kërkesës agregate kanë shfaqur ngadalësim të ritmeve të rritjes në këtë tremujor. Qeveria braziliane ka ndërmarrë një paketë veprimesh stimuluese, e cila pritet të japë rezultate pozitive në tremujorët në vazhdim.

Në Rusi, aktiviteti ekonomik ka qëndruar në vlera pozitive, por më të ulëta se pritshmëritë. Në tremujorin e dytë të vitit, ekonomia u rrit në terma vjetorë me 4.1%, si pasojë e rritjes së investimeve dhe prodhimit industrial. Sektori i ndërtimit ka shënuar tkurrje. Pas 19 vjet negociatash, Rusia u pranua në Organizatën Botërore të Tregtisë. Kjo ngjarje pritet të nxisë investimet e huaja direkte, konkurueshmërinë dhe përmirësimin e kërkesës së brendshme. Shqetësimet për inflacionin në rritje bënë që Banka Qendrore e Rusisë të rriste normën e saj bazë me 0.25 pikë përqindje në muajin korrik.

Aktiviteti ekonomik i Indisë vazhdoi ngadalësimin e rritjes në tremujorin e dytë të vitit, duke arritur normën vjetore prej 4.2%. Kushtet e pafavorshme klimatike shkaktuan vështirësi në sektorin bujqësor, i cili përfaqëson të ardhurat kryesore në zonat rurale. Nga ana tjetër, investimet kapitale kanë vuajtur nga kreditimi i ulët. Normat e larta të inflacionit kanë detyruar bankën qendrore të mos lehtësojë politikën monetare.

Ekonomia e Kinës ka përjetuar një ngadalësim ekonomik për të shtatin tremujor radhazi. Rritja ekonomike vjetore ka qenë rreth 7.4% në tremujorin e tretë. Situata ekonomike e vështirë e partnerëve kryesorë tregtarë të Kinës,SHBA-së dhe Eurozonës, ka bërë që eksportet të kenë një frenim. Ecuri të dobët ka treguar edhe kërkesa e brendshme. Pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve shtetërore për të mbajtur në norma të larta rritjen ekonomike[3], institucionet kryesore financiare kanë rishikuar në ulje parashikimet e tyre të mëparshme për rritjen ekonomike në vitet 2012 dhe 2013.

[3] *Që prej muajit nëntor të vitit të kaluar Banka Qendrore e Kinës ka ulur tre herë rezervën e detyruar, ndërsa Qeveria ka miratuar një sërë paketash stimuluese që përfshijnë edhe projekte të mëdha infrastrukturore*

Tabelë 2. Disa tregues makroekonomikë për vendet BRIK.

Shtetet	Ndryshimi i PBB-së vjetore		Inflacioni vjetor	
	T1-2012	T2-2012	T3-2012	Shtator-12
Brazil	0.7	0.5	5.2	5.3
Rusi	4.6	4.1	3.8[1]	5.9[3]
Indi	5.3	4.2	10.1[1]	10.3[3]
Kinë	7.6[1]	7.4[2]	1.9	1.9

Burimi: OECD, institutet statistikore përkatëse.
[1] Të dhëna për T2-2012
[2] Të dhëna për T3-2012
[3] Të dhëna për gusht-12

EKONOMITË E RAJONIT

Ekonomia e Turqisë, në tremujorin e dytë, shënoi një rritje vjetore prej 2.9%, duke vijuar ngadalësimin e normës së rritjes. Ndonëse prodhimi industrial ka ardhur në rritje, investimet, shpenzimet konsumatore dhe sektori i ndërtimit kanë patur përkeqësim të ndjeshëm. Ekonomia italiane ka vijuar të qëndrojë në recesion, duke regjistruar një tkurrje ekonomike prej 2.6 % në terma vjetorë. Eksportet neto kanë ndikuar pozitivisht, ndërsa shpenzimet konsumatore dhe sektori i ndërtimit kanë vijuar ecurinë negative. Të dhëna të tërthorta për tremujorin e tretë tregojnë se aktiviteti ekonomik do të vijojë tkurrjen, por në terma më të moderuara se në tremujorët e mëparshëm. Ekonomia e Greqisë ka vijuar rënien ekonomike edhe në tremujorin e dytë, duke shënuar normën vjetore të rënies prej 6.5%. Shkurtimet e shpenzimeve qeveritare dhe kushtet e vendosura për paketat ndihmëse kanë ndikuar në rënien e shpenzimeve konsumatore, si edhe të investimeve private e publike. Në nivel të agreguar, investimet kanë regjistruar një rënie vjetore prej rreth 19%, të ndikuara dhe nga trysnia që shkakton paqartësia për të ardhmen. Ekonomia e IRJM-së ka vijuar tkurrjen ekonomike, duke shënuar një rënie vjetore prej 0.9% në tremujorin e dytë. Prodhimi industrial dhe sektori i ndërtimit kanë rënë, duke eklipsuar rritjen e shpenzimeve konsumatore.

Tabelë 3. Tregues ekonomikë për vendet e rajonit.

Vendet	Ndryshimi i PBB-së	Inflacioni vjetor	Norma e papunësisë
	T2:12/T2:11	Shtator-12	Gusht-12
Itali	-2.6	3.6	10.7
Greqi	-6.5	1.6	24.4[2]
ISHRJ Maqedoni	-0.9	5.3	31.2[1]
Serbi	-0.8	10.3	26.1[1]
Kroaci	-2.2	5.0	17.7[3]
Turqi	2.9	8.3	10.4
Kosovë	4.5[(2011)]	4.1	:
Shqipëri	2.0	2.6	13.3[1]

Burimi: Institutet statistikore përkatëse, FMN, EcFin, EuroStat;
[1] - T2 2012; 2- Qershor 2012; 3-Gusht 2012;
: Të dhëna të padisponueshme

II.2 ÇMIMET E MALLRAVE KRYESORE

Çmimi i naftës në tregjet ndërkombëtare ka ndjekur ecuri rënëse në tremujorin e tretë, ndonëse me amplitudë më të vogël se ajo e regjistruar në tremujorin e dytë. Mbështetur në treguesin evropian *Brent*, një fuçi naftë u tregtua mesatarisht me 109.6 dollarë amerikanë, duke shënuar një rënie prej 3.3% në terma vjetorë[4]. Krahasuar me tremujorin e kaluar, çmimi i naftës u shtrenjtua me 1.1%, duke reflektuar më së shumti ecurinë e ofertës botërore të këtij produkti. Kështu, sanksionet ekonomike-financiare ndaj Iranit, problemet lidhur me prodhimin në detin e Veriut dhe kushtet e këqija meteorologjike në Gjirin e Meksikës, sidomos gjatë periudhës korrik-gusht, mbeten faktorët kryesorë që influencuan ecurinë e çmimit të naftës për tremujorin në analizë.

Grafik 1. Ndryshimet vjetore të çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar dhe të indeksit nominal të monedhave kryesore të shprehura në dollarë amerikanë.



Burimi: FED, EIA.

Bazuar mbi indeksin Ice Brent Crude (FUT), kuotimet e këtij produkti tregojnë për një pirrje të lehtë rënëse të nivelit të çmimit të pritshëm për muajt në vijim. Kjo pritje formulohet në pasqyrim të vlerësimeve të analistëve për dobësim të kërkesës botërore për naftë dhe rritjen e ofertës nga ana e Arabisë Saudite për muajt e ardhshëm

Çmimet e mallrave kryesorë kanë vijuar pirrjen e tyre rënëse, të nisur që prej gjysmës së dytë të vitit 2011. Indeksi i mallrave ka ngadalësuar rënien vjetore në 4.6% në tremujorin e tretë, nga 8.7% të shënuar në tremujorin e kaluar. Të njëjtën dinamikë ka ndjekur edhe Indeksi i karburantit, i cili u reduktua mesatarisht me 1.2%. Në terma tremujorë, Indeksi i mallrave dhe Indeksi karburantit u shfaqën relativisht të pandryshuar.

Grafik 2. Ndryshimet vjetore të çmimeve sipas grup-mallrave kryesorë.



Burimi: FMN.

Periudha e gjatë e thatësirës këtë vit dhe përdorimi i drithërave për prodhimin e metanolit, veçanërisht në SHBA ndikuan në rritjen vjetore të Indeksit të Ushqimeve me 2.9%. Krahasuar me tremujorin e dytë, i njëjti indeks u zgjerua me 7.7%, duke përcjellë rritjen e vrullshme që shënoi ky tregues për muajin korrik[5]. Në muajt pasardhës, Indeksi i Ushqimeve nuk shfaqi luhatje të ndjeshme, duke asimiluar tkurrjen e ofertës për këto produkte në çmimet e korrikut. Shqetësimet rreth rritjes globale, ridimensionimi i kërkesës në nivel botëror, si dhe problematikat me borxhin sovran të Eurozonës duken të kenë prekur ecurinë e çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare.

[4] *Mesatarisht në tremujorin e dytë çmimi i naftës u ul me 7.6% nga një vit më parë*

[5] *Në muajin korrik të këtij viti, Indeksi i ushqime regjistroi një rritje të theksuar mujore prej 9.4% si pasojë e mungesës së thatësirës së tejzgjatur dhe reduktimit të të korrave veçanërisht ne SHBA.*

II.3 VENDIMET PËR NORMAT E INTERESIT DHE ECURIA E TREGJEVE FINANCIARE

Banka Qendrore Evropiane në fillim të muajit korrik vendosi uljen e normës bazë të interesit me 25 pikë bazë, duke e çuar atë në nivelin 0.75%. Bankat e tjera qendrore i kanë mbajtur të pandryshuara normat bazë të interesit, përkatësisht: Rezerva Federale në 0-0.25%, Banka e Anglisë në 0.5% dhe Banka e Japonisë në 0-0.1%.

Yield-et në tregjet financiare gjatë tremujorit të tretë kanë ndjekur një ecuri rënëse, ndonëse segmente dhe emetues specifikë kanë shfaqur vështirësi dhe janë karakterizuar nga prime rreziku në rritje. Kriza e borxhit në Eurozonë ka vijuar të jetë një nga shqetësimet kryesore për investuesit dhe agjentët e tregut. Nga ana tjetër, vendimet e marra nga BQE dhe institucionet e tjera kryesore financiare si dhe krijimi i disa mekanizmave automatikë të cilët synojnë uljen e rrezikut dhe shëndetin e euros në përgjithësi kanë dhënë frytet e tyre, duke influencuar në rënien e *yield*-eve të titujve të borxhit për shumë shtete të Eurozonës. Me normat bazë afër nivelit 0, bankat qendrore kryesore kanë drejtuar veprimin e tyre tek instrumentat "jo tradicional" të politikës monetare, duke i rinovuar ose zgjatur afatet e zhvillimit të tyre. Efekti i këtyre veprimeve i ka dhënë shtysë të mëtejshme rënies së përgjithshme të *yield*-eve gjatë kësaj periudhe. Në tregjet e parasë të Eurozonës, normat e kërkuara kanë vijuar të ulen, duke reflektuar uljen e normës bazë në fillim të muajit korrik si dhe likuiditetin e bollshëm të ofruar nga BQE-ja gjatë kësaj periudhe. Në tregjet kryesore të aksioneve në ShBA, Evropë dhe Japoni, ecuria e treguesve ka qenë pozitive dhe prirja e përgjithshme ka qenë rritëse. Sjellja e agjentëve financiarë është

Grafik 3. Ecuria e normave bazë të interesit.



Burimi: BQE, FED, Banka e Anglisë, Banka e Japonisë.

Grafik 4. Ecuria e kursit të këmbimit dhe e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare.



Burimi: BQE, Reuters.

ndikuar kryesisht nga zhvillimet në zgjidhjen e problemit të krizës së borxheve nga udhëheqësit e BE-së. Ndërkohë, rezultatet më pozitive sesa pritjet për një numër të konsiderueshëm kategorish biznesesh kanë mbështetur prirjen rritëse të aksioneve gjatë këtij muaji.

Në tregun e parasë, normat e interesit Euribor me afat 1-,3- 6- dhe 12-mujor kanë vijuar të ulen. Në muajin shtator ato shënonin përkatësisht 0.12%, 0.25%, 0.48% dhe 0.74% duke regjistruar një ulje mesatare[6] prej 0.37 pikësh përqindjeje nga muaji qershor. Norma e interesit Libor me afat 3-mujor për dollarin amerikan u ul lehtas në 0.35% gjatë kësaj periudhe. Në tregjet valutore në tremujorin e tretë, euro ka ndjekur një prirje të lehtë mbiçmuese ndaj shumicës së monedhave kryesore (dollarit amerikan, juanit, jenit japonez, frangës zviceriane).Ndonëse në terma tremujorë monedha evropiane ka humbur terren, në muajin shtator 1 euro u këmbye mesatarisht me 1.2856 dollarë amerikan duke u mbiçmuar 3.7% me muajin gusht edhe pse në terma vjetorë ai qëndron -6.6% më poshtë.

[6] *Ulja ka qenë përkatësishtt 0.16, 0.41, 0.45 dhe 0.48 pikë përqindje.*

III. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE OBJEKTIVI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Inflacioni mesatar vjetor në tremujorin e tretë të vitit 2012 rezultoi 2.7%, me një prirje në rritje krahasuar me dy tremujorët paraardhës dhe pranë parashikimit të Bankës së Shqipërisë. Ky zhvillim u përcaktua nga sjellja e çmimeve të ushqimeve. Vlerësimet tregojnë se faktori sezonal për çmimet e prodhimeve bujqësore shfaqi një shpërndarje të ndryshme nga historiku. Në tërësi, luhatjet e inflacionit përgjatë muajve të tremujorit të tretë u shkaktuan nga faktorë me ndikim afatshkurtër të krahut të ofertës dhe, në muajin e fundit, nga zhvillime të veçuara në çmimet e kategorisë së strehimit. Ndërkohë presionet inflacioniste nga ana e kërkesës kanë mbetur të dobëta, megjithë kahun lehtësuese të politikës monetare.

Skenarët bazë të parashikimit të inflacionit dhe të PBB-së përgjatë horizontit të transmetimit të politikës monetare, sugjerojnë praninë e presioneve të kontrolluara inflacioniste. Kjo si pasojë e vijimit të hendekut negativ të prodhimit dhe të prirjes jorritëse të pritjeve për inflacionin dhe të presioneve të jashtme të ekonomisë.

III.1 ECURIA E ÇMIMEVE TË KONSUMIT, PËRMBUSHJA E OBJEKTIVIT DHE POLITIKA MONETARE

Inflacioni mesatar vjetor në tremujorin e tretë të vitit 2012 rezultoi 2.7%, duke konfirmuar parashikimet për prirjen rritëse të tij në këtë periudhë. Mesatarja e inflacionit vjetor në harkun e katër tremujorëve të fundit shënoi nivelin 2.1%[7], duke qenë e krahasueshme me atë tremujorit të dytë dhe 1.5 pikë përqindje më e ulët se sa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Ndryshimi tremujor i IÇK-së shënoi vlerën - 0.7%, sa gjysma e rënies së shënuar një vit më parë. Zhvillimet mujore brenda tremujorit të analizës reflektuan ndikimin e dobët të veprimit të uljes sezonale të çmimeve të ushqimeve të papërpunuara. Ky fenomen u trashëgua nga vlerat e veçuara të inflacionit në fund të vitit 2011 dhe në fillimi të vitit aktual. E veçantë e këtij tremujori është inflacion negativ i nëngrupit të qirave në muajin shtator, 2012. Ky faktor reduktoi inflacionit total në këtë muaj me 0.2 pikë përqindje. Nëse indekset qirave do të kishin mbetur të njëjta me ato të muajit gusht, inflacioni i tremujorit të tretë do të ishte pranë nivelit 2.8%. Zhvillimi në tregun e qirave mbetet ende një sinjal i veçuar nga historiku i kësaj serie. Gjatë të njëjtit tremujor, efekti statistikor i bazës së lartë krahasuese të çmimeve të ushqimeve të përpunuara pushoi së vepruari, duke pastruar ritmet e rritjes së çmimeve përkatëse nga ky faktor me natyrë jo-ekonomike.

[7] *Tregues që sheshon konsiderueshëm luhatjet afatshkurtra të serisë duke dhënë një vlerësim për prirjen përgjatë vitit.*

Grafik 5. Inflacioni vjetor (në %).



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Prirja në rënie e inflacionit bazë dhe qëndrueshmëria relative e inflacionit të mallrave të patregtueshëm neto përgjatë nëntë muajve të parë të viti, pasqyrojnë zhvillimet në sektorin real të ekonomisë, nën ritmet e një kërkese të dobësuar. Krahas ecurisë së deritanishme të inflacionit, vijimi i shfrytëzimit nën nivelet historike të kapaciteteve prodhuese dhe i pranisë së kostove të ulëta të punës dhe të prodhimit në ekonomi, kanë ndikuar në ankorimin e pritjeve inflacioniste të agjentëve të tregut në afat të mesëm. Përmirësimet në treguesit e sektorit të jashtëm të ekonomisë përgjatë tetë muajve të parë të vitit, krahas sjelljes së qëndrueshme njëvjeçare të kursit të këmbimit, kanë ndihmuar në sheshimin e presioneve të jashtme inflacioniste.

Ecuria e faktuar e aktivitetit ekonomik në vend dhe analiza mbi balancën e rreziqeve inflacioniste mbështet vlerësimet dhe parashikimet për rritje ekonomike nën potencial, në një periudhë afatmesme. Respektimi i objektivave të qëndrueshmërisë së borxhit publik kushtëzon sjelljen konsoliduese të politikës fiskale dhe kontributin e ulët të saj në rritjen ekonomike. Konsumi dhe investimet private ruajnë nivele të ulëta, nisur nga pasiguritë për zhvillimet e ardhshme brenda dhe jashtë vendit. Nga ana tjetër, situata e vështirë ndërkombëtare pritet të ndikojë kërkesën e huaj, duke kufizuar kontributin e saj në rritjen ekonomike të vendit. Në të njëjtën kohë, këto zhvillime përkthehen në një balancë të kontrolluar të presioneve inflacioniste, duke përcaktuar një rritje të ngadaltë të çmimeve të konsumit në të ardhmen. Nisur nga këto gjykime, Banka e Shqipërisë ka vijuar të ruajë natyrën stimuluese të politikës monetare në tremujorin e tretë. Në fund të muajit korrik, norma bazë u reduktua me 0.25 pikë përqindje, duke zbritur në nivelin minimal historik prej 4.00%. Kjo ishte ulja e pestë radhazi e normës bazë që prej muajit shtator 2011. Vendimi i fundit synon të krijojë kushte të përshtatshme monetare për përmbushjen e objektivit të inflacionit në afatin e mesëm. Gjithashtu, në mungesë të stimulit fiskal, politika monetare lehtësuese ofron mbështetjen e duhur për stimulimin e kërkesës agregate në vend.

Grafik 6. Norma bazë e interesit (në %).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në mbështetje të nxitjes së kërkesës dhe të respektimit të objektivit për inflacionin, Banka e Shqipërisë ka vijuar të furnizojë sistemin bankar me likuiditetin e nevojshëm, duke mundësuar minimizimin e luhatshmërisë së normave të interesit në tregun ndërbankar dhe orientimin e tyre drejt normës bazë.

Natyra lehtësuese e vendimmarrjes së politikës monetare, vlerësohet të jetë transmetuar në mënyrë më të plotë në tregun ndërbankar dhe në atë primar gjatë periudhës korrik-shtator 2012. Në të ardhmen pritet që efektet e akumuluara të kësaj vendimmarrjeje të gjejnë një transmetim më të qartë në aktivitetin ndërmjetësues të bankave, në mbështetje të aktivitetit ekonomik dhe të konsumit në afat të mesëm.

Nën perspektivën afatmesme për praninë e rreziqeve të balancuara rreth stabilitetit të çmimeve, kushtet monetare pritet të ndikojnë në ngushtimin e hendekut negativ të prodhimit, të krijuar në fund të vitit 2009. Vlerësimet për balancën e rreziqeve, si për inflacionin ashtu edhe për rritjen ekonomike, mbeten subjekt i pasigurisë që shoqëron prej kohësh tregjet financiare dhe ato të çmimeve të lëndëve të para në rajon dhe në botë.

Grafik 7. Operacionet injektuese në treg të hapur të Bankës së Shqipërisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

III.2 ECURIA E INFLACIONIT SIPAS KATEGORIVE

Inflacioni mesatar vjetor prej 2.7%[8] gjatë tremujorit të tretë u formua në pjesën më të madhe (67%) nga kontributi në rritje i kategorive "Ushqime të papërpunuara" dhe "Mallra konsumi jo ushqimorë". Ndërkohë, kategoritë e tjera me peshë të rëndësishme në formimin e shifrës së inflacionit, si "Mallra me çmime të rregulluara" dhe "Ushqime të përpunuara" nuk kanë ndryshuar kontributin në inflacionin total për këtë tremujor.

Inflacioni i kategorisë "Ushqime të papërpunuara", gjatë 5 muajve të fundit, ka shënuar rritje të vazhdueshme[9], duke shfaqur një ecuri të ndryshme krahasuar me fundin e vitit të kaluar dhe fillimin e këtij viti. Gjatë tremujorit në analizë, inflacioni vjetor i kësaj kategorie (7.1%), pësoi një rritje me gati 10 pikë përqindje krahasuar me mesataren e periudhës dhjetor 2011- mars 2012. Efekti sezonal i kategorisë "Ushqime të papërpunuara", i cili e zhvendosi kurbën e inflacionit me disa pikë përqindje në kahun rënës sidomos në tremujorin e parë të vitit, nuk kontribuoi pothuajse fare në periudhën e verës për uljen e inflacionit. Çrregullimi i përbërësit sezonal të inflacionit, të kësaj kategorie shtoi presionet inflacioniste të kahut të ofertës. Kjo sjellje u materializua në një kontribut të shtuar prej

Grafik 8. Inflacioni vjetor dhe tremujor (në %).



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

[8] *Një vit më parë norma e inflacionit vjetor mesatar ishte 3.2%.*

[9] *Inflacioni i kësaj kategorie u rrit nga 0.2 % në muajin prill në 7.2 % dhe 7.0% në muajt gusht e shtator të vitit 2012.*

1.2 pikësh përqindjeje të nëngrupeve kryesore të perimeve dhe frutave (duke formuar 45%) në inflacionin total.

Grafik 9. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje).



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Kategoria "Mallra konsumi jo ushqimorë" vazhdoi të japë një kontribut të lartë (0.5 pikë përqindje) në krahasim me ecurinë historike. Megjithë shuarjen e pjesshme të efektit të rritjes së çmimit të karburanteve nga taksa e qarkullimit, zbatuar në shtatorin e vitit të kaluar, kjo kategori formoi një pjesë të konsiderueshme të inflacionit total. Krahas çmimeve të larta të karburanteve në tregjet e huaja, nënçmimi i monedhës vendase kundrejt asaj amerikane përforcoi rritjen e këtyre çmimeve gjatë muajve gusht dhe shtator.

Çmimet në kategorinë "Ushqime të përpunuara" rezultuan pothuajse të njëjta krahasuar me një tremujor më parë, si rezultat i qëndrueshmërisë së çmimeve të mallrave të kësaj kategorie në konjukturën globale dhe i kursit të këmbimit. Inflacioni vjetor i kësaj kategorie një vit më parë shënoi vlerën 8.8%, ndërkohë që gjatë këtij tremujori kjo vlerë u reduktua në 1.6%. Si rrjedhim, kontributi në inflacionin total ra në 0.4 pikë përqindje gjatë këtij tremujori. Në muajin shtator u vërejt rritja e çmimeve dhe e kontributit të kësaj kategorie në inflacion si rezultat i rritjes së çmimeve të duhanit dhe nëngrupit të vajrave dhe të yndyrave.

Ndryshimi vjetor i indeksit të mallrave dhe të shërbimeve me çmime të kontrolluara gjatë këtij tremujori arriti një nivel të ulët, për shkak të shuarjes së efektit të rritjes së çmimeve të disa mallrave dhe shërbimeve në përbërje të tij.

Tabelë 4. Kontributi vjetor i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje).

	T3-10	T4-10	T1-11	T2-11	T3-11	T4-11	T1-12	T2-12	T3-12
1. Ushqime të përpunuara (pp)	1.1	1.4	2.2	2.5	2.2	1.6	0.7	0.4	0.4
Bukë dhe drithëra (pp)	0.1	0.4	0.7	1.0	0.8	0.5	0.2	0.0	0.0
Alkool dhe duhan (pp)	0.2	0.2	0.5	0.4	0.4	0.4	0.1	0.1	0.1
2. Ushqime të papërpunuara (pp)	0.9	0.5	0.6	0.5	0.0	-0.1	-0.6	0.5	1.3
Fruta (pp)	0.3	0.1	0.2	0.4	0.2	0.3	0.3	0.3	0.5
Perime(pp)	0.1	-0.7	0.1	-0.4	-0.6	-0.7	-1.2	-0.1	0.7
3. Shërbime (pp)	0.1	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.2	0.2
4. Mallra me çmime të rregulluara (pp)	1.0	0.9	0.4	0.3	0.1	0.0	0.1	0.1	0.1
Lëndë djegëse dhe energji (pp)	0.4	0.4	0.2	0.3	0.2	0.1	0.0	0.0	0.0
5. Strehim (pp)	0.1	0.1	0.2	0.3	0.3	0.3	0.3	0.2	0.0
6. Mallra konsumi jo ushqimorë	0.3	0.2	0.6	0.5	0.4	0.6	0.6	0.4	0.5
7. Mallra konsumi afatgjatë (pp)	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.0	0.1	0.2
Indeksi i çmimeve të konsumit (v/v, %)	3.4	3.1	4.0	4.1	3.2	2.5	1.1	1.9	2.7

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Kategoritë e tjera vazhdojnë të ruajnë kontribut të ulët në inflacionin total. Megjithatë, një zhvillim i ri në inflacionin e muajit shtator 2012, u shënua nga nëngrupi i "Qirave", i cili zë një peshë të konsiderueshme në shportën e IÇK-së (10.7%). Rëniet mujore dhe vjetore, përkatësisht me -2.3% dhe -1.5%, gjatë këtij muaji, kanë ndikuar në luhatshmërinë dhe reduktimin e inflacionit total. Kjo ka bërë që kategoria "Strehim" të kontribuojë në reduktimin e inflacionit total me -0.2 pikë përqindje. Sjellja e inflacionit dhe e kontributit të nëngrupit të "Qirave", përbën një zhvillim nën mesataren historike të serisë që pas vitit 2003.

Grafik 10. Inflacioni vjetor sipas kategorive të mallrave dhe shërbimeve (në %).



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

III.3 PRIRJET KRYESORE TË INFLACIONIT

Inflacioni bazë vjetor[10] në tremujorin e tretë të vitit 2012 vijoi të ndjekë një prirje rënëse, duke arritur nivelin 1.3%, një ndër vlerat e ulëta historike. Në konfirmim të sjelljes së ndjekur në tremujorin e dytë, edhe tremujori në analizë u karakterizua nga reduktimi gradual i vlerave të inflacionit bazë, kundrejt rritjes mesatare të inflacionit total. Ky profil u përcaktua nga rritja e normave të inflacionit jobazë gjatë tremujorit të tretë, për shkak të dinamikës në rritje të çmimeve të prodhimeve bujqësore të stinës. Në tremujorin e tretë të vitit, komponentët bazë dhe jobazë formuan përkatësisht 34% dhe 66% të inflacionit total vjetor.

[10] *Mesatarja e thjeshtë e vlerësimeve sipas dy metodave, mesatares së reduktuar dhe asaj të përjashtimit të përhershëm. Për tremujorin e tretë të vitit 2012 rezultuan, përkatësisht, 1.1% dhe 1.5%.*

Grafik 11. Inflacioni vjetor bazë dhe jo bazë (majtas); kontributet respektive (djathtas).



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Ecuria e inflacionit në tremujorin e tretë të vitit aktual, vijoi të përcaktohet nga zhvillimet në sektorin e tregtueshëm të mallrave të shportës së IÇK-së. Për periudhën e analizuar, inflacioni vjetor i këtij sektori rezultoi 3.2%, nga 1.7% në tremujorin e dytë të vitit. Në vlerën e tij është materializuar më qartë intensiteti i presioneve inflacioniste me origjinë të huaj kombinuar me ato të prodhuara nga zhvillimet në kursin e këmbimit, veçanërisht kundrejt dollarit amerikan. Këta faktorë rritën lehtë inflacionin e sektorit përkatës gjatë muajve të tremujorit të tretë për shkak të peshës së ulët të karburanteve në shportën e IÇK-së si dhe asaj jodominante të dollarit amerikan në tregtinë e jashtme. Nga ana tjetër, mbiçmimi i lekut kundrejt euros ka lehtësuar luhatjet e inflacionit në pjesën më të madhe të artikujve të nën-shportës mbi të cilën llogaritet inflacioni i tregtueshëm. Inflacioni i tregtueshëm vlerësohet i qëndrueshëm gjatë muajve të këtij tremujori, me një kontribut prej 72% (1.9 pikë përqindje) në formimin e inflacionit total. Ky kontribut është i krahasueshëm me atë të një viti më parë, por dukshëm më i lartë se sa ai i tremujorit të kaluar.

Për të njëjtin tremujor, inflacioni vjetor i sektorit të patregtueshëm neto[11], kryesisht i shërbimeve të shportës së IÇK-së, rezultoi 1.9%, duke qenë më i ulët se sa tremujorët paraardhës dhe se sa mesatarja e tij historike (2.2%). Ky reduktim u shkaktua nga vlera e ulët e tij në muajin shtator (1.3%), si pasojë e rënies së çmimeve të qirave[12]. Kontributi vjetor i inflacionit të patregtueshëm neto në atë total, për tremujorin në analizë vlerësohet rreth 22% (0.6 pikë përqindje). Pjesa e mbetur e inflacionit u krijua nga zhvillimet në çmimet kryesore të rregulluara, ndikimi i të cilave në inflacionin e brendshëm qëndroi në minimumin historik.

[11] *Ky inflacion zhvishet nga efektet e çmimeve të rregulluara (fatura uji, energji elektrike dhe shërbime spitalore).*

[12] *Ky nën-grup zë peshë të lartë në shportën e IÇK-së (10.7%) dhe aq më tepër në nën-shportën e inflacionit të patregtueshëm neto (32.9%). Nëse në muajin shtator, indeksi i qirave do të kishte mbetur i njëjtë me atë të muajit paraardhës, atëherë inflacioni i patregtueshëm neto do të rezultonte rreth 2.1% për këtë muaj dhe rreth 2.2% për tremujorin e tretë këtij viti.*

Grafik 12. Inflacioni vjetor sipas sektorëve (majtas); kontributet respektive (djathtas).



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet e mësipërme tregojnë se presionet e shtuara inflacioniste në ekonomi janë përcaktuar nga goditjet afatshkurtra të krahut të ofertës së brendshme dhe të huaj, ndërkohë që presionet me natyrë të përhershme dhe ato të brendshme janë reduktuar.

Hapësirë informuese 1. Çmimet në Shqipëri në krahasim me ato në vendet e Bashkimit Evropian

Eurostat (Instituti i Evropian i Statistikave), duke filluar nga mesi i viteve 2000, publikon rezultatet e një vrojtimi të çmimeve në secilin vend anëtar, por edhe atyre kandidate, kundrejt mesatares së 27 vendeve që aderojnë në Bashkimin Evropian. Në muajin qershor 2012 u publikuan rezultatet më të fundit[13] që i përkasin luhatjes të çmimeve brenda grupeve të mallrave dhe shërbimeve të indeksit të çmimeve të konsumit për vitin 2011. Rezultatet e vrojtimit sugjerojnë që niveli i çmimeve në Shqipëri është pothuajse 50% e nivelit të çmimeve të 27 vendeve të Bashkimit Evropian. Ndër grupet më të rëndësishme të indeksit të çmimeve, niveli i çmimeve për grupin " Ushqime dhe pije joalkoolike" në Shqipëri rezulton rreth 70% e mesatares europiane, ndërkohë që çmimet e lëndëve djegëse, pagesës së energjisë elektrike, shërbimeve të transportit dhe pijeve alkoolike dhe duhanit gjenden pak më lart se 50% e mesatares së çmimeve. Nivelin më të ulët të çmimeve e gjejmë te grupi i shërbimeve (restorante dhe hotele) me gati 40% të mesatares, ndërkohë që çmimet janë më të larta në grupin e mallrave eletroshtëpiake, elektronikë dhe blerjesh mjetesh transporti, të cilat barazojnë dhe kalojnë çmimet mesatare në vendet anëtare të Bashkimit Europian.

Rezultatet e vrojtimeve në 4 vitet e fundit tregojnë se në përgjithësi niveli i përgjithshëm i çmimeve në vend nuk ka pësuar ndryshime të rëndësishme kundrejt mesatares europiane[14]. Kjo dukuri shpjegohet me faktin se grupi më i rëndësishëm i shportës së mallrave: "Ushqime dhe pije jo alkoolike"[15] është luhatur pak përreth

[13] *http://epp.eurostat.ec.europa.eu/*

[14] *Niveli i çmimeve luhatet në intervalin 50-53% të nivelit mesatar të çmimeve në vendet e Bashkimit Evropian. Gjithsesi, ky nivel është ulur nga 53% në vitin 2008 në 51% në vitin 2011.*

[15] *Ky grup zë rreth 39% të totalit të mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën inflacioniste.*

Grafik 13. Niveli i çmimeve të disa prej grupmallrave të indeksit të çmimeve të konsumit kundrejt mesatares së EU-27 =100 (në %).



Burimi: Eurostat (online data code:prc ppp ind).

Grafik 14. Niveli i përgjithshëm i çmimeve dhe ai i dy prej grupmallrave të indeksit të çmimeve të konsumit kundrejt mesatares së EU-27 =100, në disa vende të rajonit (në %).



Burimi: Eurostat (online data code:prc_ppp_ind).

mesatares evropiane[16]*. Ndërkohë, rënie ka në mënyrë të veçantë në grupmallrat "Veshje" (nga 90% në vitin 2008 ka kaluar në 72% në vitin 2011), "Pije alkoolike dhe duhan" (nga 57% në 50%) , "Pajisje elektronike" (nga 122% në 108%), " Shërbime transporti" (nga 55 % në 42%) dhe "Komunikimi" (nga 94% në 87%). Rritje ka patur ndërkohë në grupet "Pajisje elektroshtëpiake" (nga 88% në 98%) dhe "Energji dhe lëndë djegëse (nga 55% në 56%).*

Në përgjithësi, studimi më i fundit, e rendit Shqipërinë në vendin e parafundit të vendeve më pak të kushtueshme të zonës evropiane. Në nivel më të detajuar, në krahasim me vendet e rajonit dhe ato të lindjes, niveli i çmimeve në Shqipëri për dy nga grupmallrat kryesorë "Ushqime dhe pije joalkoolike" dhe "Lëndë djegëse dhe energji"[17]*, është më i lartë se në disa nga këto vende. Për grupin e parë, niveli i çmimeve në masën 70% të mesatares europiane lë pas vende të tilla si Maqedonia, Bullgaria, Rumania, Polonia. Për grupin e dytë, niveli 55% i Shqipërisë është më i lartë se ai i Malit të Zi, Rumanisë, Serbisë dhe i barabarte me atë të Bullgarisë. E njëjta dukuri*[18] *vërehet edhe në çmimet e mallrave "Pajisje elektroshtëpiake dhe elektronike" dhe "Blerje pajisjesh transporti", ku niveli i çmimeve është nga më të lartët e gjithë vendeve të marra në studim (37)*[19]*. Ndërkohë shumë poshtë mesatares evropiane janë niveli i çmimeve në grupet "Shërbime në mjete transporti" dhe "Shërbime hotele dhe restorante", të cilat janë mesatarisht më të ulëtat në gjithë vendet që aderojnë apo synojnë të aderojnë në Bashkimin Evropian*[20]*.*

16 *Në 4 vitet e fundit është luhatur rreth vlerës 70%.*

17 *Këto dy grupmallra zënë rreth 50% të shportës së indeksit të çmimeve të konsumit.*

18 *Krahasimi për këto grupe mallrash mund të zgjerohet me të gjithë vendete marra në vrojtim (37 gjithsej).*

19 *Përkatësisht 98% dhe 108% për grupin "Pajisje elektroshtëpiake dhe elektronike" dhe 98% për "Blerje pajisjesh transporti".*

20 *Çmimet në dy grupet "Shërbime në mjete transporti" dhe "Shërbime hotele dhe restorante" janë rreth 58% poshtë çmimeve mesatare europiane.*

IV. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE DHE NDIKIMET NË INFLACION

Zhvillimet makroekonomike gjatë pjesës së parë të vitit 2012 kanë pasqyruar nga njëra anë stabilitetin makroekonomik dhe përmirësimin e primeve të rrezikut dhe, nga ana tjetër, aktivitetin e ulët ekonomik, kërkesën e zbehtë agregate dhe presionet e dobëta inflacioniste nga sektori real dhe ai monetar. Pas tkurrjes në tremujorin e parë, ekonomia shqiptare iu kthye normave pozitive të rritjes ekonomike, duke regjistruar një rritje vjetore prej 2.0% të prodhimit të brendshëm bruto në tremujorin e dytë. Përmirësimi i kërkesës agregate u mbështet kryesisht nga kërkesa e huaj, ndërsa konsumi dhe investimet brenda vendit qëndruan në nivele të ulëta. Pavarësisht këtij përmirësimi, rritja ekonomike mbetet e ulët dhe e pamjaftueshme për të vënë plotësisht në përdorim kapacitetet prodhuese të ekonomisë. Këto kushte të ekonomisë së brendshme kanë përcaktuar rritjen e dobët të çmimeve të faktorëve të prodhimit në vend. Presione të përmbajtura inflacioniste janë përcjellë edhe nga ekonomia e jashtme, të kushtëzuara si nga stabiliteti i monedhës vendase dhe nga presionet e ulëta inflacioniste në vendet partnere. Inflacioni i çmimeve të konsumit në prani të pritjeve të ankoruara inflacioniste, ka qëndruar brenda intervalit rreth objektivit të Bankës së Shqipërisë.,.

Parashikimet dhe vlerësimet për horizontin afatmesëm tregojnë se ekonomia shqiptare do të ketë rritje pozitive ekonomike. Megjithatë, aktiviteti ekonomik do të mbetet poshtë potencialit, duke kushtëzuar presione të ulëta inflacioniste përgjatë harkut kohor të veprimit të politikës monetare.

IV.1 PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO DHE ECURIA E KËRKESËS AGREGATE

Aktiviteti ekonomik dhe kërkesa agregate u përmirësuan në tremujorin e dytë të vitit, pas tkurrjes së regjistruar në tre muajt e parë. Me ndalimin e veprimit të faktorëve të përkohshëm që ndikuan prodhimin e disa prej sektorëve, prodhimi i brendshëm bruto shënoi rritje vjetore me rreth 2.04% në tremujorin e dytë. Vlera e shtuar u gjenerua kryesisht nga sektori i shërbimeve, ndërkohë që sektori prodhues kontribuoi negativisht, por në masë më të vogël se në tremujorin e parë.

Nga ana e kërkesës, rritja ekonomike e këtij tremujori u formua më së shumti nga kontributi pozitiv i eksporteve neto. Krahas rritjes së eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, ngushtimi i deficitit të eksporteve neto u diktua kryesisht nga rënia vjetore e importeve në reflektim të plogështisë së kërkesës së brendshme. Konsumi dhe investimet private ruajnë nivele të ulëta, të kushtëzuara nga pasiguria e lartë, nga kushtet relativisht të shtrënguara të financimit dhe nga hapësirat e pakta për stimul fiskal.

Grafik 15. Ecuria e PBB-së (ndryshime vjetore dhe tremujore, grafiku majtas) dhe e treguesit të tendencës ekonomike, normës së shfrytëzimit të kapaciteteve (grafiku djathtas).



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Vlerësimet paraprake për pjesën e mbetur të vitit sugjerojnë për vazhdimësinë e një rritjeje të ulët ekonomike, brenda një mjedisi me pasiguri të lartë. Rritja ekonomike vlerësohet të vijojë të mbështetet nga eksportet, por zgjerimi i tyre pritet të jetë më i ngadaltë në reflektim të ambientit të vështirë ekonomik në vendet partnere tregtare. Nga ana tjetër, kërkesa e brendshme vlerësohet të ruajë nivelet e ulëta, e ndikuar nga pirja për të kursyer dhe hezitimi për të investuar. Kushtet monetare janë të lehtësuara dhe materializimi i plotë i efekteve të politikës monetare do të krijonte një ambient më stimulues për konsumin dhe investimet private.

IV.1.1 ECURIA E PRODHIMIT SIPAS SEKTORËVE

Gjatë tremujorit të dytë të vitit, prodhimi i brendshëm bruto u zgjerua me 2% në terma vjetorë dhe me rreth 0.9% në terma tremujorë. Kontribues kryesor në rritjen ekonomike të këtij tremujori rezultuan degët e bujqësisë dhe të shërbimeve të tjera[21], përkatësisht me 1.4 dhe 1.3 pikë përqindje. Në total, sektori prodhues ndikoi negativisht në rritjen e prodhimit të brendshëm bruto, me 0.1 pikë përqindje, ndërsa performanca e sektorit të shërbimeve e zgjeroi atë me 2.1 pikë përqindje. Niveli i ulët i treguesve të besimit për ekonominë në total sugjeron vijimin e një rritjeje të ulët të aktivitetit vendas edhe gjatë tremujorit të tretë.

Në tremujorin e dytë të vitit, sektori i industrisë e ndërpreu rënien e shënuar në dy tremujorët e mëparshëm, kryesisht si pasojë e zgjerimit të eksporteve kryesore industriale. Vlera e shtuar e industrisë regjistroi rritje vjetore me 6.4%, një normë lehtësisht më e lartë se mesatarja historike prej 5.9%. Kjo tendencë

[21] *Degët e përfshira tek "Shërbimet e tjera" janë: "Ndërmjetësimi monetar dhe financiar", "Pasuritë e paluajtshme, dhënia me qira dhe aktivitete të lidhura me biznesin", "Administrimi publik, mbrojtja, sigurimet shoqërore", "Arsimi", "Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale", "Aktivitete të tjera të shërbimeve kolektive, sociale dhe individuale".*

pozitive u ndikua në një masë më të madhe nga dega e industrisë nxjerrëse, e cila kontribuoi me 4.67 pikë përqindje në zgjerimin e prodhimit industrial. Degët "Industri përpunuese" dhe "Energji elektrike, ujë dhe gaz" vlerësohet të kenë dhënë kontribute pozitive të ulëta, përkatësisht me 0.96 dhe 0.81 pikë përqindje.

Grafik 16. Produkti i brendshëm bruto dhe kontributet e sektorëve në ecurinë vjetore të tij.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Industria nxjerrëse gjeneroi një vlerë të shtuar rreth 32.5% më të lartë në tremujorin e dytë krahasuar me një vit më parë. Kategoria "Nxjerrja e produkteve energjetike" vijoi të ketë kontributin më të lartë në zgjerimin e vlerës së shtuar së industrisë nxjerrëse. Ndërkohë, tkurrja e industrisë përpunuese gjatë tremujorit të parë nuk vazhdoi në tremujorin pasues, duke pasqyruar ndikimin pozitiv më të lartë të aktiviteteve të metalurgjisë e përpunimit të metaleve. Megjithatë, rritja vjetore e vlerës së shtuar nga industria përpunuese me 1.3% mbetet e ulët, duke reflektuar kryesisht thellimin e rënies së industrisë tekstile dhe të lëkurës. Gjithashtu, pas kontraktimit për 5 tremujorë radhazi, vlera e shtuar e degës "Energji elektrike, ujë dhe gaz" regjistroi një rritje vjetore me 7.5% në tremujorin e dytë. Në linjë me përmirësimin e shënuar në tremujorin e dytë të vitit, bilanci i energjisë elektrike për periudhën korrik – gusht, tregon për rritje të prodhimit vendas. Krahasuar me vitin e kaluar prodhimi u rrit me rreth 41%. Përmirësimi i prodhimit në këto muaj, është pasqyruar në rritjen e eksporteve, ndonëse balanca e shkëmbimit vazhdon të mbetet negative.

Grafik 17. Sektori i industrisë. Vlera e shtuar, treguesi i besimit, i porosive dhe i normës së shfrytëzimit të kapaciteteve.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Grafik 18. Ecuria e treguesve kryesorë të bilancit energjetik.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Krahas zhvillimeve pozitive në sektorin e elektro-energjitikës, normat vjetore të rritjes së eksporteve industriale gjatë muajve korrik dhe gusht mbështesin zgjerimin e vlerës së shtuar në sektorin industrial edhe në tremujorin e tretë. Ndërkohë, treguesit e vrojtimeve për tremujorin e tretë japin sinjale të kundërta lidhur me ecurinë e sektorit të industrisë. Ndonëse me ritme të ulëta, vlerësohet një rënie e lehtë e treguesit të besimit, të porosive, të kërkesës dhe normës së shfrytëzimit të kapaciteteve në bizneset që veprojnë në këtë sektor.

Prodhimi në sektorin e ndërtimit vijoi të bjerë në tremujorin e dytë, duke mos mbështetur rritjen ekonomike të këtij tremujori. Vlera e shtuar nga ky sektor thelloi rënien vjetore në 18.4%, pas tkurrjes me 17.1% një tremujor më parë. Në terma kontributesh, kontraktimi i ndërtimit e uli rritjen ekonomike me 2.1 pikë përqindje. Shfrytëzimi i kapaciteteve në nivelin më të ulët të regjistruar dhe rënia e treguesit të kërkesës së referuar nga bizneset e përfshira në vrojtimin e besimit, vazhdojnë të mbeten faktorë me ndikim negativ në performancën e sektorit ndërtues.

Grafik 19. Sektori i ndërtimit. Vlera e shtuar, treguesi i besimit, i porosive dhe i normës së shfrytëzimit të kapaciteteve.



Burimi: BQE, Reuters.

Në tremujorin e tretë të vitit, rënia e treguesit të besimit në ndërtim sinjalizon për vazhdim të zhvillimeve negative, duke qenë në një linjë me nivelin minimal historik të lejeve të ndërtimit të akorduara[22] në gjysmën e parë të vitit[23]. Ndonëse treguesi i porosive për tremujorin e dytë dhe ai i normës së shfrytëzimit të kapaciteteve në tremujorin e tretë vlerësohen lehtësisht më mirë, përmirësimi i tyre gjykohet i ulët për të korrektuar pozitivisht prodhimin e sektorit ndërtues.

[22] *Ky tregues përgjithësisht paraprin zhvillimet në sektorin e ndërtimit.*

[23] *Burimi: Buletini statistikor tremujor.*

Hapësirë informuese 2. Çmimet në tregun e banesave për tremujorin e tretë, 2012.

Indeksi i çmimit të banesave[24] ka pësuar një rënie dyshifrore gjatë tremujorit të tretë të vitit. Ndryshimi vjetor nominal i këtij treguesi ishte -10.2% dhe i deflatuar me indeksin e çmimit të konsumit, ndryshimi vjetor real në këtë tremujor rezultoi -13.2%.

Indeksi i qirasë së banesave është karakterizuar nga norma pozitive rritjeje që nga tremujori i tretë i vitit 2011. Pasi u rrit me 2.3% në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, indeksi i qirasë ra me 2.2% në tremujorin aktual. I rregulluar për inflacionin, indeksi i qirasë ra me 5.5% në terma realë.

Grafik 20. Ecuria e indeksit të çmimit të banesave dhe qirasë (IÇB dhe IQB) dhe tregues të tërthorte për kërkesën dhe ofertën.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet në çmimet e banesave në tremujorin e tretë janë ndikuar në një masë më të madhe nga faktorët e kërkesës se sa nga ato të ofertës. Ngadalësimi i kërkesës për blerje banese është ndikuar nga besimi i ulët konsumator lidhur me zhvillimet në të ardhmen, ngadalësimi i të ardhurave të disponueshme, norma ende e lartë e papunësisë dhe kushtet e shtrënguara të kreditimit. Për sa i përket ofertës, tregues të tërthortë sasiorë dhe cilësorë prej vrojtimeve mbështesin vlerësimin për një ofertë të munguar për banesa të reja. Gjithashtu, standardet e akordimit të kredisë për sektorin e ndërtimit vijojnë të jenë të shtrënguara.

Zhvillimet në tregun e banesave tregojnë se çmimet e shitjes vijojnë të mbeten të larta krahasuar me marrjen e tyre me qira, mbështetur në analizën e raportit të indeksit të çmimit ndaj qirasë. Ky raport ka pësuar një ngadalësim të lehtë në tremujorin e tretë, megjithatë ai mbetet mbi mesataren e tij afatgjatë. Dinamika tremujore tregon për rënie si të çmimeve ashtu dhe të qirave të banesave në këtë tremujor. Rënia më e theksuar e çmimeve të banesave në krahasim me rënien e qirave, është reflektuar në uljen e raportit çmim/qira me 0.16 pikë përqindje krahasuar me nivelin e tremujorit të kaluar.

Grafik 21. Ecuria e raportit të IÇB me IQB.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[24] *Indekset e çmimeve dhe të qirasë së banesave ndërtohen vetëm për qytetin e Tiranës.*

Ecuria e prodhimit bujqësor u përmirësua në tremujorin e dytë, si krahasuar me mesataren afatgjatë të rritjes vjetore (3.7%) ashtu edhe me rritjen vjetore të shënuar një tremujor më parë (4.5%). Vlera e shtuar e prodhuar nga aktivitetet e bujqësisë, gjuetisë, pyjeve dhe peshkimit regjistroi rritje vjetore me 5.6%. Zgjerimi me ritëm të lartë i treguesit të prodhimit agroindustrial mbështeti performancën pozitive të sektorit të bujqësisë. Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, prodhimi i parashikuar bujqësor për vitin 2012 rezulton më i lartë se prodhimi bujqësor i faktuar një vit më parë.

Grafik 22. Sektori i bujqësisë, gjuetisë, pyjeve dhe peshkimit. Kontributi i sektorit në ecurinë vjetore të PBB-së dhe ecuria e prodhimit agroindustrial.



Burimi: INSTAT, MBUMK dhe Banka e Shqipërisë.

Vlera e shtuar e sektorit të shërbimeve vijoi të ngadalësojë ritmin e rritjes vjetore në 4.3% gjatë tremujorit të dytë, pas zgjerimit me 6.6% të shënuar një tremujor më parë. Zgjerimi me norma më të ulëta i prodhimit të gjeneruar nga sektori i shërbimeve reflektoi tkurrjen e aktivitetit në degët e transportit, hoteleve dhe restoranteve, si edhe ngadalësimin e rritjes së shërbimeve të tjera.

Grafik 23. Sektori i shërbimeve. Vlera e shtuar, treguesi i besimit, i kërkesës dhe normës së shfrytëzimit të kapaciteteve.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Dega e transportit dha një vlerë të shtuar rreth 7% më të ulët në terma vjetorë gjatë tremujorit të dytë, duke e thelluar rënien e nisur në fillimin e vitit. Të dhëna të disagreguara për transportin dëshmojnë për zhvillime më negative të aktiviteteve lidhur me transportin ajror dhe agjencitë e udhëtimit dhe turizmit[25]. Aktivitetet e hotelerisë e restoranteve gjithashtu regjistruan rënie vjetore të vlerës së shtuar në ekonomi me 5.9%, pas një ecurie pozitive në 2 vitet e fundit. Për sa i takon shërbimeve të tjera, vlera e shtuar nga këto aktivitete ngadalësoi ndjeshëm ritmin vjetor të zgjerimit, nga 11.2% në tremujorin e parë në 5.6% në tremujorin e dytë. Megjithatë, kjo normë rritjeje luhatet rreth mesatares historike të zgjerimit të shërbimeve të tjera, prej 5.3%. Ecuria e kësaj dege u ndikua kryesisht nga dinamika më e ngadaltë e aktiviteteve të lidhura me pasuritë e paluajtshme, me dhënien me qira dhe me shërbimet kundrejt bizneseve.

Aktivitetet tregtare përshpejtuan ritmin vjetor të rritjes në 7.6% gjatë tremujorit të dytë. Si rezultat, kontributi i tyre tek shërbimet në total u rrit në 2.2 pikë përqindje. Duke ju referuar të dhënave të shitjeve dhe të shifrës së afarizmit në vëllim, përmirësimi në prodhimin e tregtisë pasqyroi në masë më të madhe ecurinë e mirë të tregtisë me shumicë. Dega e postës dhe komunikacionit regjistroi gjithashtu ritëm pozitiv rritjeje prej 9.9%, i krahasueshëm me mesataren historike. Bazuar në të dhënat e tërthorta sasiore të shifrës së afarizmit, nëndega e komunikacionit u zgjerua me ritme më të larta krahasuar me nëndegën e postës, duke përcaktuar tendencën e degës së postë-komunikacionit[26].

Në tremujorin e tretë të vitit, rezultatet e vrojtimeve dëshmojnë për një rënie të treguesit të besimit në shërbime. Megjithatë, niveli pothuajse i pandryshuar i kërkesës së vlerësuar të bizneseve dhe rritja e normës së shfrytëzimit të kapaciteteve sinjalizojnë performancë pozitive në këtë sektor në tremujorin e tretë.

IV.1.2 ECURIA E KOMPONENTËVE TË KËRKESËS AGREGATE

Të dhënat e disponueshme për vlerësimin e kërkesës agregate tregojnë se përmirësimi i saj në tremujorin e dytë të këtij viti erdhi kryesisht nga performanca më e mirë e sektorit eksportues, ndërsa kërkesa e brendshme vijoi të ishte e dobët. Kontributi i shtuar i eksporteve neto vlerësohet të ketë balancuar kontributin e ulët të kërkesës së brendshme duke rezultuar në një rritje ekonomike prej 2.0%. Agjentët ekonomikë gjatë këtij viti kanë theksuar pirjen e tyre për kursim dhe mungesën e stimulit për investime, duke materializuar perceptimin e tyre për një mjedis ekonomik të pasigurt. Gjithashtu, politika fiskale mbetet e orientuar drejt konsolidimit fiskal në

[25] *Në tremujorin e dytë të vitit 2012, shifra e afarizmit në vëllim vijoi të tkurret me 26.7% në degën e transportit ajror dhe me 14.8% për aktivitetet e lidhura me agjencitë e udhëtimit dhe turizmit.*

[26] *Shifra e afarizmit e nëndegës së postës regjistroi rritje vjetore me 2.7% (mesatare historike vjetore 13.5%) gjatë tremujorit të dytë të vitit 2012, ndërkohë që shifra e afarizmit e dhënë në komunikacion shënoi zgjerim vjetor me 9.9% (mesatare historike vjetore 7.4%).*

funksion të qëndrueshmërisë afatgjatë të borxhit publik. Nga ana tjetër, kushtet monetare vlerësohen të jenë lehtësuese dhe përcjellja më e plotë e tyre tek agjentët ekonomikë do të përkthehej në një kërkesë të shtuar për ekonominë.

Rritja e konsumit privat ka qenë e dobët gjatë tremujorit të dytë të vitit 2012. Gjykuar mbi të dhënat indirekte të disponuara, rënia në konsumin e mallrave të konsumit të përditshëm dhe të shërbimeve të hotelerisë e restoranteve[27] është kompensuar pak nga rritja e konsumit të shërbimeve të tjera[28] dhe rritja e mallrave të qëndrueshëm. Në total, indeksi i tregtisë me pakicë në vëllim shënoi rënie vjetore prej 1.2% në tremujorin e dytë të vitit, megjithëse më të zbutur se sa rënia prej 8.3% në tremujorin e parë. Nga këndvështrimi i grupeve kryesore përbërëse, shpenzimet për pajisje shtëpiake dhe për blerje dhe mirëmbajtje të automjeteve kanë njohur rritje gjatë tremujorit të dytë të vitit. Prirja rritëse e shpenzimeve të konsumatorëve për automjete, nisur që nga tremujori i tretë i vitit 2011, është shoqëruar me rritjen e importit të tyre; numrin i automjeteve të importuara është më shumë se katërfishuar gjatë tremujorit të dytë të këtij viti, në krahasim me të njëjtin tremujor një vit më parë[29]. Një tjetër tregues sasior që përafron shpenzimet e përgjithshme të familjarëve është importi i mallrave të destinuar për konsum. Gjatë tremujorit të dytë, këto mallra shënuan rritje vjetore reale prej 2.7%.

Grafik 24. Tregues përafrues të konsumit privat.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Përsa i përket kanaleve të financimit të kërkesës konsumatore, tremujori i dytë i vitit dëshmoi një përmirësim të lehtë siç sugjerohet nga rritja, megjithëse e ulët, e treguesit të të ardhurave të disponueshme. Megjithatë, kjo e ardhur

[27] *Rënie vjetore e indeksit në volum të "artikujve të përzier, kryesisht ushqimorë, pije dhe duhan" dhe të "artikujve të përzier kryesisht jo ushqimorë në njësi tregtare jo të specializuara" në indeksin e tregtisë me pakicë dhe të vlerës së shtuar të gjeneruar nga sektori "Hotele dhe restorante" në PBB e tremujorit të dytë.*

[28] *Rritje vjetore reale prej 3.9% e vlerës së shtuar nga sektori i shërbimeve (përjashtuar aktivitetin e hotelerisë dhe restoranteve) në tremujorin e dytë të vitit 2012.*

[29] *Rritja e numrit të makinave të importuara reflekton në një pjesë efektin e masave fiskale.*

shtesë është kanalizuar drejt kursimeve në formën e depozitave dhe të letrave me vlerë të Qeverisë. Në lidhje me burimet e huazuara, kredia dhënë individëve për konsum ka ruajtur norma pozitive rritëse edhe gjatë tremujorit të dytë, në mbështetje të blerjeve të mallrave të qëndrueshëm.

Grafik 25. Tregues përafrues të financimit të konsumit privat.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

*) Tremujori i tretë është përafruar nga të dhënat vetëm për muajt korrik dhe gusht 2012.

Të dhënat me të fundit për tremujorin e tretë të vitit tregojnë për rritje të shpenzimeve konsumatore. Importi i mallrave për konsum është rritur në terma realë me 4.5% gjatë muajve korrik-gusht. Rritja e konsumit mund të jetë ndikuar nga përmirësimi i besimit konsumator gjatë tremujorit të tretë me 1.3 pikë përqindje.

Tregues indirektë nuk mbështesin rikuperimin e nivelit të investimeve private në ekonomi gjatë tremujorit të dytë të vitit. Zhvillimet e dobëta në këtë komponent të kërkesës agregate reflektojnë rënien e vazhduar të besimit të bizneseve dhe pasigurinë lidhur me kërkesën në të ardhmen. Një nga treguesit e tërthortë të investimeve private, importet në makineri dhe pajisje, kanë shënuar rënie reale 7.5% në tremujorin e dytë. Rënia e numrit të lejeve të ndërtimit të miratuara sugjeron për rënie të nivelit të investimeve në sektorin e ndërtimit. Niveli i investimeve në këtë sektor ndikohet negativisht edhe nga keqësimi i vazhduar i besimit të bizneseve dhe nga rënia e qëndrueshme e kërkesës/porosive të reja në këtë sektor. Investimet e huaja direkte ranë me 14.2% gjatë tremujorit të dytë, pasi patën shënuar rritje vjetore gjatë dy tremujorëve të mëparshëm. Financimi i investimeve private është mbështetur me kredi bankare gjatë tremujorit të dytë të vitit, ndonëse me ritme më të ngadalta.

Rritja vjetore reale 9.7% e importit të makinerive dhe pajisjeve për muajt korrik dhe gusht dhe rritja e shfrytëzimit të kapaciteteve në nivel ekonomie me 0.8 pikë përqindje gjatë tremujorit të tretë të vitit, sinjalizojnë rikuperim të lehtë të investimeve private për këtë periudhë. Nga ana tjetër, treguesit cilësorë nga vrojtimet e biznesit paraqesin një pamje më pesimiste në krahasim me

Grafik 26. Tregues përafrues të investimeve private.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

treguesit sasiorë. Treguesi për investimet të reja të kryera nga bizneset dhe treguesi për gjendjen e tyre financiare ka vijuar pirjen rënëse edhe gjatë tremujorit të tretë të vitit.

Të dhënat nga vrojtimet sugjerojnë për kontribut negativ në kërkesën agregate nga procesi i pakësimit të inventarëve në tremujorin e tretë. Gjatë vrojtimit të kryer gjatë këtij tremujori, balanca e inventarëve pësoi rënie me afërsisht 2 pikë përqindje, duke u ndikuar në një shkallë edhe nga pritjet negative për porosi të reja në tremujorit të katërt të vitit.

Hapësirë informuese 3. Ndryshimi i sjelljes konsumatore - Tregues nga pasuria financiare e individëve.

Në analizat tona periodike kemi sjellë vazhdimisht në vëmendje ecurinë e dobët të konsumit në vend në vitet e fundit, sjellje e cila ka reflektuar si zhvillimet në ekonominë e brendshme ashtu edhe ato të jashtme. Ndryshimi i sjelljes konsumatore gjatë kësaj periudhe pasqyrohet edhe në treguesit e pasurisë financiare të individëve. Pasuria financiare e individëve matet si diferenca e mjeteve me detyrimet e tyre financiare. Në rastin e Shqipërisë, mjetet financiare përfshijnë depozitat e individëve në sistemin bankar, investimet në bono thesari dhe mjete të tjera financiare të mbajtura në formën e parasë cash jashtë bankave. Ndërkohë, në vendet e tjera të EQL-së, për shkak të zhvillimit më të lartë të tregjeve financiare përfshihen dhe mjete te tjera financiare si investime në aksione, fonde pensioni, fonde të përbashkëta dhe letra të tjera me vlerë. Mjetet financiare përbëjnë një burim të ardhurash të rëndësishëm për individët, duke siguruar kështu përfitime në formën e dividentëve, pensioneve dhe interesave të ndryshme të paguara. Ndërkohë, detyrimet financiare përbëhen kryesisht nga kreditë bankare të individëve të marra për konsum dhe për blerje të pasurive të patundshme, e krahasueshme me vendet e rajonit në terma të llogaritjes së saj.

Pasuria financiare përbën një burim të rëndësishëm të pasurisë ekonomike[30] të individëve, duke luajtur rolin e një stabilizatori në kohë krizash dhe vështirësish ekonomike. Në kuadrin e pasigurive të krijuara për të ardhmen, sikundër vihet re edhe në krizën e fundit financiare globale, sjellja e individëve udhëhiqet nga një prirje e lartë për të kursyer, duke ulur njëkohësisht shpenzimet për konsum. Kjo prirje ndikon në rritjen e mjeteve të tyre financiare në raport me detyrimet, dhe për pasojë zgjerimin e pasurisë së tyre financiare.

Grafiku i përbri tregon se Shqipëria karakterizohet nga një raport i lartë i pasurisë financiare neto të individëve ndaj PBB-së. Pas një prirje rënëse të vënë re që nga viti 2006, dinamika e zhvillimeve në kohë vëren një tendencë në rritje në periudhën pas krizës globale të vitit 2008. Me përhapjen e efekteve të krizës globale në vend, agjentët ekonomikë u fokusuan në përmirësimin e bilanceve të tyre financiare. Kjo tendencë shpjegohet kryesisht me rritjen e mjeteve të tyre financiare, e cila dëshmon për ndryshim të sjelljes konsumatore të individëve në vend, të orientuar kryesisht drejt kursimit dhe me një përqasje të kujdesshme ndaj konsumit.

Në një masë më të ulët se rritja e mjeteve financiare, rënia e raportit të detyrimeve financiare ndaj PBB-së nga ana e ofertës reflekton kushtet e shtrënguara të kreditimit në kuadrin e përkeqësimit të cilësisë të portofolit të kredisë dhe përqasjen e kujdesshme të sektorit bankar në kreditimin e individëve gjatë kësaj periudhe. Nga ana tjetër, kërkesa e individëve për kredi mbetet e ulët, kushtëzuar nga zhvillimet në tregun e punës, rritja e pasigurive dhe perceptimi pesimist i të ardhmes.

Megjithatë, ky fenomen nuk duket të jetë thjesht një fenomen shqiptar. Sipas raportit të fundit të Unicredit, duket qartë se pas goditjes së parë nga kriza financiare në vitin 2008, e njëjta prirje vërehet edhe në vendet e tjera të rajonit si Bullgaria, Rumania, Kroacia dhe Çekia. Kjo sjellje është e pritshme pasi ashtu si dhe në Shqipëri, agjentët ekonomikë janë të prirur të rregullojnë bilancet e tyre financiare në periudhën gjatë dhe post-krizë, duke treguar kujdes në shpenzimet për konsum dhe me një prirje më të lartë drejt kursimit. Ndërkohë është vënë re e njëjta prirje rënëse e detyrimeve financiare në një pjesë të madhe të vendeve të rajonit, duke konfirmuar ritmet e ulëta të kreditimit të individëve edhe në këto vende. Vlera e lartë e pasurisë financiare krahasuar me vendet e rajonit është një tregues i përdorimit të ulët të levës financiare nga individët në Shqipëri.

Grafik 27. Mjetet, detyrimet dhe pasuria financiare neto e individëve në vend.*



*Të dhënat për vitin 2012 janë parashikime deri në fund të vitit.
Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

Grafik 28. Pasuria financiare neto e individëve në Shqipëri dhe në vendet e rajonit.



Burimi: Unicredit Group; Banka e Shqipërisë.

[30] *Pasuria ekonomike është një koncept më i gjerë i cili përfshin pasurinë financiare, pasuritë e patundshme si tokë, shtëpi etj.*

IV.1.3 KËRKESA E HUAJ DHE TREGTIA E JASHTME

Rritja ekonomike e tremujorit të dytë u formua kryesisht nga kontributi pozitiv i eksporteve reale neto[31]. Pavarësisht mjedisit të huaj jo të favorshëm, eksportet në mallra dhe shërbimeve shënuan rritje reale prej 11.7% në tremujorin e dytë. Nga ana tjetër, importet reale për mallra dhe shërbime u tkurrën në terma vjetorë me rreth 4.8% në pasqyrim të kërkesës së dobët në vend. Rrjedhimisht, deficiti i eksporteve neto në terma nominalë dhe realë u ngushtua në krahasim me nivelin e tremujorit të dytë të vitit të kaluar, duke kontribuar pozitivisht në rritjen e kërkesës agregate. Rritja e eksporteve reale u diktuara më së shumti nga zgjerimi i eksporteve në mallra (24.3%), kryesisht të kategorisë "Lëndë djegëse, energji". Nga ana tjetër, kërkesa e huaj për shërbimet vendase ka qenë e ulët duke rezultuar në rënien e eksporteve reale në shërbime (-2.1%). Përsa i përket kërkesës së brendshme për mallra dhe shërbime importi, ajo rezulton e tkurrur në terma realë si për mallrat (-2.3%) dhe për shërbimet (-10.9%).

Grafik 29. Norma e rritjes së eksporteve, importeve dhe eksporteve neto realë (në %majtas) dhe kontributi i tyre në rritjen e eksporteve neto realë (në pp; djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

Rritja e eksporteve reale neto në tremujorin e dytë duket të jetë ndihmuar edhe nga rënia e presioneve reale nënçmuese ndaj monedhës vendase, ashtu siç dëshmohet nga ecuria e treguesit REER[32]. Nënçmimi i lekut në terma realë me 2.0% për tremujorin e parë mbështeti përmirësimin e bilancit të eksporteve neto realë. Për tremujorin e dytë të vitit, leku në terma të REER-it u nënçmua me rreth 0.6%.

[31] *Për kalimin nga terma nominalë në terma realë të importeve dhe eksporteve të mallrave është përdorur Indeksi i Vlerës Njësi përftuar nga publikimet e INSTAT. Ndërsa, për importet dhe eksportet e shërbimeve është përdorur Indeksi i çmimeve Konsumit të kategorisë së shërbimeve, llogaritur nga Banka e Shqipërisë.*

[32] *Kursi real efektiv i këmbimit, REER, llogaritet si mesatare gjeometrike e ponderuar e indeksit të çmimeve vendase, krahasuar me çmimet në vendet partnere tregtare dhe e treguesit NEER. Rënia e indeksit do të tregonte një mbiçmim real, ndërsa rritja e tij nënkupton një nënçmim real të monedhës vendase.*

Të dhënat e pjesshme për tremujorin e tretë sugjerojnë për vijimësinë e ecurisë pozitive të eksporteve në mallra dhe për shenja rikuperimi të kërkesës së brendshme për mallra importi. Vlera e eksporteve në mallra është rritur mesatarisht rreth 19.4% përgjatë muajve korrik – gusht dhe vlera e importeve ka shënuar rritje të lehtë mesatare me rreth 0.5% për të njëjtën periudhë. Rrjedhimisht, deficiti tregtar është ngushtuar me rreth 8.9% në krahasim me një vit më parë. Raporti i mbulimit të importeve prej eksporteve rezultoi 39.5%, duke qëndruar rreth 6.3 pikë përqindje më lartë, krahasuar me raportin e muajve korrik-gusht të një viti më parë. Aktiviteti tregtar i vendit tonë, i matur prej shkëmbimeve tregtare me vendet partnere, u zgjerua me 5.2% në bazë vjetore.

Grafik 30. Ndryshimet vjetore të eksporteve neto (boshti majtas) dhe të indeksit REER (%; boshti djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 31. Kontributi i importeve e eksporteve ndaj ecurisë vjetore të deficitit tregtar (majtas) dhe bilanci tregtar (ndryshime vjetore në përqindje) (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Duke vijuar prirjen rritëse të nisur në muajin prill, eksportet në vlerë shënuan normën më të lartë prej 29.8% në muajin gusht. Kontributin kryesor në rritjen e eksporteve gjatë këtij muaji e dhanë eksportet në kategoritë "Lëndë djegëse dhe energji", me rreth 23.4 pikë përqindje. Brenda kësaj kategorie, kontribut të qenësishëm dha eksporti i naftës bruto, i cili përfaqësoi rreth 33.7% të eksporteve totale. Prirje pozitive rritëse vijuan të shfaqin eksportet e kategorisë "Mallra të përpunuar"[33], dhe të kategorisë "Lëndë të para, minerale", të cilët shënuan rritje vjetore përkatësisht me rreth 11.3% dhe 29.6%. Nga ana tjetër, kategoria "Mallra të tjerë të përpunuar", ku përfshihen kryesisht produktet tekstile me karakter ri-eksportues ka ruajtur prirjen rënëse dhe gjatë muajit gusht.

[33] *Produktet kryesore të eksportuara në këtë kategori janë metalet bazë të përpunuara të çelikut, gizës, hekurit dhe bakrit.*

Grafik 32. Kontributi sipas kategorive në eksportet totale, në pikë përqindje (majtas); orientimi i eksporteve, në milionë euro (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Importet në vlerë, gjatë muajit gusht shënuan një normë të lehtë rënëse prej 0.1%. Duke përjashtuar importet e energjisë elektrike, importet totale shënuan një rritje vjetore prej 1.4%. Kontributin kryesor prej 2.6 pikë përqindje në zgjerimin e importeve totale e dha importi i mallrave të përfshirë në kategoritë "Makineri dhe pajisje". Në anën tjetër, importet e kategorisë "Mallra të përpunuar" vijuan prirjen rënëse, duke kontribuar me rreth 1.7 pikë përqindje në rënien e importeve totale.

Grafik 33. Kontributi sipas kategorive në importet totale, në pikë përqindje (majtas); orientimi i importeve, në milionë euro (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shkëmbimet tregtare sipas drejtimit të tyre vijojnë të jenë të përqendruara me vendet e BE-së, të cilat mbuluan mesatarisht 65.8% të aktivitetit tregtar përgjatë 8-mujorit të parë të vitit 2012. Eksportet në vlerë, gjatë periudhës janar-gusht, u zgjeruan në nivel vjetor drejt vendeve të BE-së me rreth 13.8%. Vendet kryesore të BE-së ku eksportet tona shënuan rritje gjatë kësaj periudhe vlerësohen të kenë qenë Italia dhe Spanja. Në anën tjetër, eksportet drejt vendeve si Kina, Zvicra dhe Turqia shënuan rënie duke dhënë një kontribut

negativ prej 3.9% në terma kumulativë 8-mujor. Vendet anëtare të CEFTA-s dhanë një kontribut të lehtë pozitiv prej 0.3%. Ndërkohë, rënia e lehtë e importeve në vlerë gjatë 8-mujorit të parë të vitit ka ardhur kryesisht nga rënia e importeve me vendet anëtare të BE-së dhe CEFTA-s, respektivisht me rreth 4.4% dhe 1.3%. Importet nga vende si Kina, Zvicra, Turqia dhe SHBA-ja kanë shfaqur rritje gjatë periudhës së lartpërmendur duke dhënë një kontribut pozitiv në ecurinë e importeve totale drejt vendit.

Hapësirë informuese 4. Zhvillimet kryesore në bilancin e pagesave, T2- 2012.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2012, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi në rritje të mjeteve valutore, me rreth 7.5 milionë euro. Pozicioni neto i llogarisë korente regjistroi një deficit prej 196.6 milionë eurosh. Në terma vjetorë, deficiti korent u ngushtua me rreth 37.3%, duke u vlerësuar në 7.7% ndaj PBB-së nominale[34] *ose rreth 5.3 pikë përqindje më i ulët krahasuar me nivelin e tremujorit të dytë të vitit 2011.*

Tabelë 5. Treguesit kryesorë të bilancit të pagesave.

	T2 '11	T3 '11	T4 '11	T1 '12	T2 '12
Llogaria korente (në milionë euro)	-313.8	-244.1	-352.1	-249.3	-196.6
vmv	58.7%	1.8%	-1.2%	17.6%	-37.3%
/ PBB-së	-13.0%	-10.2%	-15.0%	-11.7%	-7.7%
Bilanci tregtar	-581.4	-593.1	-658.6	-465.3	-475.8
Eksporte, f.o.b.	330.8	344.1	360.0	325.8	394.2
Importe, f.o.b.	-912.2	-937.2	-1,018.6	-791.2	-870.0
Bilanci i shërbimeve	-6.2	116.7	41.2	8.4	28.8
Kredi	376.8	629.8	428.5	293.8	383.7
Debi	-383.0	-513.1	-387.3	-285.4	-354.9
Travel - net	-19.9	82.9	28.4	4.3	6.2
Bilanci i të ardhurave	13.7	14.1	14.5	-10.5	-6.6
Kredi	67.4	77.5	67.5	59.9	62.5
Debi	-53.7	-63.3	-53.0	-70.4	-69.1
Të ardhura nga IHD-neto	-10.2	-22.0	-7.9	-38.7	-22.9
Transferta korente	260.2	218.2	250.8	218.1	257.0
Kredi	287.6	245.6	279.1	241.5	299.8
Debi	-27.4	-27.5	-28.3	-39.5	-42.8
Dërgesa nga emigrantët -neto	190.4	153.8	188.7	159.5	178.6
Llogaria kapitale dhe financiare (mil euro)	192.0	227.6	277.1	254.4	171.3
vmv	2.4%	29.1%	-32.6%	10.4%	-10.7%
/ PBB-së	7.9%	9.5%	11.8%	11.9%	6.7%
Llogaria kapitale	31.5	6.5	27.8	12.9	44.7
Llogaria financiare	160.5	221.1	249.3	241.5	126.7
A. Detyrime	283.0	413.3	390.7	304.0	269.7
IHD	212.5	160.1	289.7	200.3	182.2
Inv. portofoli	11.1	11.1	11.4	14.4	13.2
Inv. të tjera	59.4	242.1	89.6	89.3	74.3
B. mjete	-122.5	-192.3	-141.3	-62.5	-143.1
IHD	-1.7	-3.9	-19.8	-3.4	-7.7
Inv. portofoli	-26.2	-57.1	14.4	-61.0	8.4
Inv. të tjera	-94.6	-131.2	-135.9	1.8	-143.7
Gabime dhe harresa	120.1	72.9	68.8	-1.9	32.8
Mjetet e rezervës	1.7	-56.4	6.2	-3.2	-7.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

[34] *PBB-ja nominale e përdorur për periudhën 2003- 2010 është ajo e publikuar nga Instat-i. Për vitin 2011 është përdorur një vlerësim për PBB-në nominale mbështetur në atë reale dhe normën e inflacionit.*

Grafik 34. Kontributet sipas zërave në deficitin korent (në pikë përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Dinamika e llogarisë korente gjatë këtij tremujori u ndikua gjerësisht prej ecurisë së bilancit tregtar dhe llogarisë së shërbimeve. Përmirësimi i kombinuar i pozicionit të tyre neto krahasuar me të njëjtin tremujor një vit më parë kontribuoi gjerësisht në ngushtimin e deficitit korent. Ngushtimi i deficitit tregtar në mallra me rreth 18.2% në terma vjetorë si dhe suficiti i llogarisë së shërbimeve rezultoi ngushtimin e deficitit të eksporteve neto me rreth 23.9% në nivel vjetor. Bilanci neto i llogarisë së të ardhurave rezultoi në deficit prej 6.6 milionë eurosh, kryesisht si pasojë e rritjes së fluksit dalës të të ardhurave nga investimet e huaja direke. Suficiti i llogarisë së transfertave korente u ngushtua me rreth 1.2% në terma vjetorë. Nënzëri kryesor i kësaj llogarie, transfertat neto prej emigrantëve, shënoi rënie prej 6.2% në terma vjetorë. Raporti i tyre kundrejt deficitit tregtar vlerësohet në nivelin 37.5% ose rreth 4.8 pikë përqindje më i ulët se raporti i financimit i regjistruar në të njëjtën periudhë një vit më parë.

Grafik 35. Llogaria kapitale dhe financiare (flukse neto, në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Flukset kapitale dhe financiare (neto) regjistruan një bilanc pozitiv prej 171.3 milionë eurosh gjatë tremujorit të dytë të vitit 2012. Suficiti i kësaj llogarie rezultoi rreth 10.7% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe arrin në rreth 6.7% të PBB-së. Gjatë tremujorit të dytë, suficiti i llogarisë kapitale dhe financiare arriti të financojë me rreth 87.1% deficitin korent. Fluksi hyrës i investimeve të huaja direkte shënoi rënie me rreth 14.3% në terma vjetorë. Investimet e portofolit neto shënuan vlerën e 21.6 milionë euro gjatë tremujorit të dytë të vitit 2012 duke shënuar një kthim në suficit nga deficiti i regjistruar për të njëjtën periudhë një vit më parë. Ndryshimi në terma vjetorë në investimet e portofolit neto erdhi si pasojë e rënies në investimet e portofolit të rezidentëve në ekonomitë e huaja.

Llogaria e investimeve të tjera neto, e ndikuar kryesisht nga rritja e mjeteve të rezidentëve ndaj jorezidentëve, regjistroi një deficit prej 69.4 milionë euro gjatë tremujorit të dytë të vitit 2012. Rënia e fluksit të huamarrjes si dhe rritja e monedhave dhe depozitave të sistemit bankar vendas në ekonomitë e huaja, çuan në rritjen e mjeteve të ekonomisë vendase.

Stoku i rezervës valutore në fund të periudhës shënoi nivelin 1,930.93 milionë euro. Ky nivel vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 4.5 muajve importi të mallrave dhe të shërbimeve.

IV.1.4 TREGUESIT FISKALË DHE POLITIKA FISKALE

Politika fiskale është orientuar drejt një procesi konsolidimi fiskal, duke u faktuar në një trajektore rënëse të ndjekur prej deficitit buxhetor gjatë 9 muajve të parë të vitit 2012. Procesi i konsolidimit fiskal deri në fund të 9-mujorit të parë të këtij viti duket se është mbështetur kryesisht në reduktimin e shpenzimeve buxhetore. Rënia e tyre gjatë kësaj periudhe është diktuar nga

nivele më të ulëta të shpenzimeve kapitale, duke u përkthyer në një kontribut më të ulët të investimeve publike për rritjen e kërkesës agregate. Nga ana tjetër, ritmet e ulëta të rritjes vjetore për të ardhurat buxhetore sugjerojnë një ambient ekonomik më të brishtë, krahasuar me një vit më parë.

Politika fiskale e kushtëzuar nga hapësirat fiskale të disponueshme, ka sjellë për pasojë një nivel shpenzimesh më të ulët nga një vit më parë. Më konkretisht, totali i shpenzimeve deri në fund të tremujorit të tretë të vitit rezultoi rreth 270.6 miliardë lekë, duke u tkurrur me rreth 0.2% në terma vjetorë nominalë[35]. Të vlerësuara në terma të PBB-së shpenzimet ishin rreth 26.9%, duke regjistruar raportin më të ulët të pesë viteve të fundit. Shpenzimet korrente dhe ato kapitale vlerësohen përkatësisht në 22.7 dhe 4% të PBB-së.

Grafik 36. Shpenzimet buxhetore kumulative* (korrente e kapitale) ndaj PBB-së, (në %, majtas) dhe ndryshimi vjetor i shpenzimeve buxhetore në % me kontributet përkatëse të shpenzimeve korente, kapitale e transfertave*, (në pp djathtas).



*Kumulative brenda harkut të një viti buxhetor. Psh, raporti i shpenzimeve për 6-mujorin është ndërtuar si shpenzime buxhetore për periudhën janar-qershor ndaj PBB-së së vlerësuar për të njëjtën periudhë.
**Në zërin e transfertave përfshihet zëri "Huadhënie KESH" dhe "Kthimi i huas nga KESH".
Burimi: Ministria e Financave, INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Shpenzimet korente deri në fund të muajit shtator u realizuan me rreth 228.4 miliardë lekë, duke qëndruar kështu në një nivel rreth 2% më të lartë në terma vjetorë nominalë. Normat rritëse për shpenzimet korrente gjatë këtij viti janë përcaktuar kryesisht nga nivelet më të larta të shpenzimeve për sigurime shoqërore. Kategoritë e tjera të shpenzimeve, si ato për ndihmë shoqërore dhe ato për personelin, ndonëse në masë modeste, kanë ndikuar pozitivisht rritjen e shpenzimeve korente përgjatë periudhës së analizuar. Ndërkohë, impakt të kundërt, por në të njëjtën masë me dy kategoritë e mësipërme mbi ecurinë e shpenzimeve korente kanë shfaqur shpenzimet për pushtetin lokal, si edhe ato për subvencione.

Shpenzimet kapitale deri në fund të tremujorit të tretë rezultuan rreth 40.2 miliardë lekë, nivel ky rreth 15% më i ulët nga e njëjta periudhë një vit më parë. Mënyra e financimit të tyre ka ndryshuar trajtë nga fillimi i vitit, duke shfaqur një rritje progresive të peshës së burimeve të huaja.

[35] *Duke përjashtuar kredinë për KESH totali i shpenzimeve për 9-mujorin rezulton 0.9% më i ulët në terma vjetorë*

Grafik 37. Ndryshimet vjetore në % të shpenzimeve tremujore* sipas kategorive kryesore (grafikët nga e majta në të djathtë: shpenzime totale, shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale), dhe trendet e tyre përkatëse T1 '07- T3 '12**.



*Tek totali i shpenzimeve nuk është përfshirë zëri " Huadhënie neto për KESH".
**Trendi për ndryshimet vjetore të secilit prej zërave të shpenzimeve/ ardhurave të paraqitura në grafikët sipas rradhës është ndërtuar duke iu referuar mënyrës së korrektimit me Tramo/Seats.
Burimi: Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë.

Për sa i përket shpërndarjes së shpenzimeve buxhetore përgjatë tremujorëve, tremujori i dytë ka mbartur nivelin më të lartë të tyre, ndërkohë në tremujorin e parë e të tretë janë realizuar nivele pothuajse të njëjta shpenzimesh. Kjo mënyrë shpërndarjeje për shpenzimet është e ndryshme nga trajta historike e saj, ku tremujori i parë mbart peshën më të ulët të totalit të shpenzimeve[36]. Ecuria e shpenzimeve kapitale, pavarësisht peshës së ulët në totalin e shpenzimeve (rreth 15%), ka përcaktuar kahun e ndryshimit të shpenzimeve totale përgjatë 3 tremujorëve.

Të ardhurat buxhetore për 9 muajt e parë të vitit 2012 ishin rreth 244.9 miliardë lekë, duke qëndruar në një nivel rreth 2.3% më të lartë në terma vjetorë nominalë. Ritmi i rritjes së të ardhurave është ngadalësuar krahasuar me fundin e gjashtëmujorit të parë të vitit, në reflektim të një niveli më të ulët të të ardhurave me karakter jo-tatimor. Ndërkohë të ardhurat tatimore sikurse dhe në gjysmën e parë të vitit kanë vijuar të rriten me ritme të ngadalta, pavarësisht faktit se politika tatimore në thelb ka qenë e ngjashme me atë të një viti më parë[37].

Të ardhurat totale për 9 muajt e parë të vitit u vlerësuan në rreth 24.4% të PBB-së, duke regjistruar një nivel rreth 0.9 pikë përqindje nën mesataren e 5 viteve më të fundit. Të ardhurat tatimore, deri në fund të tremujorit të tretë të vitit u vlerësuan rreth 22.4% e PBB-së, ose rreth 0.7 pikë përqindje nën mesataren e harkut kohor 5-vjeçar. Nga ana tjetër, të ardhurat jo-tatimore dhe grantet për 9-mujorin e parë të vitit të vlerësuara në raport ndaj PBB-së ishin 1.8 dhe 0.2%.

[36] *Përjashtim bën vetëm viti 2011, gjatë tremujorit të parë të cilit u realizuan rreth 33% e shpenzimeve të faktuara për 9 muajt e parë të vitit.*

[37] *Vlejnë të përmenden dy ndryshime që ka pësuar paketa fiskale në fuqi gjatë këtij viti buxhetor, e që lidhen me: (i) disa ndryshime dhe amendime në ligjin " Për taksat kombëtare"; si edhe (ii) me miratimin e ligjit të ri " Për akcizat" në kuadër të përafrimit të legjislacionit tatimor të Shqipërisë me Direktivat dhe Rregulloret e Bashkimit Evropian.*

Grafik 38. Të ardhurat sipas dy grupeve kryesore në raport ndaj PBB-së, (majtas) dhe ndryshimi vjetor i të ardhurave totale me kontributet e dy kategorive kryesore në pp (djathtas), M3' 08- M9' 12.



Burimi: Ministria e Financave, INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Të ardhurat tatimore për periudhën në fjalë rezultuan rreth 225.2 miliardë lekë, rreth 2.4% më të larta nga një vit më parë, me një kontribut prej 2.2 pikë përqindje në rritjen e totalit të të ardhurave. Rritja e të ardhurave totale i dedikohet zhvillimeve në zërin e taksave kombëtare[38], i cili ka regjistruar ritme mjaft të larta rritjeje vjetore (49%), ndryshe nga sjellja e tij historike. Ecuria e të ardhurave nga taksat kombëtare i dedikohet kryesisht masave fiskale që kanë synuar rritjen e taksës së qarkullimit për karburantet, ndryshimin e mënyrës së arkëtimit të rentës minerare, si edhe zhvendosjen e kategorisë së ambalazheve të qelqit e plastikës nga mallra subjekt akcize në grupin e mallrave të taksës kombëtare[39].

Të ardhurat nga TVSH-ja, të cilat zënë peshën më të lartë në totalin e të ardhurave (rreth 35%) dhe njëkohësisht përafrojnë ecurinë e konsumit në vend, vijojnë të shënojnë ritme të ngadalta rritjeje vjetore. Ato shënuan rritje vjetore me rreth 1.6% Ecuria e ngadaltë e tyre reflekton një vlerë importesh më të ulët nga një vit më parë[40]; qëndrueshmëri relative të kursit të këmbimit[41]; ecuri më të përmirësuar se sa ajo e gjysmës së parë të vitit për prodhimin e mallrave dhe shërbimeve në vend[42], rritje

[38] *Taksat kombëtare kontribuuan me rreth 3.0 pikë përqindje, në rritjen prej 2.3% të totalit të të ardhurave për këtëperiudhë kohore.*

[39] *Taksa e qarkullimit nga 1 janari u përcaktua në 7 lekë për litër, nga 5 lekë që ishte në shtator 2011. Përcaktimi i rentës minerare sipas ndryshimeve më të fundit (VKM 201 dt.21.03.2012) bëhet sipas një vlere tregu për mineralet, e cila bazohet në një listë me vlera referuese sipas normativave teknologjike të miratuara nga një komision ad-hoc. Ndërsa ligji i ri i akcizave, i cili hyri në fuqi në gusht 2012, krahas eleminimit të kategorisë së ambalazheve, në ndryshim nga ai i mëparshmi solli një gamë më të zgjeruar për produktet energjetike dhe pijet alkoolike (nëpërmjet një detajimi më të zgjeruar të tyre sipas intervaleve në bazë të përqindjes së alkoolit).*

[40] *Importet në vlerë për 8-mujorin janë tkurrur me rreth 0.9% në terma vjetorë.*

[41] *NEER për 9 mujorin 2012 shënoi një ndryshim vjetor prej -0.38%.*

[42] *TVSH-ja e mbledhur nga tatimet duke filluar që nga muaji shkurt 2010 (periudhë që prej të cilës disponohen të dhënat)e deri në korrik 2012, ka kontribuuar negativisht në rritjen e totalit të TVSh-së. Në të kundërt, TVSh-ja e mbledhur mbi prodhimin e mallrave e shërbimeve në vend, në fund të tremujorit të tretë të vitit kontribuoi pozitivisht me 0.3 pp në totalin e TVSh-së së mbledhur për të njëjtën periudhë. Bazuar në të dhënat më të fundit për TVSh-në sektoriale, duket se ecuria e përmirësuar e TVSH-së buron nga një aktivitet më i përmirësuar në sektorët e tregtisë dhe atë të shërbimeve.*

të eksporteve[43], si edhe efekte të rregullimeve specifike lidhur me mënyrën e pagesës së TVSH-së për importin e mallrave kapitalë.

Ndërkohë, tatimi mbi fitimin, tatimi mbi të ardhurat personale, akcizat, si edhe të ardhurat nga pushteti lokal janë realizuar në nivele më të ulëta nga një vit më parë, duke dhënë në këtë mënyrë një kontribut negativ (përkatësisht me 1.1, 0.1, 0.3 dhe 0.2 pikë përqindje) në rritjen e totalit të të ardhurave buxhetore. Ritmet negative të rritjes së të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale janë kombinim i rënies nga një vit më parë i të ardhurave nga tatimi mbi shitjen e pasurisë[44] me ritme më të moderuara rritjeje vjetore të të ardhurave mbi pagat, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Zërat tatimorë të lidhura ngushtë me ecurinë e aktivitetit ekonomik në vend, siç janë të ardhurat nga TVSH-ja, akcizat, tatim fitimi dhe tatimi mbi të ardhurat personale janë rritur me ritme nën mesataret e tyre afatgjata. Në mungesë të masave fiskale që mund të ndryshojnë normën e taksave, mënyrën e taksimit apo bazën tatimpaguese, ecuria e dobët e tyre reflekton ndër të tjera një aktivitet ekonomik të ngadaltë gjatë këtij viti buxhetor.

Grafik 39. Ndryshimet vjetore në % të të ardhurave tremujore sipas kategorive kryesore (nga majtas djathtas: të ardhura totale, të ardhura tatimore dhe të ardhura nga TVSh-ja), dhe trendet e tyre përkatëse T1 '07- T3 '12.



Burimi: Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë.

Profili i rritjes së të ardhurave tatimore paraqitet pothuajse i njëjtë përgjatë tremujorëve, me një përmirësim të lehtë në tremujorin e tretë të vitit. Nga ana tjetër, zhvillimet në zërin e të ardhurave jo-tatimore, krahas luhatshmërisë së lartë të shfaqur përgjatë tremujorëve, kanë përcaktuar kahun e ndryshimit të të ardhurave totale si në tremujorin e dytë ashtu dhe në atë të tretë të vitit.

[43] *Eksportet në vlerë për 8-mujorin 2012 janë rritur me rreth 6.7% në terma vjetorë. Për rrjedhojë dhe rimbursimi i TVSH-së ka qenë më i lartë nga një vit më parë, duke sjellë një normë rritjeje vjetore të TVSH-së neto rreth 0.7 pp më të ulët se ajo në terma bruto.*

[44] *Ky zhvillim pasqyron efekt bazë, si pasojë e të ardhurave të larta të akumuluara një vit më parë nga rivlerësimi i aseteve pas hyrjes në fuqi të ligjit "Për faljen e pjesshme të detyrimeve tatimore e doganore".*

Deficiti buxhetor për 9-mujorin e parë të vitit 2012 rezultoi rreth 25.7 miliardë lekë, duke u vlerësuar në rreth 2.6% të PBB-së. Konsolidimi fiskal i shprehur në terma sasiorë ka konsistuar në një reduktim prej 0.7 pikësh përqindjeje të deficitit buxhetor në krahasim me një vit më parë. Trajektorja rënëse e ndjekur prej deficitit buxhetor që prej shkurtit të këtij viti, ka reflektuar kryesisht zhvillimet në kahun e shpenzimeve buxhetore. Në fund të 9-mujorit deficiti buxhetor rezultoi rreth 19% më i ulët nga një vit më parë.

Grafik 40. Deficiti buxhetor ndaj PBB-së (grafiku majtas) dhe deficiti primar në raport me PBB-në (grafiku djathtas)*, M3 '08- M9 '12.



*Grafiku djathtas është ndërtuar duke marrë në konsideratë shumën rrëshqitëse të deficitit primar 3-mujor (duke përfshirë 4 tremujorë) në raport ndaj PBB-së kumulative për tremujorë.
Burimi: Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë.

Mënyra e financimit të deficitit buxhetor paraqitet brenda kuadrit të saj tradicional, me një mbështetje të madhe në instrumentet e brendshme të huamarrjes. Kështu, emetimi i letrave me vlerë të Qeverisë ka formuar rreth 70% të financimit të deficitit të përgjithshëm buxhetor[45]. Për sa i përket ndarjes së huamarrjes së brendshme sipas maturitetit, instrumentet afatgjata kanë dominuar kundrejt atyre afashkurtra. Kërkesa e pjesëmarrësve në tregun primar të letrave me vlerë, e përqendruar më së shumti në disa prej instrumenteve (bono thesari 12-mujore, obligacione 3-, 5- dhe 7-vjeçare) duket se ka diktuar dhe politikën e huamarrjes së Qeverisë përgjatë kësaj periudhe. Në këtë kontekst, shtimi i huamarrjes së brendshme ka konsistuar në bono thesari 12- mujore, si edhe obligacione 3-, 5- dhe 7-vjeçare, duke ulur por jo në të njëjtën masë peshën e financimit me instrumente afatshkurtra si bono thesari 3 dhe 6-mujore.

Rritja e portofolit të letrave me vlerë afatgjata përbën një faktor pozitiv në funksion të uljes së rrezikut të rifinancimit të borxhit, duke i shërbyer njëkohësisht një profili më të përmirësuar të shlyerjes së borxhit. Nga ana tjetër, ecuria e përmirësuar e balancës primare e vërejtur sidomos gjatë dy tremujorëve të fundit, është faktor me ndikim pozitiv mbi dinamikën e borxhit publik në të ardhmen. Megjithatë ky i fundit, krahas zhvillimeve në balancën primare, mbetet nën ndikimin e ecurisë së normave të interesit të paguara mbi borxhin publik, rritjes reale ekonomike, garancive të ndryshme publike, si edhe zhvillimeve në kursin e këmbimit.

[45] *Gjendja e likuiditetit të qeverisë, e cila kalon me shenjë (-) në financimin e deficitit, në fund të 9-mujorit përbënte rreth 24% të deficitit buxhetor.*

Tabelë 6. Treguesit kryesorë fiskalë.

	9M 2012		Ndryshim vjetor, në %		
	Mld lekë	% e PBB	9M 2010	9M 2011	9M 2012
Të ardhura totale	244.9	24.4	7.2	1.2	2.3
Tatime dhe dogana	173.7	17.3	5.7	2.7	2.6
TVSH	86.1	8.6	3.9	0.5	1.6
Tatim fitimi	12.7	1.3	2.2	16.9	-16.6
Akciza	28.4	2.8	10.4	1.7	-2.6
Të ardhura personale	20.3	2.0	-1.6	2.9	-0.9
Taksa nacionale	21.6	2.2	36.6	7.2	49.1
Pushteti lokal	8.8	0.9	-8.8	5.9	-4.4
Kontribute për sigurime shoqërore	42.7	4.2	5.4	5.8	2.7
Jo-tatimore	17.6	1.7	34.6	-19.6	0.8
Grante	2.1	0.2	9.2	-10.3	3.2
Shpenzime totale	270.6	26.9	-3.3	3.9	-0.2
Shp. korente	228.4	22.7	8.5	3.6	2.0
Personeli	50.8	5.0	5.1	3.7	2.5
Interesa	29.0	2.9	17.3	-4.0	0.6
Operative dhe mirëmbajtje	23.7	2.4	12.8	3.8	-1.9
Shp. për sigurime shoqërore	88.1	8.8	9.7	7.7	5.5
Shp. pushteti lokal	19.4	1.9	-8.3	-4.2	-6.6
Shp. kapitale	40.2	4.0	-31.9	-1.5	-15.0
Huadhënie KESH	2.0	0.2	...	...	...
Deficiti buxhetor	25.7	2.6	-50.7	30.7	-18.8

Burimi: Ministria e Financave, INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Hapësirë informuese 5. Reagimi i politikave makroekonomike gjatë viteve 2006-2012.

Kriza globale, e cilësuar nga ekonomistë të ndryshëm si më e thella që prej viteve 1930, kërkoi ndërhyrjen e përbashkët të autoriteteve monetare e fiskale në funksion të gjallërimit të kërkesës agregate dhe mbështetjes së sektorit financiar. Këto masa në shumë raste kanë dalë përtej kuadrit tradicional të veprimit të secilës prej politikave, duke sjellë për pasojë përkeqësim të pozicioneve fiskalë, si edhe rritje të konsiderueshme të bilanceve të bankave qendrore[46]. Autoritetet fiskale kanë injektuar stimuj me madhësi të ndryshme, çka është reflektuar në përkeqësime të konsiderueshme të pozicioneve fiskalë. Ndërkohë, autoriteti monetar ka përdorur një gamë më të gjerë instrumentesh jo të drejtpërdrejta në funksion të gjallërimit të aktivitetit ekonomik në vend. Masat e marra nga bankat qendrore ndër të tjera kanë përfshirë uljen e normës bazë në nivele të ulëta historike dhe ruajtjen e këtyre niveleve për periudhë të gjatë kohore; lehtësira kreditimi dhe sasiore të përkohshme apo të përhershme; ndërhyrje në tregun valutor; blerjen e letrave me vlerë afatgjata të zotëruara nga sektori privat, si edhe masa të tjera të cilat kanë dalë përtej kuadrit tradicional të instrumenteve të përdorura prej tyre[47].

Në këtë hapësirë informuese paraqitet në terma të përgjithshme kahu i veprimit të politikës fiskale me atë monetare, duke filluar me periudhën para krizës globale, përgjatë saj, e duke e shtrirë analizën deri në vitin 2012. Nga instrumentet e autoritetit monetar do merret në konsideratë vetëm ndryshimi në pikë përqindje i

[46] *Cotarreli C. and Vinals J. (2009) "A strategy for renormalizing fiscal and monetary policies in advanced economies", IMF SPN/09/22.*

[47] *Për detaje referojuni IMF (2010) "Central banking lessons from the crisis", fq. 10-12.*

normës bazë të interesit nga një vit më parë. Ky ndryshim reflekton natyrën e politikës monetare, e cila në grafikët e mëposhtëm do të pozicionohet në kahun shtrëngues për çdo zhvendosje djathtas përgjatë boshtit horizontal dhe anasjelltas. Ndërsa kahu i politikës fiskale do të ilustrohet nëpërmjet ndryshimeve të raportit të balancës primare në raport me prodhimin e brendshëm bruto nga një vit më parë. Në këtë hapësirë informuese politika fiskale do konsiderohet lehtësuese nëse balanca primare[48] e shprehur si % e PBB-së përkeqësohet, (zhvendosje poshtë përgjatë boshtit vertikal) si edhe e kundërta, shtrënguese kur balanca primare përmirësohet. Për të krahasuar kombinimin e dy politikave para dhe gjatë krizës globale janë marrë vendet e Eurozonës (EU 17)[49], për arsye se përfaqësojnë partnerin më të madh të flukseve tregtare të Shqipërisë me jashtë.

Grafik 41. Kombinimi i politikës fiskale e asaj monetare në rastin e Shqipërisë.



Burimi: Ministria e Financave, INSTAT, dhe Banka e Shqipërisë.

Nga një analizë krahasuese mes Shqipërisë dhe vendeve të Eurozonës, vërehet se në periudhën 2006-2007 politika monetare ka qenë në kahun shtrëngues, në funksion të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve[50]. Ndërkohë, për të njëjtën periudhë kohore kahu i veprimit të politikës fiskale në Shqipëri ka qenë lehtësues, i kundërt me atë të Eurozonës. Në vitet 2008-2009 politika monetare ka qenë tejet lehtësuese në Eurozonë, e kombinuar me një politikë fiskale që ka vepruar në të njëjtin kah me të, në përgjigje të krizës financiare e ekonomike që përfshiu këto vende. Ndërkaq, në Shqipëri politika fiskale ka pasur natyrë ekspansioniste gjatë periudhës 2008-2009, si pasojë e rritjes së shpenzimeve kapitale përgjatë kësaj kohe[51]. Një vit më vonë politika fiskale konsoliduese, e cila përcaktoi një deficit buxhetor ndaj PBB-së rreth 3.9 pikë përqindje më të ulët nga një vit më parë, u kombinua me një politikë monetare, e cila duke filluar nga viti 2009 ka vepruar në kahun stimulues.

Grafik 42. Kombinimi i politikës fiskale e asaj monetare në EU 17.



Burimi: Eurostat, FMN WEO tetor 2012, dhe Banka e Shqipërisë.

Për vitin 2012 paraqitet një tablo e ngjashme për reagimin e politikave makroekonomike në Shqipëri me ato të Eurozonës. Politika monetare është vendosur në kahun stimulues gjatë vitit 2012, si në Shqipëri ashtu edhe në Eurozonë. Në të njëjtën kohë, duket se përkeqësimi i pozicioneve fiskalë në vendet e Eurozonës, i reflektuar në një rritje të borxhit publik neto në rreth 73.4% të PBB-së për vitin 2012, nga 68% në vitin 2011[52], ka kushtëzuar hapësirat për veprimin e politikës fiskale, duke e vendosur këtë të fundit në kahun konsolidues. Përkeqësimi i pozicioneve fiskalë në Eurozonë vlerësohet të jetë pasojë e një kombinimi

[48] *Balanca primare= Balanca buxhetore + shpenzime për interesa.*

[49] *BE 17: Belgjikë, Gjermani, Estoni, Irlandë, Greqi, Spanjë, Francë, Itali, Qipro, Luksemburg, Maltë, Holandë, Austri, Portugali, Sllloveni, Sllovaki dhe Finlandë.*

[50] *Në vitin 2007, rritja e çmimeve të mallrave ushqimorë bazë kërkoi ndërhyrjen e autoriteteve monetarë për mbajtjen e inflacionit nën kontroll.*

[51] *Në vitet 2008 e 2009 deficiti buxhetor në raport ndaj PBB-së u vlerësua përkatësisht në 5.5 dhe 7.0% të PBB-së, duke reflektuar kryesisht rritjen e shpenzimeve kapitale në mesatarisht 8.5% të PBB-së, nga 5.4% që rezultonte për periudhën 2004-2007.*

[52] *Bazuar në vlerësimet dhe projeksionet e FMN-së në WEO, tetor 2012.*

të paketës EERP (European Economic Recovery Plan)[53] me reformat strukturore, si edhe e veprimit të stabilizatorëve automatikë në përgjigje të ngadalësimit ekonomik që njohën këto vende. Borxhi publik është rritur dhe në rastin e Shqipërisë; në fund të vitit 2011 ai vlerësohet pranë limitit prej 60% të PBB-së, të përcaktuar në ligjin organik të buxhetit.

[53] *http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-08-735_en.htm*

IV.2 TREGU I PUNËS, PAGAT DHE KOSTOT E PUNËS

Aktiviteti i ulët ekonomik i viteve të fundit është shoqëruar me rritjen e ngadaltë të punësimit dhe me luhatjet e normës së papunësisë mbi nivelin 13%. Pavarësisht faktorëve strukturorë që ndikojnë nivelin e lartë të normës së papunësisë, kushtet aktuale të tregut të punës vlerësohen të përcjellin presione të ulëta inflacioniste. Pagat dhe kostot e tjera të prodhimit kanë pësuar rënie gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012.

Tregu i punës

Në linjë me prirjet e vërejtura gjatë tre viteve të mëparshme, tregu i punës vazhdoi të karakterizohet nga mungesa e dinamizmit edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2012. Zbehja e aktivitetit në këtë treg është theksuar më shumë në tremujorin e dytë të vitit. Punësimi ka ngadalësuar rritjen vjetore në 0.4% në këtë tremujor, nga 1.4% në tremujorin e parë. Në terma absolutë kjo rritje përkthehet në 3,750 persona. Rritja modeste e këtij treguesi vlerësohet të ketë ardhur si pasojë e një kërkese të ulët nga sektori privat jobujqësor (1.6%) dhe rënies së kërkesës për punësim nga sektori shtetëror (-0.2%). Në sektorin bujqësor, punësimi ka mbetur i pandryshuar në nivelin 506,664 persona. Përsa i përket forcës së aftë për punë, ajo ka shënuar një rritje të lehtë me rreth 0.4%, duke reflektuar një rritje më të lartë të numrit të të papunëve (0.7%) në krahasim me numrin e të punësuarve (0.4%).

Tabelë 7. Treguesit e bilancit të forcave të punës.

Ndryshimet vjetore në %	2010	2011	2012 T1	2012 T2
Forca e aftë për punë	1.7	1.5	1.3	0.4
Të punësuar gjithsej	2.0	1.7	1.4	0.4
Të punësuar në sektorin shtetëror	-0.2	-0.6	-0.5	-0.2
Të punësuar në sektorin privat bujqësor	2.1	0.0	0.0	0.0
Të punësuar në sektorin privat jobujqësor	3.1	6.7	5.5	1.6
Të papunë të regjistruar gjithsej	-0.2	-0.1	0.4	0.7
Norma e papunësisë	13.49	13.29	13.32	13.30

Burimi: INSTAT

Në reflektim të zhvillimeve në kërkesë – ofertën në tregun e punës, norma e papunësisë është luhatur mbi nivelin 13% që prej vitit 2009, duke qëndruar në 13.3% në tremujorin e dytë të këtij viti. Të dhënat nga MPCSSHB[54] tregojnë se papunësia afatgjatë mbetet në nivele të larta edhe gjatë tremujorit të dytë, duke evidentuar një nga problemet e mbartura strukturore të këtij tregu. Personat që kërkojnë punë prej më shumë se një viti përfaqësojnë rreth 60% të të papunëve në total në tremujorin e dytë. Ky raport është ulur me rreth 4 pikë përqindje nga norma mesatare prej 64%, matur që nga tremujori i katërt i vitit 2007.

Grafik 43. Tregues sasiorë të tregut të punës.



Burim: INSTAT dhe MPCSSHB.

Mbështetur në rezultatet e vrojtimit për tremujorin e tretë, bizneset vazhdojnë të shprehen pesimistë në vlerësimin e tyre për situatën e punësimit për pjesën e mbetur të vitit.

Pagat dhe kostot e punës

Zhvillimet në tregun punës janë reflektuar në prirjen ngadalësuese të pagave gjatë dy viteve të fundit. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, indeksi i pagës mesatare në ekonomi[55] shënoi norma negative rritjeje. Pas rënies dyshifrore të këtij treguesi në tremujorin e parë, ai ngadalësoi tkurrjen vjetore në -7.1% në terma nominalë dhe -8.4% në terma realë në tremujorin e dytë. Dinamika tremujore tregon se paga mesatare shënoi rritje me rreth 5% në krahasim me tremujorin e parë. Në nivel sektorial pagat u rritën në sektorin e prodhimit me 3.3% në terma nominalë dhe 1.93% në terma realë. Në sektorin e shërbimeve pagat ranë në vlera nominale dhe reale me përkatësisht 11.7% dhe 12.9%. Brenda këtij sektori rënie të ndjeshme

[54] *Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta*

[55] *Treguesi i pagës në ekonomi, referuar edhe nën termin "pagë mesatare", është llogaritur si raport i indeksit të fondit të pagave me indeksin e numrit të punonjësve, burimi i të cilëve është publikimi "Statistikat afatshkurtra" INSTAT, ku përjashtohet "Bujqësia". Frekuenca e të dhënave është tremujore.*

të pagës kane pësuar sektorët e tregtisë dhe të transportit. Në dallim nga sektori privat, paga mesatare mujore shtetërore ndoqi një prirje rritëse. Në tremujorin e dytë të vitit, paga mesatare shtetërore u rrit me 7.3% në terma nominalë dhe 5.3% në terma realë.

Grafik 44. Paga dhe vlerësimet për to në ekonomi.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Nisur nga rritja e pagës minimale për ekonominë, duke filluar nga muaji korrik 2012, për tremujorin e tretë pritet rritje e indeksit të pagave. Kjo pritje konfirmohet dhe nga vlerësimet e bizneseve për nivelin e pagave në tremujorin e tretë dhe pritjet e tyre për rritje të mëtejshme të pagave në tremujorin e katërt të vitit.

- Kostot e tjera të punës

Zhvillimet në aktivitetin ekonomik, në tregun e punës dhe në paga për sektorët jobujqësorë gjatë pjesës së parë të vitit 2012, janë materializuar në ecurinë e luhatshme, veçanërisht të treguesit të produktivitetit të punës (PP). Pas ritmeve të rritjes në vitin 2011, dinamika e tij shënoi rënie vjetore në tremujorët e parë (-10%) dhe të dytë (-8%) të vitit 2012. Përformanca e tij u kushtëzua nga rritja më e shpejtë e indeksit të punësimit, se sa ritmet e vlerës së shtuar për aktivitetin ekonomik jobujqësor në vend. Një zhvillim i tillë tregon ulje të eficiencës së përdorimit të faktorit të punës në procesin e prodhimit nga bizneset përkatëse. Ritmet negative të këtij treguesi nuk sinjalizojnë "nxehje" të aktivitetit të ardhshëm ekonomik – premisë kjo e rëndësishme që do të siguronte presione të ulëta inflacioniste nga ambienti i brendshëm në terma afatmesme.

Në të njëjtën kohë, treguesi i kostove të punës për njësi të prodhuar (KPNj) në sektorin jo bujqësor të ekonomisë, vijoi të qëndrojë në zonën negative të ritmeve vjetore përgjatë pjesës së parë të këtij viti. Dinamika negative u frenua lehtësisht nga tremujori i parë (-1.2%) në të dytin (-0.9%) si pasojë e zhvillimeve në produktivitetin e punës dhe në atë të treguesit të pagës mesatare

reale. Vlerat tregojnë se rënia e pagave reale për të dy tremujorët ka rezultuar më e thellë se sa rënia e produktivitetit të punës. Këto zhvillime, krahas atyre në produktivitetin e punës, tregojnë se nga krahu i kostove të punës nuk janë prodhuar presione inflacioniste më origjinë të brendshme.

Grafik 45. Treguesit e produktivitetit, të kostos së punës për njësi dhe të pagës mesatare reale (majtas); ndryshime vjetore (djathtas)*.



*Matjet u referohen treguesve të produktivitetit të punës dhe të kostos së punës për njësi të prodhuar të ekonomisë përjashtuar bujqësinë. Në llogaritje janë përdorur të dhënat nga vlera e shtuar (sezonalisht e rregulluar - INSTAT, PBB, T2, 2012), si edhe ato nga statistikat afatshkurtra për punësimin dhe për pagat (INSTAT, SASh, T2, 2012). Treguesit e SASh nuk përfshijnë bujqësinë, ndaj vlera e shtuar është konsideruar pa bujqësinë. Indeksi i pagës mesatare reale është përftuar pas deflatimit me atë të IÇK-së së rregulluar sezonalisht (T2,2012). Për efekt krahasimi, treguesit janë ribazuar me vlerën e secilit tregues në tremujorin e parë të vitit 2003.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e mësipërme e këtyre treguesve nuk krijon një ambient që mund të prodhojë efekte të veprimit të dytë nga kostot e punës në ekonomi. Mundësitë e shfaqjes së një spiraleje inflacioniste nga pagat tek pritjet për inflacionin në një horizont afatmesëm mbeten shumë të kufizuara, vlerësim që konfirmohet nga pritjet e ankoruara për inflacionin në terma afatmesme dhe afatgjata.

- Kostot prodhuese industriale

Ecuria e kostove prodhuese industriale deri në fund të muajit qershor 2012 për mallra të destinuara për tregun vendas, nuk ka transmetuar presione të shtuara drejt çmimeve të konsumit në tremujorin e tretë. Indeksi i çmimeve të prodhimit gjatë tremujorit të dytë (IÇP_vend), në terma tremujorë shënoi rënie (-0.6%), ndërsa rritja vjetore rezultoi 1.7%. Pavarësisht kësaj rritjeje, inflacioni vjetor i këtyre çmimeve qëndron 2.7 pikë përqindje më poshtë se sa ai i së njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Nga luhatjet e IÇP-ve (vendase) të nëndegëve prodhuese të industrisë, të cilat janë më të korreluara me ato të IÇK-ve të nëngrupeve përkatëse, rezulton se nëndegët e nxjerrjes dhe të rafinimit të naftës kanë operuar me kosto më të larta prodhuese. IÇP-të (vendase) të këtyre nëndegëve kanë shënuar rritje vjetore përkatësisht 8.3% dhe 9.3% në tremujorin e dytë. Këto zhvillime në hallkën prodhuese dhe përpunuese kanë ushtruar presione të shtuara inflacioniste në nëngrupin "Operacione për mjetet personale të transportit" gjatë periudhës korrik-shtator 2012.

Grafik 46. Ndryshimet vjetore: IÇK dhe IÇP për prodhimet në tregun vendas; korrelacionet lineare.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Kostot prodhuese në industrinë përpunuese ushqimore në tremujorin e dytë shënuan rënie vjetore prej 5.7%, relativisht më e thellë se sa ajo e tremujorit të parë. Një pjesë e kësaj rënieje vjen nga mbartja e efektit të bazës së lartë krahasuese të vitit të kaluar. Këto zhvillime kanë mbështetur qëndrueshmërinë e inflacionit vjetor rreth vlerave të ulëta në kategorinë e rëndësishme të shportës së IÇK-së "Ushqime të përpunuara" për periudhën korrik-shtator[56]. Kjo ecuri vijon të konfirmojë vonesën kohore me të cilën transmetohen luhatjet e qenësishme nga kostot prodhuese drejt çmimeve të konsumit të ushqimeve të përpunuara.

IV.3 INFLACIONI I IMPORTUAR

Bazuar në dinamikën e treguesit të inflacionit të importuar në muajt e fundit, presionet inflacioniste nga ekonomia e jashtme të pranishme në tregun e brendshëm vlerësohen të kenë qenë përgjithësisht të ulëta, por me një kthesë drejt rritjes në muajin gusht 2012[57]. Në analizën e vlerësimit të presioneve inflacioniste nga jashtë përdoren dy tregues. Ndërsa treguesi i inflacionit të importuar[58] mundëson gjykimin për presionet e përgjithshme inflacioniste me origjinë nga jashtë, treguesi i diferencialit ndërsektorial të inflacionit përpiqet të kuantifikojë masën e verifikimit të tyre në inflacionin në vend.

[56] *Vlerat e inflacionit mesatar vjetor për kategorinë përkatëse kanë qenë 1.7% dhe 1.6%, përkatësisht, në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2012.*

[57] *Presionet inflacioniste me origjinë nga jashtë, nuk ushtrojnë efekt të menjëhershëm në tregun e brendshëm, por vlerësohet që ato e shfaqin ndikimin e tyre me disa muaj vonesë. Nisur nga kjo, për muajin shtator, prezenca e presioneve inflacioniste vlerësohet rritëse.*

[58] *Ky tregues llogaritet si mesatare e ponderuar e indekseve të çmimeve të konsumit të 21 shteteve, duke përdorur peshat e importit të tyre bazuar në të dhënat e tregtisë së jashtme, duke i shtuar vlerën e indeksit NEER për muajin përkatës*

Indeksi i inflacionit të importuar është shfaqur i luhatshëm gjatë 8 muajve të parë të vitit, duke shënuar normën më të ulët prej 0.9% në muajin shkurt dhe normën më të lartë prej 4.5% në muajin prill. Presionet inflationiste me origjinë nga jashtë rezultuan në rritje me përafërsisht 2.9% për gjashtëmujorin e parë të vitit, ndërsa për periudhën korrik-gusht u rritën mesatarisht me 2.1%. Ky zhvillim pasqyroi kryesisht ecurinë e komponentit "Çmime të huaja", i cili shënoi një rritje vjetore për të njëjtin interval kohor prej 1.7%. Përpos, rritjes së çmimeve në vendet kryesore partnere tregtare, nënçmimi i lehtë i lekut në terma të indeksit NEER në muajt korrik – gusht duket të ketë luajtur një rol plotësues në përcjelljen e rritjes së çmimeve nga jashtë në inflacionin në vend.

Grafik 47. Indeksi "Presionet inflacioniste prej çmimeve të huaja"dhe inflacioni në vend (majtas, ndryshim vjetor), dhe kontributet e çmimeve të huaja dhe kursit të këmbimit (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT, FMN, OECD, EuroStat.

Treguesi i diferencialit ndërsektorial të inflacionit tregon për një kontribut të shtuar të inflacionit të importuar në atë total, në tremujorin e tretë të vitit. Ky tregues rezultoi pozitiv dhe evidentoi se gjatë tremujorit në analizë zhvillimet në çmimet e mallrave kanë shkaktuar inflacion më të lartë se sa ato të shërbimeve. Presionet e importuara inflacioniste patën një intensitet më të lartë gjatë tremujorit të tretë të vitit aktual, edhe si pasojë e shuarjes së efektit të bazës së lartë krahasuese të vitit të kaluar. Ato ndikuan në rritjen e inflacionit me rreth 1.3 pikë përqindje, duke formuar rreth 48% të tij. Pothuaj se gjysma tjetër e inflacionit, u krijua nga presionet e brendshme në ekonomi, të cilat mbetën relativisht të qëndrueshme. Balancimi i strukturës kontribut-dhënëse të presioneve të jashtme dhe të atyre të brendshme inflacioniste është favorizuar nga sjellja e gjatë mbiçmuese e kursit të këmbimit euro/lek.

Grafik 48. Diferenciali ndërsektorial dhe kontributet përkatëse (grafiku djathtas).



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

IV.4 PRITJET INFLACIONISTE[59]

Pritjet inflacioniste rezultuan të ankoruara më mirë në tremujorin e tretë të vitit 2012, në krahasim me gjashtëmujorin e parë. Regjistrimi i një norme të ulët historike të inflacionit zyrtar në tremujorin e parë dha një ndikim rënës të përkohshëm tek pritjet e agjentëve ekonomikë. Treguesi që kuantifikon masën e ankorimit të pritjeve afatshkurtra[60] ka ardhur në rritje, duke ju afruar nivelit 0, gjë e cila dëshmon për presione të ulëta inflacioniste nga të tre grupet kryesorë të agjentëve ekonomikë. Pritjet afatmesme të inflacionit, të cilat matin goditje të një natyre më të qëndrueshme, janë më mirë të ankoruara

Grafik 49. Treguesi i masës së ankorimit të pritjeve të inflacionit nga agjentë të ndryshëm të ekonomisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[59] *Banka e Shqipërisë i mat pritjet inflacioniste të agjentëve ekonomikë nëpërmjet vrojtimeve të besimit të bizneseve e të konsumatorëve dhe vrojtimit të pritjeve të agjentëve financiarë.*

[60] *Ky tregues tregon sa devijime standarde larg është vlera e pritur e inflacionit nga mesatarja historike e serisë kohore të pritjeve.*

në krahasim me tremujorin e kaluar[61]. Ankorimi i pritjeve, sidomos atyre afatmesme, tregon për besimin e agjentëve financiarë në aftësinë e politikës monetare në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

IV.5 VLERËSIM I PRESIONEVE INFLACIONISTE NË SEKTORIN REAL TË EKONOMISË

Zhvillimet në ekonominë reale gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012 tregojnë për vijimësinë e një aktiviteti ekonomik nën potencial, të një kërkese të zbehtë agregate dhe të presioneve të dobëta inflacioniste nga ana e kërkesës. Pas rënies ekonomike të tremujorit të parë, rritja ekonomike iu kthye normave pozitive. Megjithatë, ajo mbetet në nivele të ulëta dhe e pa balancuar, e mbështetur kryesisht nga kërkesa e huaj, ndërkohë që kërkesa e brendshme vijon të jetë e dobët. Kushtet aktuale të ekonomisë janë materializuar në presione të ulëta nga ana e kostove të punës dhe të kapitalit në tregun e brendshëm. Presionet nga ekonomia e jashtme janë bërë më të pranishme gjatë tremujorit të tretë, por mbeten të kontrolluara në kushtet e një qëndrueshmërie thuajse njëvjeçare të kursit të këmbimit. Në linjë me parashikimet, inflacioni vjetor ndoqi një trajektore rritëse përgjatë nëntë muajve të parë të vitit, duke qëndruar në nivelin 2.7% në tremujorin e tretë.

Grafik 50. Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në ekonomi (devijim nga mesatarja, grafiku majtas) dhe vlerësimet për punësimin (devijime nga mesatarja, grafiku djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

Balanca e informacionit të pjesshëm të disponuar për tremujorin e tretë të vitit dhe në vazhdim, tregon se ekonomia shqiptare do të performojë poshtë potencialit të saj. Në një mjedis ekonomik me kërkesë të ulët, rritja e çmimeve dhe e kostove pritet të jetë e kufizuar. Nga ana tjetër, parashikimet për çmimet e lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare dhe për kursin e këmbimit tregojnë për ecuri relativisht të qëndrueshme të tyre, duke nënkuptuar një mjedis të jashtëm me presione të kontrolluara inflacioniste. Pritjet inflacioniste

[61] *Pritjet afatmesme maten vetëm për agjentët financiarë.*

janë të mirë-ankoruara, duke lehtësuar efektivitetin e politikës monetare në raste goditjesh të përkohshme nga ana e ofertës. Si konkluzion, Banka e Shqipërisë vlerëson se presionet inflacioniste do të mbeten të dobëta gjatë horizontit afatmesëm.

V. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE

Mjetet monetare në ekonomi kanë ruajtur ritme rritjeje të qëndrueshme gjatë tetë muajve të parë të vitit 2012. Zgjerimi i parasë së gjerë ka marrë kryesisht trajtën e mjeteve valutore neto, në përgjigje edhe të prurjeve të larta sezonale gjatë muajve të verës. Ndërkohë, kontributi i kredisë për sektorin privat dhe publik ka rezultuar me rënie krahasuar me tremujorin e dytë të vitit. Megjithë gjendjen e mirë të likuiditetit të sistemit bankar, kërkesa e ulët për mjete monetare e agjentëve ekonomikë privatë, pasiguritë për zhvillimet në të ardhmen dhe kushtet e shtrënguara të kreditimit vijojnë të diktojnë ritmin e ulët të kredisë në ekonomi. Ndërkohë, politika fiskale konsoliduese dhe financimi i deficitit buxhetor nga institucionet jobanka është reflektuar në një kontribut negativ të sektorit publik në krijimin e mjeteve monetare në ekonomi. Zhvillimet e deritanishme monetare konfirmojnë prezencën e presioneve të ulëta inflacioniste nga sektori monetar.

V.1 ECURIA E TREGUESVE MONETARË

Ecuria e agregatit të gjerë të parasë, M3, rezultoi e qëndrueshme gjatë muajve korrik – gusht, duke shënuar një rritje mesatare vjetore prej 8.3%. Ritmet e zgjerimit të parasë së gjerë reflektojnë kërkesën e ulët për para të agjentëve ekonomikë dhe performancën e mirë të komponentit valutor. Në kontekstin e një ecurie të dobët të aktivitetit ekonomik, të pasigurive për zhvillimet në të ardhmen dhe të kushteve ende të shtrënguara të kreditimit të sektorit bankar, kontributi me rreth 3.3 pikë përqindje i kredisë për ekonominë në krijimin e mjeteve monetare rezultoi në rënie në krahasim me tremujorin e dytë. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, kontributi i sektorit publik në zgjerimin vjetor të masës monetare ka rezultuar negativ me 2 pikë përqindje, në reflektim të politikës fiskale konsoliduese dhe të financimit të sektorit publik jashtë sistemit bankar. Nga ana tjetër, prurjet e larta valutore, të cilat karakterizohen nga sezonaliteti gjatë muajve të verës, kanë reflektuar zhvillime pozitive në sektorin e jashtëm, duke dhënë një kontribut prej 9.4 pikë përqindje në zgjerimin e masës monetare.

Krijimi i ulët i parasë në monedhë vendase është reflektuar në ritmet ngadalësuese të rritjes vjetore të agregatit M2, i cili regjistroi një normë rritjeje prej rreth 5% në muajt korrik-gusht, kundrejt mesatares prej 5.6% në tremujorin e dytë të vitit. Dinamika e ngadaltë vjetore rezulton nga financimi më i ulët i qeverisë me mjete monetare të sistemit bankar edhe nga performanca e mirë e kredisë në lekë. Gjithashtu, agregati likuid i parasë, M1, ka ndjekur një trajektore ngadalësuese, kryesisht si pasojë e kërkesës së ulët për para likuide.

Grafik 51. Kontributi i përbërësve të kërkesës dhe ofertës për para.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 52. Ecuria vjetore e agregatëve monetarë, shumëzuesi i parasë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

ECURIA E DEPOZITAVE

Stoku total i depozitave u zgjerua me një ritëm mesatar vjetor prej 10.3% në muajt korrik-gusht, kundrejt ritmit 10.6% në tremujorin e dytë të vitit, ose me rreth 25 miliardë lekë në terma mujorë. Ecuria e tyre ka reflektuar më së shumti flukset e larta valutore gjatë muajve të verës, kryesisht në muajin gusht. Kështu, depozitat në valutë u rritën me rreth 13.4% vit mbi vit. Zgjerimi i tyre në terma mujorë me rreth 27 miliardë lekë në muajt korrik-gusht kompensoi plotësisht tkurrjen e lehtë të depozitave në lekë gjatë kësaj periudhe. Kështu, krijimi i dobët i parasë në monedhë vendase u pasqyrua edhe në rritjen vjetore të depozitave në lekë, me rreth 7.5% në periudhën korrik-gusht kundrejt 8.5% në tremujorin paraardhës. Zgjerimi i vazhdueshëm i depozitave ka ndikuar në rritjen e raportit të depozitave ndaj M3 në 83.1%, nga 81.8% që shënonte në fund të vitit 2011.

Grafik 53. Ecuria vjetore e depozitave sipas monedhës dhe maturitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e depozitave sipas agjentëve ekonomikë ka evidentuar një tkurrje të depozitave të individëve me afat në lekë në harkun kohor korrik-gusht, më e theksuar në muajin gusht. Paralelisht, është vënë re një rritje e investimeve në bonot e thesarit dhe në obligacionet e individëve në tregun primar. Ndërkohë, depozitat me afat në valutë kanë dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e stokut total. Depozitat e biznesit kanë shfaqur gjithashtu trend pozitiv rritjeje, zhvillim ky i cili është favorizuar dhe nga ecuria pozitive e eksporteve gjatë kësaj periudhe.

Grafik 54. Kontributet e depozitave të agjentëve ekonomikë në lekë dhe në valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

KREDIA[62]

Kredia për ekonominë ka shfaqur ecuri të dobët në muajt korrik-gusht, e manifestuar në ngadalësimin e mëtejshëm të rritjes vjetore të saj. Në fund të muajit gusht, rritja vjetore e kredisë rezultoi 6.5%, nga 8.3% dhe 10.9% që shënonte përkatësisht në fund të tremujorit të dytë dhe të parë të vitit. Ecuria e kredisë për ekonominë reflekton kryesisht kërkesën e ulët në ekonominë vendase për mallra, shërbime e investime, por edhe tendencën e përdorimit të pakët të levës financiare nga agjentët ekonomikë. Në të njëjtën kohë, kredidhënia vijon të kushtëzohet edhe nga sjellja e kujdesshme e bankave. Kushtet e kreditimit mbeten të shtrënguara, pavarësisht lehtësimeve të bëra për segmente të caktuara të tregut, të cilat janë kryer në periudha të kufizuara kohore.

Grafik 55. Kredia për ekonominë sipas valutës.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia në lekë ka ruajtur ritme të larta të rritjes vjetore; në muajt korrik-gusht kjo rritje shënoi 16.5%. Teprica e kredisë në lekë është rritur me rreth 2 miliardë lekë gjatë kësaj periudhe, por nuk ka balancuar reduktimin e portofolit të kredisë në valutë prej rreth 2.7 miliardë lekësh. Tkurrja e vazhdueshme e kredisë në monedhë të huaj në pesë muajt e fundit është reflektuar në ngadalësimin e theksuar të rritjes vjetore të saj. Në fund të muajit gusht, norma vjetore e rritjes së kredisë në valutë rezultoi 1.5%, nga 4.3% dhe 7.3% që shënonte përkatësisht në fund të tremujorit të dytë dhe të parë të vitit. Përveç tendencës së vazhdueshme të individëve për të reduktuar detyrimet e tyre në valutë, ecuria e dobët e kredisë në valutë është përcaktuar ndjeshëm edhe nga shlyerja e detyrimeve, kryesisht afatshkurtra, në monedha të huaja të bizneseve.

[62] *Kjo analizë bazohet në të dhënat monetare. Përjashtim bën analiza e kredisë sipas qëllimit të përdorimit dhe sektorëve të ekonomisë, e cila përdor të dhëna të një metodologjie tjetër. Kredia sipas qëllimit dhe sipas sektorëve të ekonomisë nuk përmban interesat e përllogaritur dhe përfshin bizneset publike.*

Rritja vjetore e kredisë për sektorin privat ka ndjekur trendin ngadalësues të muajve të mëparshëm të këtij viti. Ajo rezultoi rreth 5.0% në muajin gusht, duke rënë me 5.4 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit të kaluar. Ngadalësimi i vazhdueshëm i ritmeve të rritjes së kredisë gjatë këtij viti është reflektuar edhe në zvogëlimin e impulsit të kredisë dhënë aktivitetit ekonomik. Kështu, raporti i kredisë për sektorin privat ndaj PBB-së në tremujorin e dytë vlerësohet në 40.4%, me një ndryshim vjetor prej 0.9 pikësh përqindjeje.

Grafik 56. Kredia për sektorin privat ndaj PBB-së dhe rritja vjetore e saj.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia për biznese në muajt korrik-gusht është shfaqur krahasimisht më e dobët se në pjesën e parë të vitit. Pas zgjerimit të ulët të regjistruar në tremujorin e dytë të vitit, teprica e kredisë për biznese u tkurr në muajt korrik dhe gusht. Në terma vjetorë, ritmi i rritjes së saj zbriti në 9.2%[63] në fund të muajit gusht, nga 11.7% dhe 13.3% që shënonte përkatësisht në fund të tremujorit të dytë dhe të parë të vitit.

Ngadalësimi i kredisë për biznese ka ardhur si pasojë e kredisë për financimin e nevojave për likuiditet, ecuria e së cilës ka qenë në nivele të dobëta historike. Ky portofol, pasi shënoi flukse neto të ulëta pozitive në tremujorin e parë dhe mbeti thuajse i pandryshuar në tremujorin e dytë të vitit, u tkurr në muajt korrik dhe gusht. Kjo ecuri është reflektuar në ngadalësimin e theksuar të normave vjetore të rritjes, të cilat në fund të muajit gusht qëndruan në 8.9%, nga 19.1% që shënonin në fund të vitit të kaluar.

[63] *Në muajin dhjetor të vitit 2011, u risklasifikua sipas qëllimit të përdorimit portofoli i kredisë së njërës nga bankat raportuese. Riklasifikimi çoi në reduktimin e stokut të kredisë hipotekore të individëve me 5.77 miliardë lekë dhe rritjen me po të njëjtën masë të stokut të kredisë për investime të bizneseve gjatë muajit dhjetor. Si rrjedhojë e këtij riklasifikimi, ndryshimet vjetore të kredisë për biznese kanë një zhvendosje pozitive prej mesatarisht 1.7 pikë përqindje.*

Grafik 57. Zhvillimet në kredinë për biznese sipas qëllimit të përdorimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.
Shënim: Ndryshimi mujor i kredisë për investime në muajin dhjetor 2011 nuk përfshin rritjen si rrjedhojë e riklasifikimit.

Kredia për investime ka regjistruar flukse neto pozitive, ndonëse të ulëta, në këta dy muaj. Rritja vjetore e saj është ngadalësuar, por në masë më të ulët krahasuar me llojet e tjera të kredive. Në fund të muajit gusht, ajo shënoi vlerën 13.7%[64], duke qëndruar pranë vlerës së regjistruar në fund të tremujorit të dytë të vitit.

Në periudhën korrik-gusht, bizneset që kanë rritur financimin nga sektori bankar i përkasin kryesisht sektorit të industrisë dhe të degëve të tjera të shërbimeve. Ndërkohë, kredia për degët e tregtisë, hotelerisë dhe restoranteve, si dhe ajo për sektorin e ndërtimit janë tkurrur. Në terma vjetorë, ngadalësimi është më i theksuar në rritjen vjetore të kredisë për shërbime

Grafik 58. Zhvillimet në kredinë për biznese sipas sektorëve të ekonomisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[64] *Efekti i riklasifikimit të mësipërm në kredinë për investime është një rritje me rreth 3.3 pikë përqindje të ndryshimeve vjetore të saj për periudhën dhjetor 2011 – gusht 2012.*

të tjera[65] (10.3% në gusht), në atë për industrinë (19.7% në gusht) dhe në atë për degët e tregtisë, hotelerisë e restoranteve (12.8% në gusht). Rritja e kredisë për sektorin e ndërtimit në fund të muajit gusht qëndron në 4.6%, ose rreth 1 pikë përqindje më pak se në fund të tremujorit të dytë.

Kredia për individë ka thelluar tkurrjen e saj në terma vjetorë. Në fund të muajit gusht, teprica e saj është 4.6%[66] më e ulët se një vit më parë. Ndonëse kushtet e kreditimit për individët kanë qenë më pak të shtrënguara se sa ato për bizneset, kredia për individë vuan më shumë mungesën e kërkesës për financim, veçanërisht të asaj afatgjatë. Kjo tregon për një faktorizim më të madh të pasigurisë në sjelljen e konsumatorëve.

Grafik 59. Zhvillimet në kredinë për individë sipas qëllimit të përdorimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Ndryshimi mujor i kredisë hipotekore në muajin dhjetor 2011 nuk përfshin reduktimin si rrjedhojë e riklasifikimit.

Sipas qëllimit të përdorimit, kredia hipotekore ka shfaqur ecuri më të dobët se sa ajo konsumatore. Kredia hipotekore ka vijuar të tkurret në terma vjetorë me -6.7%[67] në muajin gusht, pothuaj aq sa edhe në fund të tremujorit të dytë të vitit. Ndërkohë, ndryshimet mujore, përtej luhatshmërisë që shfaqin, e kanë lënë pothuaj të pandryshuar portofolin e kredisë konsumatore nga nivelet e fundit të vitit të kaluar. Në terma vjetorë, rritja e kredisë konsumatore është ngadalësuar më tej, duke zbritur në 1.6% në muajin gusht.

[65] *Në zërin shërbime të tjera klasifikohet kredia dhënë për shërbime sociale, për ndërmjetësit financiar, për arsim, për shëndetin etj.*

[66] *Efekti i riklasifikimit të portofolit të kredisë është materializuar në një reduktim të normave vjetore të rritjes së kredisë për individë me rreth 3.8 pikë përqindje në periudhën dhjetor 2011 – gusht 2012. Duke korrigjuar këtë efekt, ndryshimi vjetor i kredisë për individë është ngadalësuar deri në muajin maj dhe ka kaluar në territor negativ në muajt më pas.*

[67] *Efekti i riklasifimit të portofolit të kredisë në kredinë hipotekore është reduktim me mesatarisht 5.1 pikë përqindje i ndryshimeve vjetore të saj në periudhën dhjetor 2011 – gusht 2012. Duke korrigjuar për këtë efekt, rritja vjetore e kredisë hipotekore është ngadalësuar ndjeshëm deri në muajin mars dhe ka kaluar në territor negativ në muajt më pas.*

Hapësirë informuese 6. Përmbledhje e rezultateve nga vrojtimi i aktivitetit kreditues për tremujorin e tretë të vitit 2012[68].

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012, masa e shtrëngimit të standardeve të kredisë për bizneset ka mbetur e pandryshuar në krahasim me tremujorin e parë dhe të dytë. Bankat kanë shtrënguar në të njëjtën shkallë kredinë dhënë bizneseve sipas madhësisë (SME-ve dhe korporatave të mëdha) dhe sipas qëllimit (financim i kapitalit qarkullues dhe i investimeve). Për kredinë dhënë konsumatorëve, bankat vijuan të mbajnë të pandryshuara standardet, për të dytin tremujor rresht, si për blerje banese, ashtu edhe për financim të konsumit.

Faktorët kryesorë që shpjegojnë shtrëngimin e standardeve të kredisë për bizneset janë problemet specifike të sektorit ku operon biznesi, situata e kredive me probleme dhe situata e përgjithshme makroekonomike. Gjatë dy tremujorëve të fundit, mjaftueshmëria e kapitalit është vlerësuar si një faktor tjetër që ka dhënë kontribut në shtrëngimin e standardeve. Në lidhje me kredinë dhënë individëve, gjendja financiare e individëve, kreditë me probleme dhe tregu i pasurive të paluajtshme kanë kontribuar në shtrëngimin e standardeve, ndërsa likuiditeti dhe konkurrenca janë faktorë të cilët kanë dhënë kontribut për lehtësimin e tyre.

Grafik 60. Standardet e kredisë dhe kërkesa për kredi për bizneset (balanca neto).

Burimi: Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, Banka e Shqipërisë.

Ndryshimi në kushtet dhe kriteret për miratimin e kredive të reja të miratuara gjatë tremujorit të tretë ka reflektuar shtrëngimin e standardeve për bizneset. Për individët ato kanë mbetur pothuaj të pandryshuara. Kushtet kryesore me të cilat bankat kanë zbatuar politikën shtrënguese të kreditimit për bizneset janë zgjerimi i marzhit mesatar, rritja e komisioneve, ulja e madhësisë së huasë, rritja e madhësisë së kolateralit në raport me madhësinë e huasë, si dhe zvogëlimi i maturitetit.

Kërkesa neto për kredi, bazuar në perceptimin e ekspertëve pranë bankave, është zvogëluar edhe gjatë tremujorit të tretë si për bizneset ashtu edhe për individët, por me ritëm më të vogël në krahasim me tremujorin e dytë.

[68] *Vrojtimi i realizuar në muajin shtator 2012 mbulon zhvillimet në aktivitetin kreditues të tremujorit të tretë të vitit 2012, si dhe pritjet e bankave për aktivitetin kreditues gjatë tremujorit të katërt të vitit 2012. Analiza e detajuar e rezultateve të vrojtimit të aktivitetit kreditues gjendet në adresën www.bankofalbania.org, seksioni i publikimeve.*

Grafik 61. Standardet e kredisë dhe kërkesa për kredi për individët (balanca neto).



Burimi: Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, Banka e Shqipërisë.

Pritjet e bankave për tremujorin e katërt të vitit 2012 shfaqin një pamje më optimiste; standardet e kredidhënies pritet të lehtësohen dhe kërkesa të rritet, për të dy llojet e klientëve, biznese dhe individë. Pritjet janë përmirësuar si në krahasim me ato të një tremujori më parë, ashtu dhe me vlerësimin për gjendjen aktuale gjatë tremujorit të tretë.

V.2 ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE

Tregjet financiare janë shfaqur likuide dhe me një prirje rënëse të normave të interesit në tremujorin e tretë të vitit. Tregu ndërbankar ka regjistruar rritje të vëllimeve të shkëmbyera dhe diversifikim të maturiteteve, duke sugjeruar një administrim më eficient të tij nga pjesëmarrësit. Më tej, tregu primar ka evidentuar rënie të yield-eve për instrumentet e borxhit publik, primet për të cilat u rritën ndjeshëm një tremujor më parë. Ristrukturimi i këtij tregu ka lehtësuar përcjelljen e sinjaleve të politikës monetare në të dhe, në vijim, pritet të reflektohet në segmente të tjera të lidhura. Normat e interesit të kredisë në lekë, në terma mesatarë, kanë shënuar vlera më të ulëta në tremujorin e tretë. Megjithatë, përçimi i sinjaleve lehtësuese në këtë treg është ende i dobët dhe kushtet e kredidhënies mbeten të shtrënguara.

TREGU NDËRBANKAR

Normat e interesit në tregun ndërbankar për maturitetin javor janë ulur lehtë ndërsa ato për huamarrjen ditore kanë shfaqur prirje rritëse gjatë tremujorit të tretë. Volumi i shkëmbyer nga bankat në këtë treg ka shënuar rritje dhe transaksionet janë shtrirë edhe në maturitete të tjera, të përdorura rrallë në periudhat e mëparshme. Niveli i përgjithshëm i likuiditetit ka qenë më i lartë, duke krijuar kështu kushte të përshtatshme për rritjen e aktivitetit të agjentëve

të tregut ndërbankar dhe duke favorizuar rritjen e shkëmbimit të fondeve të lira. Në fundin e muajit korrik, Banka e Shqipërisë uli me 0.25 pikë përqindje normën bazë të interesit, duke e çuar atë në 4.00%. Në linjë me sinjalin e politikës monetare, normat e interesit në tregun ndërbankar regjistruan ulje të mëtejshme gjatë muajit gusht. Ecuria e normave të interesit ka qenë përgjithësisht rënëse në dy muajt e parë të këtij tremujori, duke prekur të dyja maturitetet e përdoruara nga bankat. Muaji shtator, ndërkohë, është karakterizuar nga një rritje e normave të interesit të kërkuara nga bankat në tregun e parasë. Vëllimi i huamarrjes në tregun ndërbankar ka shfaqur vlera të larta muaj pas muaji. Duke lënë mënjanë efektin pozitiv sezonal, ecuria e tij ka reflektuar një përqasje më aktive të bankave ndaj këtij segmenti për plotësimin e nevojave afatshkurtra për likuiditet. Peshën kryesore në volumin total të transaksioneve vijon ta luaj maturiteti javor, ndërkohë që vlen të evidentohet edhe shtimi i numrit të transaksioneve me maturitet të ndryshëm nga 1- ose 7-ditor.

Banka e Shqipërisë ka vijuar të kryejë operacionet e rregullta në treg të hapur nëpërmjet injektimit të likuiditetit me afat 7-ditor, ku likuiditeti i injektuar në sistem ka qenë lehtësisht më lartë se ai i periudhave paraardhëse. Krahas tyre janë përdorur edhe marrëveshjet e anasjellta me maturim 1- dhe 3-mujor.

Grafik 62. Vëllimi mesatar tremujor i transaksioneve në tregun ndërbankar për maturitetin 1- dhe 7-ditor (në mld lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ulja e normave ditore të interesit është shfaqur kryesisht në muajt korrik dhe gusht. Nga ana tjetër, ato kanë qenë vazhdimisht poshtë normës bazë të zbatuar nga Banka e Shqipërisë. Në nivel të përgjithshëm, ato kanë treguar luhatshmëri të afërt[69] me tremujorin e kaluar ndërkohë që diferenca e interesit ditor në tregun e parasë me normën bazë është ngushtuar[70]. Mesatarisht, norma mesatare e interesave njëditore në tremujorin e tretë rezultoi 3.80%, duke qëndruar 0.02 pikë përqindje më lart nga ajo e tremujorit të mëparshëm, ndërsa ajo shtatëditore zbriti në 4.13%, nga 4.24%. Vëllimi mesatar i transaksioneve njëditore u zvogëlua me 0.23 miliardë lekë në 1.42 miliardë lekë. Ndërsa ai i transaksioneve shtatëditore shënoi një rritje prej 0.61 miliardë lekësh në 5.00 miliardë lekë. Në total, volumi i tregtuar nga bankat gjatë tremujorit të tretë ishte 7.97 miliardë lekë, duke pasqyruar përkatësisht rritjen e huamarrjes javore e asaj mujore, si edhe prezencën e disa transaksioneve 2-3 ditore.

[69] *Deviacioni standard i interesit ditor në tregun ndërbankar për këtë tremujor ishte 0.231 nga 0.226 që ishte në tremujorin e parë të 2012.*

[70] *Diferenca e normës së interesit ditor me normën bazë në tremujorin e tretë ishte mesatarisht 32 pikë bazë, nga 47 pikë që ishte në tremujorin e kaluar.*

Grafik 63. Ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar (majtas) dhe e diferencave të tyre nga norma bazë (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

TREGU PRIMAR

Tremujori i tretë i vitit ka shënuar një pikë kthese në ecurinë e *yield*-eve. Këta tregues kanë shfaqur prirje rënëse të vazhdueshme për të gjitha maturitetet, që prej fundit të muajit korrik. Kjo ecuri është ndikuar nga rregullimi strukturor i pozicioneve të bankave dhe kërkesa e ulët e qeverisë për huamarrje në treg, të cilat kanë lehtësuar përçimin e natyrës stimuluese të politikës monetare në tregun primar në tremujorin e tretë. Reduktimi i normës bazë në mbledhjen e datës 25 korrik gjeti reflektim të menjëhershëm në ankandet pasardhëse të bonove të thesarit 12-mujore. Korrektimi i *yield*-eve në tremujorin e tretë është më i dukshëm tek instrumentet me afat mbi një vit, për të cilat primet ishin rritur ndjeshëm një tremujor më parë. Prirja konsoliduese e politikës fiskale, duket se ka ndikuar në rënien e rrezikut të perceptuar nga agjentët. Kushtet e lehtësuara në tregun e investimit të letrave me vlerë të qeverisë pritet të kanalizohen dhe në segmente të tjera investimi, duke qenë se ky treg përdoret shpesh si referencë për to.

Yield-i mesatar i bonove të thesarit 12-mujore zbriti në nivelin 6.78% në javën e dytë të tetorit, duke regjistruar një rënie prej 0.59 pikësh përqindje nga muaji qershor[71]. Raporti midis kërkesës për investim në këtë instrument me shumën e shpallur për emetim ka rezultuar relativisht i lartë (në 1.51 në tremujorin e tretë, nga 1.11 një tremujor më parë). Prirje të njëjtë kanë treguar dhe ankandet për instrumentet me maturitete të tjera, duke konfirmuar presionet e ulëta për likuiditet, të cilat kanë mbështetur rënien e *yield*-eve. Gjithashtu, rritja e konsiderueshme e pjesëmarrjes së individëve në investimet në letra me vlerë të qeverisë (nga 14.1% në fillim të vitit, në 19.1% në shtator) ka lehtësuar funksionimin e tregut primar dhe përmirësimin e treguesve.

[71] *Të dhënat më të fundit mbi zhvillimet në tregun primar datojnë më 18 tetor 2012.*

Grafik 64. Ndryshimet e yield-eve dhe niveli i tyre (majtas) dhe diferenca midis maturiteteve (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Financimi i qeverisë në tremujorin e tretë është bërë me instrumente afatgjatë (obligacione). *Yield*-et e obligacioneve 2-vjeçare u reduktuan në 8.02% në muajin tetor, nga niveli relativisht i lartë 8.75% në fund të tremujorit të dytë. Në të njëjtën linjë janë ulur dhe primet e kërkuara për instrumente më afatgjata. Ai për afatin 5-vjeçar (me interes të ndryshueshëm) ra nga 2.25 pikë përqindje në muajin maj, në 2.08 pikë përqindje në muajin gusht.

Grafik 65. Yield-et e letrave me vlerë të qeverisë në tregun primar (majtas) dhe struktura kohore e borxhit të brendshëm (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në muajt korrik dhe gusht, u kryen dhe dy ankande për emetimin e bonove të reja të thesarit të shprehura në euro. Ndonëse një instrument i ri, pjesëmarrja në ankande ishte relativisht e kënaqshme dhe u konsiderua si një mjet alternativ për investimin e kursimeve të individëve në valutë. Nga ana tjetër, duhet theksuar se emetimi i këtij instrumenti nuk shkaktoi presione në tregun valutor.

NORMAT E INTERESIT PËR DEPOZITAT DHE KREDITË E REJA[72].

Në përgjithësi, normat e interesit të depozitave kanë ndjekur prirje rënëse, si në lekë ashtu dhe në valutë. Këto të fundit, gjithnjë e më tepër po konvergojnë drejt atyre të zbatuara në Eurozonë, ndonëse mbeten ende pak më të larta. Rënia e interesave të depozitave në lekë ka ndjekur sinjalet e lehtësimit të kushteve monetare dhe rënien e kostos huamarrëse në tregun ndërbankar. Në muajin gusht, norma mesatare e ponderuar e depozitave 12-mujore (të cilat zënë peshën më të madhe në stokun e depozitave) ra në 5.06%, ose 0.44 pikë përqindje më poshtë se niveli i muajit qershor. Muaji gusht shënoi gjithashtu dhe një vlerë relativisht të lartë të interesit të depozitave 1-mujore, 4.33% nga 3.31% në muajin qershor, e cila duket të jetë ndikuar nga oferta afatshkurtër në këtë sezon.

Interesat për depozitat në euro kanë rënë, duke ndjekur të njëjtën prirje me ato në tregjet ndërkombëtare. Interesi mesatar i depozitave 12-mujore në këtë monedhë llogaritet 3.03% për muajt korrik-gusht, duke rënë me 0.24 pikë përqindje nga niveli i tremujorit të dytë. Pavarësisht rënies së normës së interesit, prurjet hyrëse të depozitave në euro kanë shënuar rritje të ndjeshme në muajt e verës.

Grafik 66. Normat e interesit për depozitat e reja në lekë (grafiku majtas) dhe ato në euro (grafiku djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Aktiviteti kredidhënës në monedhë vendase vazhdon të karakterizohet nga kushte të shtrënguara, shprehur midis të tjerash edhe në ruajtjen e diferencave të normave të interesit nga ato referencë[73]. Ecuria e normave të interesit është kushtëzuar nga rënia e kërkesës për kredi, nga kujdesi i shtuar i bankave dhe nga ndikimi i peshës së klientëve preferencialë në momentin që flukset e reja të kredisë janë të ulëta.

[72] *Të dhënat e fundit zyrtare për normat e interesit të depozitave dhe kredive datojnë në muajin gusht 2012.*

[73] *Vrojtimi i aktivitetit kreditues për tremujorin e tretë 2012.*

Normat e interesit të kredisë në lekë kanë shfaqur pririje të ndryshme sipas maturiteteve në tremujorin e tretë. Interesat afatshkurtra (deri në 1 vit) janë ulur mesatarisht në 10.53% në muajt korrik-gusht nga 11.15% në tremujorin e dytë, ndërsa ato afatgjata (mbi 5 vjet) janë rritur në 10.79% nga 10.60%. Këto zhvillime reflektojnë deri diku dhe strukturën e kredisë së re, ku dominon ajo afatshkurtër për plotësimin e nevojave me likuiditet për bizneset, si dhe primet në rritje të rrezikut për projekte afatgjata në këtë periudhë.

Ecuria e normave të interesit të kredisë në lekë është kushtëzuar dhe nga niveli i *yield*-eve të letrave me vlerë të qeverisë me të cilat indeksohen.

Grafik 67. Normat e interesit për kredinë e re në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pavarësisht rënies së theksuar të normave referencë në tregun ndërkombëtar, interesat për kredinë në euro në tregun e brendshëm kanë reaguar pak dhe kanë reflektuar marzhe më të larta për të gjitha afatet në këtë segment. Në të

Grafik 68. Normat e interesit për kredinë e re në euro.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

njëjtën kohë, ritmi i kredidhënies në euro është ngadalësuar së tepërmi dhe normat e interesit janë ndikuar ndjeshëm nga kredi të caktuara, duke shfaqur luhatshmëri. Rrjedhimisht, diferenca midis normave të interesit të kredisë në lekë dhe asaj në euro ka ardhur duke u ngushtuar. Në muajin gusht, ajo llogaritet në vlerën 3.94 pikë përqindje, nga mesatarisht 4.29 pikë përqindje që prej fillimvitit.

KURSI I KËMBIMIT

Ecuria e kursit nominal efektiv të këmbimit ka vijuar të paraqitet relativisht e qëndrueshme edhe gjatë tremujorit të tretë të vitit 2012. Pas një mbiçmimi të lehtë të monedhës vendase për gjashtëmujorin e parë të vitit, ndryshimet vjetore të indeksit NEER[74] kanë qëndruar thuajse të pandryshuara për periudhën në analizë (rritje në terma vjetorë vetëm me 0.4% dhe rënie në terma tremujorë me rreth -0.4%). Qëndrueshmëria e vlerave të indeksit NEER duket të jetë shprehje e kombinimit të ecurisë mbiçmuese të lekut ndaj monedhës evropiane dhe sjelljes së tij nënçmuese kundrejt dollarit amerikan në tregjet ndërkombëtare. Ngushtimi i deficitit të eksporteve neto si dhe përmirësimi i llogarisë së shërbimeve[75], shoqëruar dhe nga prurjet valutore tipike të periudhës korrik-gusht vazhduan të përkrahin forcimin e pozitave të monedhës vendase ndaj euros.

Grafik 69. Ndryshimet vjetore dhe tremujore të lekut në terma nominalë efektivë (NEER).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet individuale të monedhave kryesore të shportës në tregun e shkëmbimeve valutore pasqyrojnë një nënçmim të ndjeshëm të monedhës vendase kundrejt dollarit (11.3%) dhe mbiçmim kundrejt euros (1.6%)

[74] *NEER – kursi nominal efektiv i këmbimit llogaritet kundrejt monedhave të pesë partnerëve tregtarë kryesorë, të cilët janë Italia, Greqia, Gjermania, Turqia dhe Kina. Një rritje e NEER do të thotë nënçmimi i lekut.*

[75] *Të dhënat më të fundit i referohen bilancit të pagesave për tremujorin e dytë të vitit.*

në tremujorin e tretë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. E njëjta dinamikë reflektohet edhe në terma tremujorë, ku leku ka shënuar një mbiçmim të lehtë ndaj euros, duke u forcuar mesatarisht me 1.0% nga mesatarja e tremujorit të kaluar, ndërkohë që ka vijuar të humbasë terren ndaj dollarit amerikan me afërsisht 1.6%.

Grafik 70. Ecuria ditore e raportit euro/lekë, usd/lekë dhe euro/usd, gjatë tremujorit të parë të vitit 2012.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pasiguritë ekonomiko-financiare me të cilat po përballen njëherësh disa vende të Eurozonës dhe efektet e tyre në dinamikën e raportit euro/usd janë përcjellë edhe në tregun e shkëmbimit vendas. Efekti sezonal përgjatë muajve të verës ka kulmuar në nivele të tregtimit të raportit euro/lekë në 136.8, i cili përbën dhe vlerën më të ulët të regjistruar në dy vitet e fundit. Ndërkohë, mbarimi i sezonit veror është shoqëruar me një dobësim të lekut ndaj shportës së monedhave kryesore të tregtuara në vend. Kështu, në fund të javës së parë të shtatorit, një euro u ngrit në nivelin 138.0 lekë, duke vazhduar një ngjitje të vazhdueshme deri ditën e parafundit të muajit. Në këtë ditë një euro u këmbye me 140.4 lekë, mbështetur dhe nga kërkesa e lartë e fundit të tremujorit dhe pritjet për dobësim afatshkurtër të lekut në këtë periudhë. Forcimi i monedhës evropiane u shoqërua me rritje të ofertës së valutës nga agjentët e tregut, duke favorizuar monedhën vendase në fillim të tetorit.

Zhvillimet e sipërpërmendura, konfirmohen edhe nga luhatshmëria e euros ndaj lekut e cila shfaqet më e lartë se ajo e tremujorit paraardhës.

Në kontekstin rajonal, ecuria e lekut në raport me euron paraqitet ndjeshëm më e qëndrueshme nga ajo e monedhave të vendeve të Evropës Qendrore-Lindore dhe të Ballkanit. Në terma tremujorë, përveç Serbisë dhe Rumanisë, shtetet e tjera kanë shfaqur një mbiçmim të monedhave vendase gjatë muajve të fundit. Treguesi i luhatshmërisë në rastin e monedhës shqiptare paraqitet në kufirin e poshtëm të intervalit të krijuar nga vendet e rajonit.

Grafik 71. Luhatshmëria e raportit usd/lekë dhe euro/lekë në terma tremujorë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 72. Ecuria (indeks me bazë tetorin e vitit 2008) dhe luhatshmëria e raportit euro/lekë në krahasim me monedhat e Evropës Lindore-Qendrore dhe Ballkanit*.



* Luhatshmëria e raporteve euro/monedhë vendase është matur si devijim standard 30-ditor. Pikat kulminante të luhatshmërisë në çdo periudhë përfaqësojnë devijimin standard maksimal dhe minimal, të cilat kanë shënuar raportet e përfshira. Vendet e përfshira janë: Poloni, Çeki, Hungari, Rumani, Turqi dhe Serbi.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

V.3 VLERËSIMI I PRESIONEVE INFLACIONISTE ME NATYRË FINANCIARE

Zhvillimet monetare deri në muajin gusht 2012 tregojnë ngadalësim të ndjeshëm në normën vjetore të rritjes reale të M3, në 5.2% krahasuar me 7.7% dhe 6% në tremujorin e parë dhe të dytë përkatësisht. Ky ngadalësim nga njëra anë ka reflektuar vendosjen e kursimeve të individëve në tregun e letrave me vlerë, duke kushtëzuar rritjen më të ulët të depozitave në lekë në sistem; ndërsa nga ana tjetër ka reflektuar një kërkesë të dobët për para nga ekonomia e brendshme si dhe zhvillimet pozitive në ecurinë e komponentit valutor. Ecuria e mirë e komponentit valutor paraqet një rritje të pasurisë financiare të individëve që potencialisht mund të shfrytëzohet në të ardhmen

për të mbështetur konsumin, por në një këndvështrim afatshkurtër ndikimi i saj në ecurinë e inflacionit është i ulët. Ndërkohë, krediti i brendshëm si një tregues monetar që lidhet drejtpërdrejt me kërkesën për para të agjentëve ekonomik, ka shënuar tkurrje në terma realë, në muajin gusht, me 0.5% krahasuar me një vit më parë. Tkurrja në terma realë e kreditit të brendshëm është një fenomen i ri, i cili është ndikuar si nga financimi i ulët i bankave për sektorin fiskal ashtu edhe nga ecuria e dobët e aktivitetit kreditues.

Grafik 73. Ecuria e hendekut te parasë dhe kreditit te brendshëm*.



*Hendeku i parasë është llogaritur si diferencë e zhvillimeve në M3 real me vlerat potenciale të llogaritura me HP-filter.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndërkohë, diferenca midis *yield*-it dymbëdhjetëmujor me atë tremujor, në tremujorin e tretë ka zbritur pranë nivelit historik, duke diktuar se zhvillimet në tregjet financiare tregojnë për faktorizim të ulët të presioneve inflacioniste në çmimin e produkteve financiare. Po kështu edhe tregu valutor shfaqet i qetë dhe nuk sinjalizon për presione inflacioniste në çmimet e konsumit. Në të njëjtën kohë qëndrueshmëria e tij i ka shërbyer forcimit të mëtejshëm të stabilitetit financiar në vend, duke krijuar premisa për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve në periudhën afatmesme.

Grafik 74. Ecuria e diferencës së yield-ve dhe e presioneve në tregun valutor.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

PËRMBAJTJA	NR/ NO	CONTENTS
Tregues kryesore makorekonomikë		Main Macroeconomic Indicators
Zhvillimet monetare dhe normat e interesit	1	Monetary developments and interest rates
Prodhimi i brendshëm bruto, indekset e çmimeve dhe tregu i punës	2	Gross domestic product, price indexes and labor market
Bilanci i pagesave, rezerva dhe kursi i këmbimit	3	Balance of pay ments, reserves and exchange rate
Bilanci fiskal, stoku i borxhit të brendshëm dhe borxhi i jashtëm	4	Fiscal balance, domestic debt stock and external debt
1 Sektori financiar		Financial Sector 1
Bilanci sektorial i Bankës së Shqipërisë	1-1	Sectoral balance sheet of Bank of Albania
Paraqitja monetare e Bankës së Shqipërisë	1-2	Monetary survey of Bank of Albania
Bilanci sektorial i bankave para depozituese/ Mjetet	1-3a	Sectoral balance sheet of deposit money banks/ Assets
Bilanci sektorial i bankave para depozituese/ Detyrimet	1-3b	Sectoral balance sheet of deposit money banks/ Liabilities
Paraqitja monetare e bankave para depozituese	1-4	Monetary survey of deposit money banks
Bilanci sektorial i shoqërive të kursim-kreditit	1-5	Sectoral balance sheet of savings and loan associations
Paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese	1-6	Monetary survey of other depository corporations
Paraqitja monetare e korporatave depozituese	1-7	Monetary survey of depository corporations
Agregatët monetarë dhe përbërësit e tyre	1-8a	Monetary aggregates and their components
Kundërpartitë e agregatëve monetarë	1-8b	Counterparts of Monetary Aggregates
Depozitat në lekë sipas sektorit	1-9	Lek denominated deposits by sector
Depozitat në valutë sipas sektorit	1-10	Foreign currency denominated deposits by sector
Kredia për ekonominë sipas sektorit	1-11	Credit to Economy by Sector
Kredia sipas aktivitetit ekonomik	1-12	Loan by Economic Activity
Kredia sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës për bizneset	1-13	Business loans by purpose and currency
Kredia sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës për individët	1-14	Household loans by purpose and currency
Kredia sipas rrethit	1-15	Loans by district
Normat e interesit të Bankës së Shqipërisë	1-16	Bank of Albania interest rates
Normat e interesit për depozitat e reja sipas monedhave	1-17	Interest rate on new deposits currency
Normat e interesit për kreditë e reja sipas monedhave	1-18	Interest rate on new loans currency
Normat e interesit për bonot e thesarit sipas afatit	1-19	Maturity breakdown of Treausury bills yields
Sistemi i pagesave		Payment system
Sistemi i pagesave ndërbankare	1-20	Interbanking payment system
Shpërndarja rajonale e terminaleve të ATM dhe POS	1-21	Number of ATM & POS terminals by region
Numri i llogarive të klientëve në banka	1-22	Number of customers accounts with banks
2 Sektori i jashtëm		External sector 2
Bilanci i pagesave	2-1	Balance of Payments
Kursi i këmbimit të lekut kundrejt monedhave kryesore	2-2	Exchange Rate
Eksporti i mallrave sipas partnerëve	2-3	Export by countries
Importi i mallrave sipas partnerëve	2-4	Import by countries
Eksporti i mallrave sipas SITC	2-5	Export by product group
Importi i mallrave sipas SITC	2-6	Import by product group
Borxhi i jashtëm	2-7	External Debt
3 Sektori fiskal		Government Finance Sector 3
Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar	3-1	Fiscal indicators regarding consolidated budget
Stoku i borxhit të brendshëm sipas instrumenteve	3-2	Domestic debt stock by instruments
4 Sektori real		Real Sector 4
Prodhimi i brendshëm bruto sipas aktivitetit ekonomik	4-1	Gross domestic product by economic activities
Indeksi i çmimeve të prodhimit dhe indeksi i kushtimit në ndërtim	4.2	Producer price index and construction cost index
Indeksi i çmimeve të konsumit	4-3	Consumer price index
Punësimi, papunësia dhe pagat	4-4	Employment, unemployment and wages

SHTOJCA STATISTIKORE

TREGUES TË PËRGJITHSHËM MAKROEKONOMIKË

1. ZHVILLIMET MONETARE DHE NORMAT E INTERESIT

Në miliardë lekë, përveç rasteve kur shënohet ndryshe, fund periudhe

MAIN MACROECONOMIC INDICATORS

MONETARY DEVELOPMENTS AND INTEREST RATES 1.

In billions ALL, unless otherwise indicated, end of period

	Agregatët monetarë/ Monetary aggregates			Depozitat[1]/ Deposits[1]	Kredia[2] / Credit[2]	Normat e interesit 12m / 12m interest rates (%)			Norma e marrëveshjes së riblerjejes njëjavore [4] Weekly repurchase agreement rate[4]
	M1	M2	M3			Depozita[3] / Deposits[3]	Kredi[3]/ Loans[3]	Bono Thesari/ T. Bills	
	1	2	3	4	5	6	7	8	9
2007	242.7	506.1	757.6	602.7	293.9	5.67	11.73	8.26	6.25
2008	282.9	555.0	815.7	619.9	396.3	6.93	11.75	8.56	6.25
2009	284.5	578.2	871.5	662.4	440.4	6.78	12.46	9.14	5.25
2010	275.4	604.5	980.3	785.2	483.1	6.40	11.29	7.09	5.00
2011	276.9	647.0	1,070.1	875.2	541.9	5.87	11.17	6.95	4.75

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Source: Bank of Albania.

2. PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO[5], INDEKSET E ÇMIMEVE DHE TREGU I PUNËS

GROSS DOMESTIC PRODUCT[5], PRICE INDEXES AND LABOR MARKET 2.

	Rritja reale vjetore e PBB me çmime konstante (%)/ Annual real growth of GDP at constant prices (%)	Me çmime korrente, në milionë lekë/ At current prices, in million ALL				Ndryshimet vjetore të Indekseve (%) / Yearly Index change (%)		Tregu i punës[7]/ Labor market[7]	
		Produkti Brendshëm Bruto (PBB)/ Gross domestic product (GDP)	Pagat e të punësuarve, neto /Compensation of employees, net	Të Ardhura nga prona, neto/ Property income, net	Të Ardhurat Kombëtare Bruto/ Gross National Income	IÇK[6] / CPI[6] (12/2007=100)	IÇP / PPI (2005=100)	Niveli i punësimit/ Employment rate (%)	Shkalla e papunësisë/ Unemployment rate (%)
	2	1				6	7	8	9
2007	5.9	967,670.0	13,858.3	13,005.3	994,533.7	3.1	4.1	44.7	13.2
2008	7.5	1,089,293.1	21,282.7	-15,903.7	1,094,672.1	2.2	4.4	45.8	12.5
2009	3.3	1,148,082.1	20,749.0	-37,865.9	1,133,902.7	3.7	0.4	41.9	13.6
2010	3.8	1,222,462.1	22,501.4	-31,030.7	1,233,888.7	3.4	0.2	42.3	13.6
2011						1.7	2.6		13.3

Burimi: INSTAT.

Source: INSTAT.

3. BILANCI I PAGESAVE, REZERVA DHE KURSI I KËMBIMIT

BALANCE OF PAYMENTS, RESERVES AND EXCHANGE RATE 3.

Në milionë euro, përveç rasteve kur shënohet ndryshe

In millions EUR, unless otherwise indicated

	Bilanci i llogarisë korrente/ Current account	Nga të cilat: Bilanci tregtar/ Of which:Trade balance (3+4)			Nga të cilat: Remitancat/ Of which: Remittances	Investimet e Huaja Direkte/ Foreign direct investments	Rezervat valutore (stok)/ Reserves (stock)	Rezervat në muaj importe/ Reserves in months of import	Kursi i këmbimit/ Exchange rate Mesatare e periudhës/ Period average	
			Eksporti/ Export	Importi/ Import					ALL / EUR	ALL / USD
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
2007	-824.2	-2,104.0	786.3	-2,890.4	951.7	463.7	1,459.8	4.1	123.6	90.4
2008	-1,381.2	-2,431.5	917.5	-3,348.9	833.3	609.8	1,675.4	4.0	122.8	83.9
2009	-1,329.8	-2,303.7	750.7	-3,054.4	781.3	688.7	1,646.2	4.2	132.1	95.0
2010	-1,018.6	-2,082.7	1,171.5	-3,254.2	689.8	788.5	1,904.8	4.8	137.8	103.9
2011	-1,122.1	-2,241.6	1,405.5	-3,647.1	687.9	716.8	1,912.5	4.4	140.3	100.9

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Source: Bank of Albania.

4. BILANCI FISKAL, STOKU I BORXHIT TË BRENDSHËM DHE BORXHI I JASHTËM

FISCAL BALANCE, DOMESTIC DEBT STOCK AND EXTERNAL DEBT 4.

Në miliardë lekë

In billions ALL

	Të Ardhura/ Revenue		Shpenzime/ Expenditure		Deficiti/ Deficit			Stoku i borxhit të qeverisë qendrore/ Central government debt stock	
		Nga të cilat: Të ardhura tatimore/ Of which: Tax revenue		Shpenzime kapitale/ Capital expenditure		Financim i brendshëm/ Domestic financing	Financim i jashtëm/ Foreign financing	Stoku i borxhit të brendshëm/ Domestic debt stock	Stoku i borxhit të jashtëm / External debt stock
	1	2	3	4	5	6	7	8	9
2007	251.6	228.2	285.7	57.0	-34.1	28.8	5.3	369.5	147.5
2008	291.2	264.4	351.5	93.8	-60.3	24.4	35.8	400.5	195.4
2009	299.0	270.8	379.9	95.9	-80.9	70.7	10.2	415.0	267.5
2010	324.7	288.6	362.8	67.5	-38.0	27.8	10.2	407.4	308.0
2011	330.5	303.9	376.4	70.7	-45.9	26.1	19.8	438.6	334.0

Burimi: Ministria e Financave, sipas publikimeve "Statistikat fiskale të qeverisë" dhe Treguesit e Borxhit".
1) Përfshihen vetëm llogaritë dhe depozitat që janë pjesë e parasë së gjerë.
2) Përfaqëson kredinë për ekonominë.
3) Norma mesatare e ponderuar vjetore e depozitave dhe kredive të reja 12 mujore në lekë për sistemin bankar.
4) Të dhënat i referohen normës në fund të periudhës.
5) PBB 2010 jo përfundimtare.
6) Ndryshimi i muajit dhjetor të vitit n me dhjetorin e vitit n-1.
7) Të dhënat sipas informacionit në tabelat vjetore "Të punësuar gjithsej sipas sektorëve, niveli i punësimit" dhe "Shkalla e papunësisë". Të dhëna administrative.

Source: Ministry of Finance, according to "Fiscal Statistics of Government" and "Debt Indicators" publications.
1) Deposits included in broad money.
2) Credit to economy.
3) The annual weighted average rate of the 12 months new deposits and loans in ALL for the banking system.
4) End of period data.
5) GDP 2010 semi final.
6) Variation of December index of year n with December index of year n-1.
7) Data as of "Total employment by sector, employment rate" and "Unemployment rate" yearly tables. Administrative data.

1-1 BILANCI SEKTORIAL I BANKËS SË SHQIPËRISË

Në milionë lekë, fund periudhe

SECTORAL BALANCE SHEET OF BANK OF ALBANIA 1-1

In millions ALL, end of period

	Totali i mjeteve/ Total assets (2+3+4+5+8+12+13+14)	Mbajtjet e SDR/ SDR holdings	Arka në valutë/ Foreign currency	Depozita/ Deposits	Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet/ Securities other than shares (6+7)			Huatë/ Loans (9+10+11)				Derivatet financiare/ Financial derivatives	Llogari të arkëtueshme/ Receivable accounts	Mjete jofinanciare/ Nonfinancial assets
						Jorezidentë/ Nonresidents	Qeveria qendrore/ Central Government		Qeveria qendrore/ Central Governmen	Korporata të tjera depozituese/ Other depository corporations	Sektorë të tjerë rezidentë/ Other resident sectors			
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
2009 / 12	359,552.4	7,546.1	705.8	54,391.6	243,142.8	165,853.4	77,289.4	33,885.2	_	32,371.7	1,513.5	10.7	13,279.2	6,590.9
2010 / 12	368,031.5	8,126.9	647.0	41,705.7	280,300.9	215,901.8	64,399.2	14,302.2	_	12,534.8	1,767.3	81.4	10,748.3	12,119.1
2011 / 12	384,581.3	8,226.5	59.8	40,286.0	284,209.6	219,718.8	64,490.8	27,388.1	_	25,485.4	1,902.8	35.3	11,295.9	13,080.0
2012 / 04	383,568.3	7,737.2	62.1	44,099.0	282,934.9	217,894.7	65,040.2	23,535.7	_	21,605.5	1,930.2	23.0	11,569.4	13,607.0
05	386,335.4	8,553.2	49.3	41,695.8	291,583.7	222,524.8	69,058.9	18,534.3	_	16,588.0	1,946.2	28.1	12,280.0	13,611.1
06	392,021.6	8,324.9	125.7	43,759.8	288,344.7	218,414.9	69,929.8	25,703.8	_	23,763.0	1,940.8	20.6	12,125.6	13,616.5
07	402,924.8	8,298.8	56.4	47,305.6	291,255.1	221,381.9	69,873.2	28,916.4	_	26,980.9	1,935.5	20.5	13,096.7	13,975.3
08	407,390.2	7,994.8	48.5	40,768.0	303,009.1	232,945.4	70,063.7	28,334.4	_	26,404.7	1,929.7	19.1	12,991.1	14,225.3
09	407,908.0	7,835.6	54.0	45,317.6	302,043.4	233,136.6	68,906.8	25,028.3	_	23,104.0	1,924.3	16.4	12,944.0	14,668.8

	Detyrimet totale/ Total liabilities (2+3+4+10+14+15+16)	Paraja në qarkullim/ Currency in circulation	Depozita të përfshira në paranë e gjerë/ Deposits included in broad money	Depozita të papërfshira në paranë e gjerë/ Deposits excluded from broad money (5+6+7+8+9)						Huatë / Loans (11+12+13)				Llogari të pagueshme/ Other accounts payable	Alokimi i SDR/ SDR allocation	Aksione dhe instrumente të tjerë të kapitalit/ Shares and other equity
					Jorezidentët/ Nonresidents	Qeveria qendrore/ Central Government	Korporata të tjera depozituese/ Other depository corporations	Korporata të tjera jofinanciare/ Other nonfinancial corporations	Sektorë të tjerë rezidentë/ Other resident sectors		Jorezidentët/ Nonresidents	Qeveria qendrore/ Central Government	Korporata të tjera depozituese/ Other depository corporations			
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
2009 / 12	359,552.4	216,767.6	0.6	87,660.4	7,981.6	10,897.5	68,071.5	17.0	692.9	1,269.2	1,269.2	_	_	6,903.5	6,954.1	39,997.0
